

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

DHIKR DHE DUA

Ihjau Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit:
KITABU-DHIKR VE'D- DA'AVAT
LIBRI 9

Përgatiti dhe përktheu:
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Shenaj Zeneli

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Hamd i takon vetëm Allahut Teala, Atë e lavdërojmë dhe Atë e falënderojmë. Ai Allah që urdhëroi:

“...më kujtoni Mua që Unë t’ju kujtoj.” 2- Bekare: 152,
me çka i njoftoi se Allahu Teala do ta shpërblejë duke e përmendur robin e Vet, i cili e përmend (bën dhikër) Allahun, dhe thotë:

“Lutmuni Mua, Unë do t’ju përgjigjem”, 40- Gafir: 60,
me çka i inkurajon robët në lutje, dhe thotë:

“Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai t’më lutet Mua.” 2-Bekare: 186,
me çka njofton se Ai i përgjigjet lujëve të secilit që lutet, të nënshtruarit, por edhe kryengritësit.

Salat dhe selam zotërisë sonë dhe zotërisë së të gjithë peygamberëve, Muhammedit, s.a.v.s., ehli bejtit dhe as’habëve.

Tani dije se:

pas leximit të Kur’anit, ibadetet më të vlefshme janë ato në të cilat me gjuhë e me zemër përmendet (bëhet dhikër) Allahu dhe duaja (lutja) e singertë.

Atëherë le ta shpjegojmë, më parë shkurtimisht e pastaj edhe në detaje, vlerën e lartë (faziletin) e dhikrit, vlerën e lartë të duasë (lutjes), metodat (adab) dhe kushtet e saj, dobinë në dynja dhe ahiret, duatë që transmetohen nga Resulallahu, s.a.v.s., dhe duatë e posaçme për kërkim të faljes, mbrojtjes e të ngjashme. Të gjitha këto i përmbledhëm në pesë kapituj.

Kapitulli i parë

**VLERA E LARTË DHE DOBIA E DHIKRIT SIPAS AJETEVE,
HADITHEVE DHE TRANSMETIMEVE TJERA**

AJETET NË KËTË TEMË

“...më kujtoni Mua që Unë t’jukurtoj.” 2-Bekare: 152.

Sabit Benani tha: *“Unë e di kur më kujton Rabbi im”. Të pranishmit mbetën të habitur. E pyetën se si mund të dijë një gjë të tillë, e ai u përgjigj:*

- Kjo është e lehtë. Kur unë e kujtoj Rabbin tim, edhe Rabbi im më kujton mua.

Allahu Teala gjithashtu thotë:

“O ju që besuat, përkujtoni Allahun sa më shpesh.”

33-Ahzab: 41,

“E kur të derdheni (hiqeni) prej Arafatit, përmendeni Allahun në vend të shenjtë (Muzdelife), përmendeni Atë ashtu si u ka udhëzuar Ai.” 2-Bekare: 198,

“Pasi t’i kryeni ritet e haxhillëkut, përmendni Allahun ashtu siç i kujtoni prindërit tuaj, madje edhe më tepër!” 2-Bekare: 200

“... ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjur ose shtrirë.” 3-Ali Imran: 191,

"Pasi të kryeni namazin, përmendeni Allahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe të shtrirë." 4-Nisa: 103

Duke e komentuar këtë ajet, Ibn Abas r.a., ka thënë:

"Përmendeni (bëni dhikër) Allahun në çdo gjendje: ditën, natën, në tokë, në det, në vendbanim, në udhëtim, në pasuri, në varfëri, në rehati, në shëndet të mirë dhe në sëmundje, haptas dhe fshehtas."

"Përmende Rabbin tend në vete (heshtas), me përulje dhe drojë – jo me zë të lartë, në mëngjes dhe mbrëmje, dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje!" 7-Araf: 205,

"...përmendja e Allahut është më e madhja."

29-Ankebut: 45.

Për këtë ajet Ibn Abasi thotë se mund të ketë dy kuptime:

- a) Përmendja e robit prej anës së Allahut Teala është më e madhe se përmendja e Allahut nga ana e robit; dhe
- b) Përmendja e Allahut Teala është më e vlefshme se çdo ibadet tjetër pa dhikër.

Duke i përbuzur hipokritët, Allahu thotë:

"Allahun e përmendin fare pak." 4-Nisa: 142.

HADITHET NË KËTË TEMË

“Ai i cili përmend Allahun Teala në mesin e të pavetëdiqshmëve është sikur një pemë e gjelbër në mesin e pemëve të thata.”¹

“Ai i cili përmend Allahun Teala, në mesin e të pavetëdiqshmëve është sikur luftëtari në mesin e të arratisurve.”

Në një hadith *kudsi* thuhet:

“Unë jam me robin Tim përherë derisa ai të më përmend Mua dhe derisa lëviz buzët me dhikër.”²

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Me të vërtetë për njeriun nuk ka vepër më të vlefshme se sa dhikri, që ta shpëtojë veten nga dënimi i Allahut.” E pyetën:

- *As xhihadi në rrugën e Allahut?, e ai u përgjigj:*

- *As xhihadi në rrugën e Allahut, vetëm nëse godet me shpatë derisa nuk thyhet, dhe prapë godet me shpatë derisa nuk thyhet.*³

“Kush dëshiron t’i shijojë bahçet e xhennetit le t’i bëjë shpesh dhikër Allahut Teala.”⁴

¹ Ebu Nu’ajm në ‘*Hilje*’, Bejheki në ‘*Shuabu’l-Iman*’, nga Ibn Omeri me zinxhir të dobët transmetuesish.

² Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre.

³ Taberani nga Muadhi.

⁴ Taberani nga Muadhi.

Në pyetjen se cila vepër është më e pëlqyeshme, Resulallahu, s.a.v.s. u përgjigj:

“Vdekja duke thënë *Allah, Allah* me gjuhë.”⁵

“Zgjohu dhe flej me gjuhë të lagur nga dhikri dhe do të zgjohesh e flesh pa gjynahe.”⁶

“Me të vërtetë përmendja e Allahut Teala, në mëngjes dhe në mbrëmje është më e dobishme se sa thyerja e shpatave në rrugën e Allahut Teala dhe nga shpërndarja e pasurisë.”⁷

Resulallahu, s.a.v.s., tregon se Allahu Teala ka thënë:

“Kur një rob i Imi më përmend Mua, Unë jam me të. Nëse robi Im më përmend në vete (fshehtë), Unë do ta përmendi atë në Qenien Time (Dhat) në mënyrë të veçantë. Nëse më përmend Mua në një shoqëri, Unë do ta përmendi në një shoqëri edhe më të mirë. Po të më afrohet robi Im Mua një pëllëmbë, Unë i afrohem atij një kut. Po të më afrohet robi Im një kut, Unë atij i afrohem një pash. Po të vijë robi Im kah Unë duke ecur, Unë shkoj kah ai duke vrapuar.”⁸

“Shtatë (lloje njerëzish) Allahu Teala do t’i vendosë nën hijen (mbrojtjen) e Tij, atë Ditë ku nuk do të ketë hije tjetër përveç saj; (njëri prej tyre është) ai që e përkujton Allahun në vetmi dhe i mbushen sytë me lot.”⁹

⁵ Taberani dhe Bejheki nga Muadhi.

⁶ Transmeton Ebul-Kasim Isfahani.

⁷ Enesi me zinxhir të dobët, nga Ibn Omeri. Ibn Abdulberr në *et-Temhid*.

⁸ Buhari dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

Ebu Derda, r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“A doni t’iu jap lajmin se cila nga veprat tuaja është më e mirë te Rabbi juaj, e cila ngrit gradën tuaj më së shumti, e cila është edhe më e mirë se ndihmat e arit dhe të argjendit që i jepni, se vrasja e armiqve përballë jush ose të bërit shehid në luftë me ta? Kjo vepër është të bërit vazhdimisht dhikër Allahun Teala.”¹⁰

Resulallahu, s.a.v.s., tregon se Allahu Teala ka thënë:

“Ai që është i angazhuar duke më përkujtuar Mua (me dhikrin Tim), e nuk gjen kohë të kërkojë nga Unë, do T’i jap më të mirën prej asaj që të tjerët e kërkojnë nga Unë.”¹¹

FJALËT E TË MËDHENJVE TË ISLAMIT NË KËTË ÇËSHTJE

Fudajl ka thënë: *“Na është lajmëruar se Allahu Teala thotë:*

- Robi im! Bëj dhikër një orë pas namazit të sabahut dhe një orë pas namazit të ikindisë, e Unë do të mbroj në mes të atyre dy kohëve.”

Një dijetar ka thënë se Allahu Teala thotë:

“Unë shikoj zemrën e robit Tim; tek cili do rob që në zemër i sundon dhikri Im, Unë do të kujdesem për të, Unë do të jem shoqëruesi i Tij, Unë do të jem bashkëbiseduesi i tij.”

¹⁰ Tirmidhi, Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Ebu Derda.

¹¹ Buhari.

Hasani Basriu ka thënë: *“Dhikri është dy lloj: (1) dhikri për të cilin e di vetëm Allahu Teala dhe ti; ky lloj dhikri ka shpërblim të madh, dhe (2) braktisja e një vepre haram duke përkujtuar Allahun Teala, e ky dhikr është edhe më i mirë.”*

Thuhet se njeriu vdes i etur, përpos atyre që e kanë lagur gojën me dhikër gjatë jetës. Këta, në frymën e fundit nuk janë të etur. Muadh bin Xhebel r.a., ka thënë: *“Xhenetlitë më së shumti do të pendohen për kohën që ju ka kaluar pa dhikër.”*

VLERAT E (TUBIMIT) MEXHLISIT TË DHIKRIT

Resulallahu s.a.v.s. ka thënë:

“Kudo që mblidhet një xhemat dhe bëjnë dhikër (përmendin Allahun), ata rrethohen nga melekët, i mbulon rahmeti hyjnor dhe Allahu Teala u lavdërohet melekëve të tij me ta.”¹²

“Njerëzve që mblidhen në dhikër vetëm për rizanë e Allahut, një telall nga qielli ju kumton:

- Zgjahuni! Ju është falur! Veprat e juaja të këqija i kam zëvendësuar me të mira.”¹³

“Nëse në një mexhlis nuk përmendin Allahun Teala dhe nuk bëjnë salavat për Resulallahun s.a.v.s. me siguri se për ta do të jetë pendim i madh në Ditën e Kijametit.”¹⁴

¹² Muslimi nga Ebu Hurejre.

¹³ Ahmed i nga Enesi.

Davudi a.s., ka thënë: *“Allahu im! Nëse kaloj pranë një mexhlisi të dhikrit dhe vazhdoj tek mexhlisi i të pakujdesshmëve, ma thyej këmbën që të mos arrij tek ata. (Me të vërtetë se) kjo për mua do të jetë një mirësi me të cilën do të më shpërblesh.”*

Në një hadith thuhet:

“Një prezencë në mexhlisin e të devotshmit, i largon dy mijë gabime prej mexhlisit të keq.”¹⁵

Ebu Hurejre r.a., ka thënë: *“Siç i shohin banorët e Tokës yjet duke shkëlqyer në qiell, edhe banorët e qiellit ashtu i shohin duke shkëlqyer shtëpitë ku përmendet Allahu Teala.”*

Sufjan ibn Ujejne, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: *“Kur njerëzit mblidhen dhe bëjnë dhikër, shejtani dhe dynjallëku largohen prej aty. Shejtani i thotë dynjallëkut:*

- A e sheh se çfarë bëjnë këta?!; e dynjallëku i thotë:

- Leji! Kur të shpërndahen, do ti kap një nga një për qafe e do t'i dorëzoj ty.”

Transmetohet se Ebu Hurejre shkoi në treg dhe tha:

- Ju rrii këtu, e mirasi i Resulallahut s.a.v.s., po shpërndahet në xhami. Njerëzit lanë tregun dhe shkuan në xhami por nuk panë të shpërndahet asnjë miras (trashëgimi). Thanë:

- O Ebu Hurejre! Nuk pamë të ndahet miras në xhami. Pamë njerëz që bëjnë dhikër dhe lexojnë Kur'an.

- Ky është mirasi i Resulallahut, s.a.v.s., ju tha Ebu Hurejre.

Transmetohet nga Ebu Hurejre dhe Ebu Seid el-Hudri, se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

¹⁴ Tirmidhiu nga Ebu Hurejre.

¹⁵ Ebu Mensur Dejlemi në ‘Musnedu’l- Firdevs’.

“Allahu Teala ka melekë që udhëtojnë dhe kërkojnë ithtarë të dhikrit, përveç melekëve që shkruajnë veprat (e njerëzve). Kur gjejnë tubimet e dhikrit, thërrasin (njëri-tjetrin):

- Ejani, këtu është ajo që kërkuat!

I rrethojnë me krahë deri në qiell, e Allahu Teala thotë:

- Çfarë po bëjnë robët e Mi? Melekët thonë:

- Po të falënderojnë (tahmid) Ty, po të lavdërojnë (tesbih)

Ty, po të madhërojnë (tekbir) Ty, dhe po të lartësojnë (temxhid) Ty. Allahu Teala i pyeti:

- A me kanë parë ata Mua? Melekët thanë:

- Nuk të kanë parë. Allahu Teala pyeti:

- E si do të ishte po të më shihnin? Melekët thanë:

- Po të të shihnin, edhe më tepër do të të falënderonin, të lavdërojnë, të madhëronin dhe të lartësojnë. Allahu Teala tha:

- E nga çka kërkojnë strehim? Melekët thanë:

- Kërkojnë strehim nga zjarri. Allahu Teala pyeti:

- A e kanë parë zjarrin? Melekët thanë:

- Nuk e kanë parë. Allahu Teala pyeti:

- E si do të ishte po ta shihnin? Melekët thanë:

- Do të iknin edhe më tepër nga zjarri. Allahu Teala pyeti:

- Çka kërkojnë robët e Mi? Melekët thanë:

- Kërkojnë xhennetin. Allahu Teala pyeti:

- A e kanë parë xhennetin? Melekët thanë:

- Nuk e kanë parë. Allahu Teala pyeti:

- E si do të ishte po ta shihnin? Melekët thanë:

- Do ta kërkonin edhe më tepër. Allahu Teala tha:

- Ju jeni dëshmitar se i kam falur. Melekët thanë:

- Në mesin e tyre është edhe filani, që nuk ka ardhë për dhikër, por për punë të veta. Allahu Teala tha:

- ***Kush shoqërohet me këta nuk është i keq; edhe atë (filanin) e fala.***¹⁶

FAZILETI I TEHLIL-it (SHQIPTIMIT TË LA ILAHE ILALLAH)

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Më e mira që e them unë dhe pejgamberët para meje është: ‘*La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh*’ (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe nuk ka partner).”

“Kush thotë: ‘*La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, leahul mulku ve leahul hamdu ve huve ala kul-li shej’in kadir*’ (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe nuk ka partner. Atij i takon sundimi dhe falënderimi. Ai ka fuqi mbi çdo gjë), **100 herë në ditë, shpërblehet sikur të ketë liruuar 10 skllavë, i shkruhen 100 sevape, i fshihen 100 gjynahe, është i mbrojtur prej shejtanit deri në mbrëmje. Askush nuk ka vepruar më mirë se ai, pos atij që e përsërit këtë lutje edhe më shumë.**”¹⁷

“Secili rob që merr abdes në mënyrën më të bukur dhe sipas të gjitha rregullave, e më pas drejton shikimin kah qielli dhe thotë: ‘*Esh’hedu en la ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, ve esh-hedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu.*’ (Dëshmoj që nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Një i vetëm dhe nuk ka partner dhe dëshmoj se Muhammedi (a.s.) është rob i Tij dhe i dërguar i Tij), **do të hapen për të tetë dyer të xhennetit, dhe ai mund të hyjë nga cila derë të dëshirojë.**”¹⁸

¹⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

¹⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

¹⁸ Edu Davud nga Ukbe b. Amir.

“Ata që thonë ‘La ilahe illallah’ në varreza dhe në ditën e Gjykimit nuk do të ndjejnë vetmi dhe frikë. Gati se po i shoh, kur të thirren, si e shkundin dheun nga koka, e thonë: i Lavdëruar qoftë Allahu, i Cili e largoi vuajtjen nga ne, Rabbi ynë, vërtetë falë e dhuron shumë.”¹⁹

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Ebu Hurejres:

- O Ebu Hurejre! Të gjitha veprat e mira që i bën do të peshohen në ditën e Gjykimit, përpos shehadetit ‘La ilahe illallah’. Shehadeti nuk do të peshohet sepse, po të vendoset shehadeti i thënë me sinqeritet në njërin tas të peshores, e në tasin tjetër të vendosen shtatë qiejt dhe shtatë toka, dhe gjithë çka ka në to, tasi me ‘la ilahe illallah’ do të vinte më i rëndë.”²⁰

“Nëse ai që e thotë sinqerisht ‘La ilahe illallah’ vjen edhe me gjynahe sa Toka, Allahu Teala do ta falte.”²¹

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Ebu Hurejres:

- O Ebu Hurejre! Atë që është në shtratin e vdekjes këshilloje të thotë: ‘La ilahe illallah’, sepse shehadeti i shkatërron gjynahet.

¹⁹ Ebu Ya’la dhe Taberani.

²⁰ Fundin e hadithit e shënon Mustagfiri në *ed-Da’vat*. Njihet si hadith *merfu* nga Ebu Seid, dhe e shënon Nesai në *e-Jevm vel-lejle*, Ibn Hibban dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm.

²¹ Në këtë formë është hadith garib, ndërsa Tirmidhi e shënon nga Enesi: ***Allahu Teala thotë: O njeri! Po të më vije me gjynahe të shumta sa Toka e të takohesh me Mua duke mos më përshkruar asgjë për partner, Unë do të vija tek ti me po aq shumë falje.***

- O Resulallah! Kjo për ata që po vdesin, e të gjallët?; pyeti Ebu Hurejre, e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

- ***Të gjallëve edhe më shumë ua shkatërron gjynahet.***²²

“Kush thotë sinqerisht *la ilahe illallah*, hyn në xhennet.”²³

“Vërtetë që të gjithë ju do të hyni në xhennet, përpos atij që refuzon dhe largohet nga rahmeti i Allahut Teala, sikur deveja kur largohet nga kopeja.”²⁴

- *Kush është ai që do të refuzojë e do të largohet nga Allahu Teala?; pyeti dikush, e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:*

- ***Ai që nuk thotë ‘La ilahe illallah’. Prandaj vazhdoni të thoni fjalët ‘La ilahe illallah’ para se të vendoset pengesë mes jush dhe këtyre fjalëve. Këto janë fjalë të tevhidit, sinqeritetit, të frikës nga Allahu, fjalë të bukura, thirrje e të vërtetës, litar i fortë dhe çmimi për xhennet.***

Allahu Teala thotë:

“A mund të jetë shpërblimi i veprës së mirë diç tjetër, pos të së mirës?!” 55-Rahman: 60.

Disa thonë se *vepër e mirë* në këtë botë janë fjalët *la ilahe illallah*, ndërsa e mira në ahiret – xhenneti. E njëjta vlen edhe për këto fjalë të Allahut Teala:

“Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (xhenneti) edhe më tepër (e shohin Allahun).” 10-Junus: 26.

²² Ebu Mensur Dejlemi në ‘*Musnedu’l- Firdevs*’.

²³ Taberani nga Zejd ibn Erkam.

²⁴ Buhari, nga Ebu Hurejre.

Berr ibn Azib tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush thotë dhjetë herë: *‘La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kuli shej’in kadir,’* do të ketë për këtë shpërblim sikur të ketë liruar një skllav; ose ka thënë: ...një person.”²⁵

Amr ibn Shuaib transmeton nga i ati, e ai nga gjyshi i vet, që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush thotë për çdo ditë dyqind herë *‘La ilahe illallahu vahdedu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kuli shej’in kadir,’* askush, as para tij e as pas tij nuk do të mund të bëjë diçka më të mirë se kjo, përpos atij që këtë e thotë edhe më shumë herë.”²⁶

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që në vend publik ose në ndonjë takim thotë: *‘La ilahe illallahu vahdedu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kuli shej’in kadir,’* Allahu Teala do t’ia shkruajë njëmijë hasenate (vepra të mira), do t’ia fshijë njëmijë vepra të këqija, dhe do t’ia ndërtojë një shtëpi në xhennet.”

Gjithashtu, transmetohet se kur robi thotë *“La ilahe illallah”,* kjo i vjen te fleta ku janë të shkruara veprat të tij, dhe sa herë që ndeshet me ndonjë gjynah, e fshinë, deri sa nuk e gjenë një vepër të mirë, si vetja, dhe ulet pranë saj.

²⁵ Hakimi, dhe e konsideron të besueshëm sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit. Gjendet edhe në *‘Musned’* të Imam Ahmedit, por pa fjalët *“dhjetë herë”*,

²⁶ Imam Ahmed bin Hanbel, por në vend të 200, thotë 100 herë. Në atë formë e shënon edhe Hakimi në *Mustedrek*, e zinxhiri i tij i transmetuesve është i mirë.

Në një transmetim të besueshëm, Ebu Ejub tregon që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush thotë dhjetë herë: *‘La ilahe illallahu vahdedu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kuli shej-in kadir’* do të ketë shpërblim për këtë sikur të ketë liruar (nga robëria) katër persona nga pasardhësit e Ismailit, a.s..”²⁷

Gjithashtu nga një transmetim i besueshëm, shënohet se Ubade ibn Samit ka treguar që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush zgjohet natën dhe thotë:

- *La ilahe illallahu vahdedu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kuli shej-in kadir, subhanallahi vel-hamdu lilahi, ve la ilahi illallahu vallahu ekber ve la havle ve la kuvvete illa billahil-alijil-adhim’*, e më pas thotë:

- *Allahumma gfirmi (Allahu im, më fal)*, do t’i falen gjynahet, nëse bën dua, duaja do t’i pranohet, e nëse merr abdes dhe falet, namazi do t’i pranohet.”²⁸

²⁷ Buhariu dhe Muslimi

²⁸ Buhari.

FAZILETI I SHQIPTIMIT TË *SUBHANALLAH, ELHAMDULILLAH* DHE
DHIKREVE TJERË

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush thotë pas secilit namaz 33 herë ‘Subhanallah’ 33 herë ‘Elhamdulilah’ dhe 33 herë ‘Allahu Ekber’ e njëqindëshin e plotëson me ‘La ilahe illallahu vahdedu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kuli shej-in kadir’, do t’i falen gjynahet, qofshin edhe të shumtë sa shkuma e detit.”²⁹

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Ai që gjatë një dite thotë ‘Subhanallahi ve bihamdihi’, (Lavdia i qoftë Allahut dhe Atij i qoftë falënderimit) do t’i hjekën gjynahet, qofshin edhe të shumtë sa shkuma e detit.”³⁰

Një person erdhi te Resulallahu, s.a.v.s., dhe iu ankua për gjendjen e rëndë ekonomike. Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

- ***A nuk bën ti dua si melekët dhe tesbih si njerëzit? Gjithkush në sajë kësaj furnizohet.*** Personi pyeti:

- *Cili është ai tesbih?*; e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

- ***Thuaj 100 herë: ‘Subhanallahi ve bihamdihi sub’hane’llahi’l-adhim estagfirullah!’, prej lajmërimit të agimit deri te falja e namazit të sabahut, dhe dynjaja do të të nënshtrohet, edhe nëse ajo nuk do, e Allahu Teala nga secila fjalë do të krijojë një melek, që do t’i bëjë Allahut tesbih deri në ditën e Gjykimit, ndërsa sevapet e kësaj do të shkruhen ty.***³¹

²⁹ Muslimi, nga Ebu Hurejre.

³⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

³¹ El-Mustagfiri.

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur robi thotë ‘elhamdulillah’ për herë të parë, mbushet hapësira në mes të qiellit dhe Tokës; kur thotë ‘elhamdulillah’ për herë të dytë, mbushet hapësira prej nën tokës deri në qiellin e shtatë, e kur thotë ‘elhamdulillah’ për herë të tretë, Allahu Teala thotë: ‘Kërko çfarë të duash, atë do ta kesh’.”³²

Rufaijetu’z-Zarki tregon: *“Po falnim namaz me Resulallahun, s.a.v.s.. Kur u drejtua nga rukuja e tha ‘semiallahu limen hamideh’, dikush mbrapa tij tha ‘rabbena lekel-hamdu hamden kethiren tajjiben mubareken fih’.* Kur Resulallahu, s.a.v.s., e përfundoi namazin, pyeti:

- **Kush i tha ato fjalë më herët?, e pastaj tha:**

- **Pashë mbi tridhjetë melekë që garonin cili më parë t’i shënojë.”³³**

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Veprat e mira që zgjasin janë ‘La ilahe illallah, ‘Subhanallah’, ‘Elhamdulillah’, ‘Allahu Ekber’ dhe ‘La havle ve la kuvvete ila billah’.”³⁴

Omeri, r.a., transmeton se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Nuk ka në Tokë dikush të thotë ‘La ilahe illallah, Subhanallah, Elhamdulillah, Allahu Ekber, dhe La havle ve la kuvvete ila billah, e të mos i falen gjynahet, qofshin edhe sa shkuma e detit.”³⁵

³² Në këtë formë është hadith garib.

³³ Buhari.

³⁴ Nesai dhe Hakimi nga Ebu Hurejre.

³⁵ Hakimi nga Abdullah ibn Amr, dhe thotë se i plotëson kriteret e Muslimit. Shënon edhe Tirmidhi, që e konsideron hasen.

Numan ibn Beshir tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ata, që në mendje e kanë madhështinë e Allahut Teala dhe të cilët e madhërojnë me tesbih, tahmid e tekbir, (pra thonë: Subhanallah, Elhamdulillah dhe Allahu Ekber) ai dhikr i tyre sillet rreth Arshit dhe i jep zë i cili përngjanë në gumëzhimën e bletëve, duke kujtuar kështu Krijuesin e vet. A nuk doni ju që te Allahu Teala të keni gjithmonë diçka me të cilën Ai do t’ju kujtojë?”³⁶

Ebu Hurejre r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Të them ‘Subhanallah ve’l-hamdulillah ve la ilahe illallahu vallahu ekber’ më është më e dashur se gjithçka që Dielli e ndriçon”; e në transmetimin tjetër:

“...edhe ‘La havle ve la kuvvete ila billah’ kjo është më e mirë se dynjallëku me krejt çfarë ka në të.”³⁷

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Katër fjalë janë më të dashurat për Allahun Teala: ‘Subhanallah, Elhamdulillah, La ilahe ilallah dhe Allahu Ekber’ dhe nuk pengon me cilën do prej tyre të fillosh.”³⁸

Ebu Malik Esh’ari tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Pastërtia është gjysma e imanit. ‘Elhamdulillah’ e plotëson mizanin (peshoren), e ‘Subhanallah’ dhe ‘Allahu Ekber’ e plotësojnë hapësirën në mes të qiellit dhe Tokës, namazi është nur, sadakaja është dëshmi, durimi ndriçon, e Kur’ani Kerim është dëshmi në dobi tënden, ose kundër teje.

³⁶ Ibn Maxhe

³⁷ Muslimi

³⁸ Muslimi.

Kur njerëzit në mëngjes nisen për në punë, ose e shesin nefsin dhe kështu e shkatërrojnë, ose e blejnë (nefsin) dhe kështu e lirojnë.”³⁹

Ebu Hurejre, r.a., tregon që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Dy fjali janë të lehta në gjuhë, të rënda në peshore, e të dashura për Allahun Teala, e ato janë: ‘Subhanallah ve bihamdihi’ dhe ‘subhanallahil-adhim.’”⁴⁰

Transmetohet se Ebu Dherr r.a., pyeti se cilat fjalë janë më të dashurat për Allahun, e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

- Fjalët që Allahu Teala i zgjodhi për melekët e vet: ‘Subhanallah ve bihamdihi, subhanallahil-adhim’.⁴¹

Ebu Hurejre r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Vërtetë që Allahu Teala i ka zgjedhur katër fjalë: Subhanallah, Elhamdulillah, La ilahe illallah dhe Allahu Ekber. Kur robi thotë ‘Subhanallah’, do t’i shkruhen njëzet vepra të mira e t’i fshihen njëzet të këqija, kur thotë ‘Allahu Ekber’ do të ketë shpërblim të njëjtë.”⁴²

Xhabiri tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i thotë fjalët ‘Subhanallahi ve bi hamdihi,’ do t’i mbillet një palmë e hurmasë në xhennet.”⁴³

³⁹ Muslimi

⁴⁰ Buhariu dhe Muslimi.

⁴¹ Buhariu dhe Muslimi.

⁴² Nesai.

⁴³ Tirmidhi.

Disa të varfër erdhën te Resulallahu, s.a.v.s., e i thanë:

- *Të pasurit po shpërblehen më shumë se ne, e ata falin namaz sikur ne, agjërojnë sikur ne, pos që tepicën e pasurisë e ndajnë për sadaka; e Resulallahu, s.a.v.s., ju tha:*

- ***A nuk ju la Allahu Teala atë me të cilën edhe ju do ta arrini shpërblimin e sadakasë; ju keni sadaka për secilën ‘Subhanallah’ që e thuani, për ‘La ilahe illallah’, për ‘Allahu ekber’, për urdhërimin e të mirës, për largim nga e keqja, për secilën kafshatë që i vendosni në gojë familjarëve, bile për ju sadaka është edhe marrëdhënia me gruan; sadaka për secilin durim tuajin.***

- *O Resulallah! A do të ketë shpërblim edhe për kënaqjen e epshit?; pyetën, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- ***Çfarë mendoni, nëse ka marrëdhënie me dikë që e ka të ndaluar, a do të ishte gjynahqar?***

- *Natyrisht!; i thanë, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- ***Njëjtë, edhe në marrëdhënie të lejuar ka sevap.***⁴⁴

Sipas një transmetimi, Ebu Dherr i tha Resulallahut, s.a.v.s.:

- *O Resulallah, të pasurit kanë përparësi në shpërblim; ata lexojnë njëjtë si edhe ne, por ata ndajnë nga pasuria, e ne jo; e Resulallahu, s.a.v.s., i tha:*

- ***Unë do të mësoj një veprim ty që, nëse e bën, do t’i arrish ata që ishin para teje e do t’i kalosh ata që vinë pas teje, përpos atyre që e veprojnë të njëjtën; pas secilit namaz, lexo 33 herë Subhanallah, 33 herë Elhamdulillah dhe 34 herë Allahu ekber.***⁴⁵

⁴⁴ Muslimi, nga Ebu Dherr.

⁴⁵ Ibn Maxhe.

Busre transmeton se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Vazhdoni me *tesbih*, *tehlil* dhe *takdis* e mos u bëni të pakujdesshëm në këtë! Për të mos u habitur, përdorni gishtat, sepse në ditën e Gjykimit ata do të dëshmojnë.”⁴⁶

Ibn Omeri thotë se e ka parë Resulallahun, s.a.v.s., duke bërë *tesbih* me gishta.⁴⁷

Ebu Hurejre dhe Ebu Seid el-Hudri tregojnë se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur robi thotë ‘*la ilahe illallahu vallahu ekber*’, Allahu Teala thotë:

- *Të vërtetën e flet robi Im; vetëm Unë jam Allah që meritoj ibadet, nuk ka zot tjetër përpos Meje, Unë jam më i madhi (Ekber). Kur robi thotë:*

- *La ilahe ilallahu vahdehu la sherike leh*, Allahu Teala thotë:

- *Të vërtetën e flet robi Im; vetëm Unë jam Allah, dhe Unë nuk kam rival, as ortak*. Kur robi thotë:

- *La ilahe illallah dhe La havle ve la kuvvete ila billahi*, Allahu Teala thotë:

- *Të vërtetën e flet robi Im; fuqinë dhe forcën vetëm Unë i posedoj*. Kush i thotë këto fjalë në momentin e vdekjes, nuk do ta arrijë flaka e xhehenemit.”⁴⁸

⁴⁶ Ebu Davud dhe Tirmidhiu.

⁴⁷ Fjalët e Abdullah ibn Amr el-As, që i shënon Ebu Davud, Nesai dhe Tirmidhi, që thotë së është hadith hasen, si edhe Hakimi.

⁴⁸ Tirmidhi.

Mus'ab b. Sad tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

- **A jeni të pafuqishëm për të fituar çdo ditë njëmijë sevape?**
- *Si bëhet kjo?*; pyetën, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:
- **Secilën ditë do të thoni 100 herë Subhanallah dhe për këtë ju shkruhen 1000 sevape dhe ju fshihen 1000 gjynahe.**⁴⁹

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Abdullah ibn Kajs:

- **A dëshiron të të udhëzoj në thesarin e xhennetit?**
- *Natyrisht!;* i tha ky, e Resulallahu, s.a.v.s., i tha:
- Thuaj: **“La havle ve la kuvvete ila billah”.**⁵⁰

Ebu Hurejre tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“A ta mësoj një veprim që është thesari i nën Arsh-it dhe i xhennetit? Është fjala ‘La havle ve la kuvvete ila billah’. Kur robi e thotë këtë, Allahu Teala thotë: ‘Robbi Im u dorëzua dhe e pranoi islamin’.”⁵¹

“Ai që çdo mëngjes thotë: Reditu bil-lahi rabben ve bil islami dinen ve bil Kur’ani imanen ve bi Muhammedin, sallellahu alejhi vesel-leme nebijjen ve resula. (Jam i kënaqur që Allahu është Rabbi im, që islami është feja ime, që Kur’ani është udhëzuesi im dhe që Muhammedi, s.a.v.s., është peygamberi im dhe i dërguar i Allahut), Allahu Teala ka marrë mbi Vete obligimin që ta gëzojë në ditën e Gjykimit”⁵²; e në version tjetër:

...Allahu Teala do të jetë i kënaqur me të.

⁴⁹ Shënon Muslimi, por aty thuhet: *“i shkruhen 1000 vepra të mira ose i fshihen 1000 të këqija.”*

⁵⁰ Buhariu dhe Muslimi.

⁵¹ Nesai dhe Hakimi.

⁵² Ebu Davud, Nesai dhe Tirmidhi .

Muxhahidi ka thënë: “Kur njeriu del nga shtëpia dhe thotë: ‘Bismillah’, meleku thotë: ‘Ti je në rrugë të drejtë’. Kur thotë: ‘Tevekkeltu ala’llah’ (U mbështeta në Allahun Teala), meleku thotë: ‘Kjo të mjafton’. Kur thotë: ‘La havle ve la kuvvete ila billah’, meleku thotë: ‘Je i mbrojtur’. Atëherë shejtanët largohen nga ai person, the thonë: ‘Çfarë doni nga ai person? Ai është në rrugë të drejtë, atij i mjafton Allahu Teala dhe është i mbrojtur, kështu që nuk keni mënyrë si t’i afroheni’.”

Ndoshta dikush mund të pyes: “Përse dhikri, edhe pse aq i thjeshtë e i lehtë, është aq i vlefshëm e i dobishëm dhe më i mirë se ibadetet tjera që kërkojnë shumë më shumë angazhim?”,

atëherë dije se arritja e hakikatit të kësaj është i lidhur për diturinë *mukashefe*. Ne këtë fakt mund ta shpjegojmë në diturinë muamele. Sa për sasinë e dhikrit, duhet ditur që dhikri efikas e i dobishëm është vetëm ai që bëhet rregullisht dhe me prezencë maksimale të zemrës. Dhikri me gjuhë, deri sa zemra është e pakujdesshme dhe endacake, sjell dobi të pakët. Për këtë flasin edhe hadithet.⁵³ Njëjtë edhe prania dhe zgjimi i zemrës gjatë dhikrit duke iu lëshuar dynjallëkut, sjell dobi të pakët. Zgjimi i vazhdueshëm dhe prania e zemrës, bashkë me vetëdijen për Allahun Teala, aq sa kjo është e mundur, kjo është çfarë ka përparësi në raport me ibadetet tjera. Kjo në fakt është qëllim dhe rezultat i ibadeteve praktike.

⁵³ Tirmidhi, dhe thotë që është hasen, dhe Hakimi, që thotë se ka zinxhir të besueshëm, nga Ebu Hurejre.

Dhikri ka fillimin dhe përfundimin e vet. Fillimi i tij sjell gëzim e dashuri, e ky gëzim dhe dashuri domosdo paralajmërojnë edhe përfundimin e vet, që vjen si rezultat i atij gëzimi dhe dashurie, dhe kjo është ajo që kërkohet. Sepse, në fillim, muridi mund të ketë vështirësi në përpjekjen që zemrën dhe gjuhën e vet ta largojë nga vesveset e shejtanit e t'i kthejë kah kujtimi i Allahut Teala. E nëse ka sukses në vazhdueshmëri të kësaj, do të mësohet me dhikr e në zemër do t'i mbijë dashuria për Atë që përmendet. Kjo nuk është aspak e pazakontë, sepse ne jemi dëshmitarë që kur para dikujt përmendet personi që nuk është prezent dhe theksohen cilësitë e tij të mira, kjo te dëgjuesi zgjon dashuri për atë person, bile dëshiron të dëgjojë më shumë për të dhe për cilësitë e tij të mira. Kur te ai të lind dashuria për përmendje të shpeshtë, e cila në fillim mund të jetë e vështirë, më vonë detyrohet të përmend shpesh dhe nuk mund ta shpërfillë, sepse kur dikush dashuron diçka, atë edhe e përmend shpesh, e ai që përmend diçka shpesh, dashurohet në atë, pa marrë parasysh sa e vështirë ajo përmendje të jetë. Njëjtë edhe me dhikrin; në fillim është i vështirë dhe i rëndë, deri sa arrin kënaqësinë dhe dashurinë, e më vonë, nuk mund ta braktisë. Kështu, shkaku bëhet pasojë. Fruta jep frutë. Ky është kuptimi i fjalëve: *“Kisha vështirësi me Kur'anin për njëzet vite, e pastaj u kënaqa me të për njëzet vite.”*

Kënaqja mund të vijë vetëm si rezultat i gëzimit dhe dashurisë, ndërsa gëzimi vjen vetëm si pasojë e vazhdueshmërisë afatgjate në vështirësi. E kur vazhdueshmëria dhe durimi të bëhen pjesë e natyrës njerëzore, si të largohet kjo më pastaj?

Njëjtë është edhe rasti kur personi nuk dëshiron të hajë ndonjë ushqim të caktuar. Në fillim e konsumon me vështirësi, mirëpo nëse vazhdon, kjo i bëhet pjesë e natyrës së tij e më vonë as nuk mundet pa të. Nefsi i njeriut mësohet dhe e duron atë me çfarë ngarkohet. I tillë është nefsi, përshtatet në atë me çfarë ti e mëson, dhe ajo me çfarë ti e mëson, në fund bëhet pjesë e natyrës së tij. Kur personi mësohet me dhikrullah, largohet nga gjithçka tjetër pos dhikrit, sepse ai e di se gjithçka përpos Allahut Teala, do ta braktisë kur ky të vdes. Me të në varr nuk shkojnë as familja e tij, as pasuria, as pasardhësit, as fuqia. Do të mbetet vetëm dhikri, prandaj nëse mësohet me të, do të kënaqet me të e do të ëmbëlsohet atëherë kur gjithçka tjetër ta braktisë, sepse nevojat njerëzore në këtë jetë e largojnë njeriun nga dhikri, e me vdekje këto nevoja i zhduken e bëhet sikur ai që mbetet vetëm me atë që dashuron, dhe kështu largohet nga ky burg që ishte pengesë mes tij dhe asaj që i ofron kënaqësi.

Në një hadith, Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Xhebraili, ose Allahu Teala (drejtpërdrejtë), e vendosi këtë në zemrën time: ‘Dashuro çka të duash, në fund do të ndahesh. Jeto sa të duash, në fund do të vdesësh. Vepro si të duash, në fund do të përgjigjesh’.”⁵⁴

Do të braktis gjithçka që ndërlidhet me dynjallëk. Kjo e pret secilin me vdekje. Gjithçka që është në Tokë është i vdekshëm, vetëm Allahu është i Përhershmi (*Baki*).

⁵⁴ Hadithi është përmendur në *Librin për diturinë*.

Dynjallëku i ndërpritet personit me vdekje, por vazhdon ngritja në afërsinë e Allahut, sepse në saje të dhikrit realizohet takimi (mes Allahut Teala dhe atij që bën dhikër) e kjo do të ndodhë kur të ngjallet prej varrit dhe kur në pah të del ajo çfarë kishte fshehur në zemra. Dikush mund të pyes se si dhikri mbetet me të e ai vet shndërrohet në asgjë, por ndalimi i ekzistimit të njeriut me vdekjen e tij nënkupton privim nga kjo dynja dhe nga bota e dukshme, por jo edhe nga bota e melekutit. Këtë e tregon edhe hadithi:

“Varri është ose një gropë e xhehenemit ose një bahçe e xhennetit”⁵⁵; si edhe:

“Shpirtat e shehidëve janë në mes të krahëve të zogjve të gjelbër.”⁵⁶

Resulallahu, s.a.v.s., i thirri me emra mushrikët e vrarë në betejën e Bedrit, e ju tha:

- *A u vërtetuat në vuajtjen që ju premtoi Allahu? Unë u vërtetova në premtimin (ndihmën) e Rabbit im!*”

Kur Omeri, r.a., i dëgjoi këto fjalë, tha:

- *O Resulallah! Si do të dëgjojnë ata, e si do të përgjigjen?*; e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- *Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, ju nuk dëgjoni asgjë më shumë se ata, vetëm se ata nuk janë në gjendje të përgjigjen.*⁵⁷

⁵⁵ Tirmidhi, nga Ebu Seid.

⁵⁶ Muslimi, nga Ibn Mesud.

⁵⁷ Muslimi, nga Enesi.

Të gjitha këto dëshmojnë qartë se vdekja nuk është zhdukje. Ky hadith gjendet në *Sahih* dhe ka të bëjë me mushrikët, ndërsa për besimtarët dhe shehidët, Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Shpirtat e tyre janë në gushë të zogjve të gjelbër, dhe të varur nën Arsh.”⁵⁸

Ky rast, dhe ajo që e tregojnë këto fjalë, nuk e përjashtojnë dhikrin. Allahu Teala thotë:

“Kurrresi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Rabbi i tyre.

Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij, dhe atyre që kanë mbetur ende pa ju bashkuar radhëve të tyre, u marrin myzhde se për ta nuk ka as frikë dhe as që kanë pse të brengosen.” 3-Ali Imran: 169, 170.

Nga nderi ndaj dhikrit, Allahu Teala e ngriti gradën e shehidëve, sepse fryma e fundit është i kërkuari, pra duke ndërprerë interesimin për dyjallëk dhe çdo gjë me tërë ekzistencën, i drejtohet Allahut.

Prandaj, nëse robi është në gjendje që interesimin dhe angazhimin e vet ta drejtojë vetëm kah Allahu Teala, atëherë nuk mund të vdes ndryshe përpos në luftë me armikun sepse ai, në atë mënyrë, nga zemra e vet e ka larguar mallin, e familja e tij, pasuria dhe fëmijët, bile as krejt dynjaja, nuk janë objekt i dëshirave dhe ambicieve të tij.

⁵⁸ Ibn Maxhe, nga Ka'b ibn Malik.

Ky dynjallëk i duhet vetëm për shkak të jetesës, ndërsa dashuria ndaj Allahut Teala dhe kërkimi i kënaqësisë së Tij ka lënë pa vlerë jetën e tij. Nuk ka përkushtim më të lartësuar ndaj Allahut Teala se kjo dhe, pikërisht për këtë, shehadeti është aq i lartësuar dhe për faziletin e tij ka shumë ajete dhe hadithe. Kur Abdullah ibn Amr Ensari ra shehid në Uhud, Resulallahu, s.a.v.s., i tha Xhabirit:

- **A dëshiron të të gëzoj?!;** e Xhabiri tha:

- *Natyrisht që dua, o Resulallah, Allahu të gëzoftë ty me të gjitha të mirat e Tij!* Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **Allahu Teala e ngjalli babanë tënd dhe e mori afër Vetes, dhe i thotë: “Robi Im! Kërko nga Unë çfarë të duash, do ta plotësoj dëshirën”, e ai përgjigjet: “O Rabbi im! Më kthe në dynja e të vritem prapë në rrugën Tënde para pejgamberit Tënd.” Allahu Teala tha: “Unë tashmë e kam caktuar se nuk ka kthim në dynja.”**⁵⁹

Vdekja është shkaktar i këso përfundimi dhe i kësaj gjendje, por sikur njeriu të mos vritej në rrugë të Allahut e po të mbetej në dynja për një kohë, ndoshta zemra përsëri do t'i angazhohej në kënaqësitë e kësaj bote, që mund t'ia kalojnë angazhimin të tij me dhikër. Për këtë arsye arifët aq shumë i frikësohen përfundimit të jetës, sepse zemra është e rrotullueshme edhe kur është në dhikër, prandaj gjithmonë mund të kthehet kah dynjallëku.

⁵⁹ Tirmidhi, Ibn Maxhe dhe Hakimi nga Xhabiri.

Prandaj, nëse në përfundim të jetës të tij në dynja në zemër i theksohet diçka nga dynjaja dhe e pushton, e në këso gjendje e lëshon këtë botë, ekziston frika që kjo t'i mbetet edhe pas vdekjes, e ky të dëshirojë kthimin në dynja, që për të nuk do të ishte shenjë e mirë. Njeriu vdes me atë në çka e ka kaluar jetën e kësaj bote, dhe ashtu edhe do të ringjallet. Prandaj mbrojtja më e mirë nga përfundimi i padëshiruar në këtë botë është shehid në rrugë të Allahut, përpos nëse lufton me qëllim që të fitojë dobi materiale ose reputacion, për çka ekzistojnë edhe transmetime.⁶⁰ Qëllim i shehidit është dashuria ndaj Allahut Teala dhe dëshira që fjala e Allahut të jetë më së larti. Për këtë flet ajeti Kur'anor:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit.” 9-Tebue: 111

Personi i tillë e ka shitur dynjanë për ahiret. Kjo gjendje e shehidit i përshtatet fjalëve ‘*La ilahe illallah*’, sepse shehidi nuk dëshiron asgjë tjetër pos Allahut Teala. Shehidi, me shehadetin e vet thotë: “*Nuk ka zot pos Allahut*”, sepse ai nuk dëshiron asgjë tjetër, përpos Allahun.

Ai që këtë e thotë me gjuhë, por kësaj nuk i përshtatet gjendja (*hal*) e vet, puna e tij është nën vullnetin e Allahut, nëse do e fal, nëse do e dënon dhe ai nuk është pa rrezik. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., i dha përparësi fjalëve (dhikrit): ‘*La ilahe illallah*’ në krahasim me dhikret tjera.

⁶⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Musa.

Për këtë, Resulallahu, s.a.v.s., flet në përgjithësi, kur i inkurajon myslimanët të bëjnë vepra të mira, e më pas, e përmend edhe kur flet për sinqeritetin dhe nijetin e pastër. Prandaj në një rast thotë:

- ***Ai që sinqerisht*** (muhlisan) ***thotë: “La ilahe illallah”,*** sepse sinqeriteti do të ndihmojë të përshtatet gjendja e personit me fjalët që i thotë. E kuptimi i sinqeritetit është bashkimi i gjuhës me gjendjen.

Dëshirojmë nga Allahu Teala që me gjuhë dhe me gjendje, me të brenshmen (*batin*) dhe me të jashtmen (*zahir*) në frymën e fundit të jemi në mesin e atyre që thonë: ‘*La ilahe illallah*’, ashtu që të mos kthehemi kah kjo dynja, por t’ia kthejmë shpinën asaj e të dëshirojmë takim me Allahun Teala. Ai që dëshiron takim me Allahun, edhe Allahu dëshiron takim me të, e kush përbuzë takimin me Allahun, edhe Allahu përbuzë takimin me të.

Kapitulli i dytë

**EDEBI I DUASË, VLERAT E SAJ, DISA DUA TË RESULALLAHUT,
S.A.V.S., SI EDHE VLERAT E ISTIGFARIT DHE TË SALAVATIT
DËRGUAR RESULALLAHUT, S.A.V.S.**

VLERAT E LARTA TË DUASË

AJETET NË KËTË TEMË

Allahu Teala thotë:

“E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua.” 2-Bekare: 186

“Luteni Rabbin tuaj të përlur e në heshtje, pse Ai nuk i do ata që e teprojnë.” 7-Araf: 55

“Rabbi juaj ka thënë: *“Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që mendjemadhësohen e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar”*40-Gafir: 60

“Thuaj: *Thërrisni Allah ose thërrisni Rrahman, me cilindo emër që ta thërrisni, emrat e Tij janë më të bukurit.*” 17-Isra: 110

Numan ibn Beshir tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

- *Duaja, vërtetë është ibadet; e më pas lexoi ajetin:*

“Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem!” (40: 60)⁶¹

⁶¹ Autorët e Sunnenit, Hakimi, që thotë se ka zinxhir të besueshëm, dhe Tirmidhi, që thotë që është hasen-sahih.

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Duaja është palca e ibadetit”⁶²,

“Te Allahu asgjë nuk ka më shumë vlerë se duaja”⁶³,

“Vërtetë që nga duaja robi do të fitojë njërën prej këtyre trijave: ose do t’i falet një gjynah, ose do t’i dhurohet një e mirë në këtë botë, ose ajo e mirë do ta presë në ahiret.”⁶⁴

Ebu Dherr thotë: *“Duaja e ibadeti janë si buka e kripa.”*

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Pritja e lehtësimit është ibadet i pëlqyeshëm.”⁶⁵

ADABI I DUASË

Duaja ka dhjetë adabe:

1. Kërkimi i kohës së vlefshme (e të veçantë): ditët e Arefe (*Jevm Arefe*) brenda vitit, ditët e Ramazanit brenda muajve, xhumaja brenda javës dhe koha para agimit për çdo natë:

“Dhe në syfyr (kah mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkatet.”⁵¹-Dharijat: 18,

e Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

⁶² Tirmidhi, nga Enesi.

⁶³ Tirmidhi

⁶⁴ Dejlemi në ‘*Musnedu’l-Firdevs*’

⁶⁵ Tirmidhi, nga Ibn Mesud.

“Çdo natë, Allahu Teala lëshohet në qiellin më të afërt të dynjasë, kur mbetet pjesa e tretë e natës, e thotë:

- A ka dikush të më bëj dua Mua, e t’ia pranoj; a ka dikush të kërkojë diçka nga Unë, e t’ia dhuroj; a ka dikush të kërkojë falje nga Unë, e t’ia fali.”⁶⁶

Kanë treguar që Jakubi a.s., ju tha fëmijëve të vet:

"Më vonë do t'ia kërkoj Rabbit tim faljen tuaj",
(12-Jusuf: 98), dhe e la ta bëjë duanë para agimit. U ngrit, lexoi duanë, fëmijët e tij bënë amin pas tij, e Allahu Teala shpalli:

"I fala dhe i bëra peygamber.";

2. Të përfitohet nga raste të vlefshme. Ebu Hurejre, r.a., ka thënë: *"Dyert e qiellit hapen me rastin e përparimit të ushtrisë në rrugë të Allahut, me rastin e shiut të hairit, me rastin e kryerjes së namazeve farz. Prandaj përfitoni nga këto raste për t'i bërë dua Allahut Teala."*

Muxhahidi ka thënë: *"Namazi është i caktuar në kohët më të mira. Prandaj, pas namazit bëni dua Allahut Teala."*

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

"Duaja në mes ezanit dhe ikametit nuk refuzohet"⁶⁷,

si edhe:

"Agjëruesit nuk i refuzohet duaja."⁶⁸

⁶⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

⁶⁷ Ebu Davud, Nesai dhe Tirmidhiu nga Enesi.

⁶⁸ Tirmidhi.

Vlefshmëria dhe veçoria e momenteve të caktuara ndërlihet me vlefshmërinë e rastit, sepse koha në pjesën e fundit të natës është koha kur zemra është e pastër dhe larg nga ajo çfarë mund të turbullojë pastërtinë e saj; dita e Arefes dhe xhumaja (e premtja) janë ditë kur njerëzit mblihen dhe i drejtohen Allahut, duke kërkuar rahmetin e Tij. Kjo është vetëm një nga arsyet e veçimit dhe vlefshmërisë së disa momenteve, krahas arsyeve tjera në të cilat njeriu nuk ka çasje. Gjithashtu, gjendja e sexhdes është një nga rastet ku dua ja pranohet. Ebu Hurejre, r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Robi është më së afërti Rabbit të vet deri sa është në sexhde. Prandaj, deri sa jeni në sexhde, bëni shumë dua Allahut Teala!”⁶⁹, si edhe:

“Më është ndaluar të lexoj Kur’an sa jam në ruku dhe sexhde; në ruku madhëroni Allahun (lexoni: *Subhane rabbijel-adhim*), e në sexhde mundohuni të bëni sa më shumë dua! Kjo është gjendje e përshtatshme për pranim të duasë.”⁷⁰;

3. Kur lexon duanë të kthehet kah kibla dhe të ngrisë duart lartë, ashtu që të shihet bardhësia e sqetullës. Xhabir ibn Abdullah tregon se Resulallahu, s.a.v.s., erdhi në Arafat, u kthye kah kibla dhe i bëri dua Allahut Teala deri në perëndim të diellit.⁷¹

⁶⁹ Muslimi.

⁷⁰ Muslimi.

⁷¹ Muslimi, por në vend të fjalës *jed’u* (*bëri dua*) është përdorë fjala *vakfjfen* (*qëndroi*). Shënon edhe Nesai, nga Usame ibn Zejd, me transmetues të besueshëm.

Selmani tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Vërtetë që Rabbi juaj është i turpërueshëm dhe bujar; turpërohet nga robët e Tij, kur i drejtojnë duart kah Ai, që t’i kthejë zbrazët.”⁷²

Enesi r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., kur bënte dua i ngriste duart aq sa i shihej bardhësia nën sqetull, dhe nuk bënte shenjë me gisht.⁷³

Ebu Hurejre, r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., po kalonte pranë një personi që po bënte dua dhe bënte shenjë me të dy gishtat tregues, e i tha: **“një, një!”**; pra, mjafton një gisht.

Ebu Derda, r.a., ka thënë: *“Ngritni ato duar për dua para se të lidhen me zinxhirë.”*

E kur duaja të përfundojë, me duar duhet përkëdhelë fytyrën. Omeri, r.a., ka thënë: *“Kur Resulallahu, s.a.v.s., i ngriste duart me rastin e bërjes dua, nuk i lëshonte poshtë para se të fërkojë me to fytyrën e vet.”⁷⁴*

Ibn Abbassi ka thënë: *“Resulallahu, s.a.v.s., kur bënte dua, i afronte shuplakët dhe anën e brendshme të shuplakave e afronte te fytyra.”*

⁷² Ebu Davud dhe Tirmidhi

⁷³ Muslimi, por pa fjalët *“nuk bënte shenjë me gisht.”*

⁷⁴ Tirmidhi, që thotë se është *garib*, dhe Hakimi në *Mustedrek*.

Këto janë pozitat e duarve kur bëhet dua. Shikimin nuk duhet drejtuar kah qielli. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Ata që drejtojnë shikimin kah qielli gjatë duasë, duhet ta brakëtisnin këtë adet, përndryshe ju merret drita e syrit”⁷⁵;

4. Duaja bëhet me zë të ultë, pra fshehur. Ebu Musa Esh’ari tregon: *“Ishim duke u kthyer nga një udhëtim me Resulallahun, s.a.v.s., e kur iu ofruam Medines, tha: “**Allahu Ekber**”, e gjithkush me zë të lartë tha: “**Allahu Ekber**” e (në këtë) Resulallahu s.a.v.s., tha:*

- O njerëz, Ai të cilit i drejtoheni dhe i bëni dua nuk është as i shurdhër as jo-prezent. Ai të cilit i drejtoheni dhe i bëni dua është mes jush dhe vazhdimisht ju përcjellë.”⁷⁶

Duke folur për kuptimin e ajetit Kur’anor:

“E ti mos ngrit zërin (duke lexuar) në namazin tënd, po as mos e ul tepër në të, mes kësaj kërkoje një rrugë mesatare”
(17-Isra: 110), Ajshe r.a., thotë që kjo ka të bëjë me drejtimin e duasë Allahut Teala.

Allahu Teala e lavdëroi peygamberin Zekeria, a.s.:

“Kur ai iu lut Rabb-it të vet me një zë të ulët...”

19-Merjem: 3

E me një ajet tjetër thotë:

“Luteni Rabbin tuaj të përlur e në heshtje...”

7-Araf: 55

⁷⁵ Muslimi, nga Ebu Hurejre, dhe thotë se kjo ka të bëjë me duanë në namaz.

⁷⁶ Buhariu dhe Muslimi në formë më të gjatë, nga Ebu Davud.

5. Në dua duhet të ruhem nga fjalë të pasinqerta dhe formaliteti. Ai që bën dua është si lypësi në derë; duhet të kërkojë me modesti dhe përulësi, dhe pa teprim. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Do të vijë një popull që do t’i kalojë kufijtë (do ta teprojë) në dua”⁷⁷, e për fjalët në ajetin:

“Ai, me të vërtetë, nuk i do ata që e kalojnë kufirin.”

(7: 55), disa thonë se mendohet në ata që i rimojnë duatë. Allahu Teala nuk i do ata. Prandaj më së miri është të kufizohet në duatë tradicionale që vijnë nga as’habët, sepse personi në dua mund ta kalojë kufirin e të kërkojë nga Allahu Teala atë që nuk është në interesin e tij. Prandaj Muadh ibn Xhebel r.a., ka thënë: *“Banorët e xhennetit do të kenë nevojë për dijetarë, sepse do t’ju thuhet të kërkojnë çfarë të dëshirojnë, e ata nuk do të dinë të shprehen deri sa dijetarët t’i mësojnë.”*

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Assesi mos u mundoni që domosdo ta bëni duanë me rimë. Mjafton të thuani: ‘Allahu im! Nga ti kërkoj xhennetin, dhe veprën e fjalën që do të më afrojë xhennetit, dhe tek Ti kërkoj mbrojtje nga xhehenemi, dhe nga vepra e fjala që do të më afrojnë xhehenemit.’ (Allahumme inni es-elekel-xhennete ve ma karrebe ilejha min kavlin ve amelin, ve eudhu bike minen-nari ve ma karrebe ilejha min kavlin ve amelin.)”⁷⁸,

⁷⁷Ebu Davud, Ibn Maxhe, Ibn Hibban dhe Hakimi, nga Abdullah ibn Mugaffel.

⁷⁸Në këtë formë është garib. Buhari transmeton nga Ibn Abbas më ndryshe, si dhe Ibn Maxhe dhe Hakimi, që thotë se ka zinxhir të besueshëm, nga Ajshe, r.anha.

e në një hadith tjetër thuhet:

“Do të vijë një popull që do t’i kalojë kufijtë (do ta teprojë) në dua dhe pastrim.”⁷⁹

Njëri nga gjenerata e parë (*selefi salihin*), po kalonte pranë një ligjëruesi që po bënte dua, e rimat i përdorte sa për formalitet, e i tha: *“Si mund t’i bësh dua Allahut Teala sa për formalitet?!”*

E kam parë Habib el-Axhmi si bën dua, e nuk i shtonte më shumë fjalëve: *“Allahu im, mos na turpëro në ditën e Gjykimit! O Allahu im, na ndihmo në punë të mira!”*, e edhe të tjerët lexonin duanë e njëjtë pas tij, sepse njihej si person që duaja i pranohej.

Dikush ka thënë: *“Duaja duhet të bëhet me modesti dhe përulësi, e jo me fjalë të rimuara.”*

Thonë se dijetarët dhe disa nga evliatë në dua nuk përdorin më shumë se shtatë fjali. Këtë na e mësojnë edhe ajetet e fundit të sures *Bekare*, sepse Allahu Teala nuk i shpalli robëve të Vet asnjë dua më të gjatë. Vargjet e rimuara kërkojnë fjalë të pasinqerta. Duaja në këtë stil gjuhësor nuk përputhet me gjendjen e atij që bën dua.

Në duatë tradicionale që transmetohen nga Resulallahu, s.a.v.s., ka harmoni, mirëpo ajo harmoni nuk është e rimuar, por rrjedhë vetvetiu, si për shembull:

⁷⁹ Ebu Davud, Ibn Maxhe, Ibn Hibban dhe Hakimi, nga Abdullah ibn Mugaffel.

“O Allah, prej Teje kërkoj siguri në ditën e Gjykimit, prej Teje kërkoj xhenetin në Ditën e përhershme, me ata të cilët janë të afërt me Ty, të cilët kanë bërë *ruku* e *sexhde*, dhe të cilët e kanë mbajtur fjalën sepse Ti, vërtetë je i mëshirshëm dhe Ti vërtetë bën atë që Ti dëshiron. (*Es’elukel-emne jevmelveidi velxhennete jevmulhuludi meal-mukarrabinesh-shuhudi ver-rukkies-suxhudil-muveffine biluhud inneke rrahimun vedudun ve inneke tef’alu ma turid*)”⁸⁰

Ka shumë dua si kjo, prandaj edhe është mirë që të kufizohemi në duatë tradicionale, dhe që duatë të bëhen me pendim e përlësi, sepse Allahu Teala e do pendimin.

6. Kur bën dua në përlësi dhe me frikë-respekt, duhet të kërkojë atë që dëshiron, duke shpresuar pranimin:

“Ata përpiqeshin për punë të mira, Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin respektues...”

21-Enbija: 90

“Luteni Rabbin tuaj të përlur e në heshtje.” 7- Araf: 55

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kur Allahu Teala Teala e do robin, e sprovon me ndonjë vështirësi, që të dëgjojë duanë përgjëruese të robit të Tij.” ⁸¹

⁸⁰ Tirmidhi nga Ibn Abbas.

⁸¹ Ebu Mensur Dejlemi në ‘*Musnedu’l-Firdevs*’ nga Enesi r.a.

7. Kur bën dua, duhet të jetë i vendosur, duke shpresuar në pranimin e saj dhe duke besuar në rahmetin e Allahut. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikush nga ju bën dua, mos të thotë: ‘Allahu im, më fal nëse do’, e as: ‘Allahu im, më mëshiro, nëse do’, por le të jetë i vendosur në kërkim, zaten, nuk ka forcë që Atë e detyron.”⁸², dhe ka thënë:

“Kur dikush nga ju bën dua, duhet të mbajë shpresë të madhe që do t’i pranohet, sepse për Allahun, pranimi i saj është i lehtë.”⁸³, dhe ka thënë:

“Kur bëni dua, bëni duke besuar se do të pranohet. Dijeni që Allahu Teala nuk do të pranojë duanë e zemrës së pavendosur.”⁸⁴

Sufjan ibn Ujejne ka thënë: *“Askë të mos e pengojnë gjynahet nga duaja, sepse Allahu Teala ia pranoi duanë edhe krijesës më të keqe, Iblisit të mallkuar:*

“(Iblisi) tha: Më jep afat deri në ditën kur ringjallen njerëzit! (Allahu) tha: “ti je nga ata që u është dhënë afati.”

7-Araf: 14, 15

8. Në dua duhet të jetë këmbëngulës dhe i vendosur dhe ta përsërisë duanë tri herë. Ibn Mesud tregon: *“Kur Resulallahu, s.a.v.s., bënte dua, e bënte këtë tri herë, kur kërkonte diçka prej Allahut, e kërkonte tri herë.”*

⁸² Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

⁸³ Ibn Hibban, nga Ebu Hurejre.

⁸⁴ Tirmidhi, nga Ebu Hurejre.

Përgjigjen nuk duhet pritur me padurim dhe nuk duhet ngutur, sepse Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Dua ju pranohet nëse nuk nguteni e të thoni: ‘I bëra dua Allahut Teala, por nuk m’u pranua.’ Kur t’i drejtohesh Allahut Teala me dua, kërko shumë nga Ai, sepse ti po i drejtohesh Fisnikut.”⁸⁵

Dikush ka thënë: “Për njëzet vite po kërkoj nga Allahu Teala plotësimin e një dëshire, e Ai nuk ma plotësoi dëshirën, por unë edhe më tutje po shpresoj në përgjigje. Kërkova nga Allahu Teala të më ndihmojë të largohem nga ajo që nuk më hyn në punë.”

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikush nga ju kërkon diçka nga Allahu Teala dhe kur i pranohet lutja, le të thotë: ‘Elhamdulillahil-ledhi bi ni’metihi tetimmus-salihatu’ (Hamd Allahut, me mirësitë e Tij përmbushen veprat e mira). E nëse ka ndonjë kërkesë që ende nuk i është pranuar, le të thotë: ‘Elhamdulillah ala kuli hal’ (falënderimet Allahut, sido që të jetë).”⁸⁶

9. Duanë e fillon me përmendjen e Allahut Teala, jo me kërkesë. Seleme ibn Ekva ka thënë: “Nuk e kam dëgjuar Resulallahun, s.a.v.s., të fillojë dua pos me fjalët: ‘**Subhane Rabbije’l-alijji’l-a’lâ’l-vehhab’**.”⁸⁷

⁸⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

⁸⁶ Bejheki nga Ebu Hurejre.

⁸⁷ Ahmedi dhe Hakimi.

Ebu Sulejman Darani, r.a., ka thënë: *“Kur dikush kërkon diçka nga Allahu, le të fillojë me salavat, më pas le të shprehë kërkesën e vet, dhe në fund le ta përfundojë duanë me salavat. Allahu Teala do të pranojë atë që është në mes të dy salavateve, sepse Ai është aq fisnik sa nuk do të refuzojë çka gjendet mes dy salavateve.”*

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur kërkon diçka nga Allahu Teala, filloni me salavat mua, sepse Allahu Teala është aq fisnik sa nuk do të ndodhë që t’i bëhen dy kërkesa e Ai njërin ta pranojë e tjetrën ta refuzojë”⁸⁸;

10. Në pranimin e duasë, thelbësor është adabi i brendshëm (*batin*), që shprehet me pendimin, kthimin e asaj që është marrë pa të drejtë si edhe drejtimin me vendosmëri dhe fuqishëm kah Allahu Teala. Nga kjo varet pranimi i duasë.

Kab ibn Ahbar tregon: *“Popullin e Musasë, a.s., e goditi thatësi e madhe. Musa, a.s., doli bashkë me izraelitët të bëjnë dua për shi. Tri herë dolën, e shiu nuk ra. Allahu Teala i shpalli Musasë, a.s., se Ai nuk do t’ia pranojë duanë, as duanë e popullit të vet deri sa mes tyre të jetë ai që shpifë. Musa, a.s., kërkoi nga Allahu Teala që t’ju zbulojë cili është, që ta largojnë nga radhët e veta, e Allahu Teala i shpalli:*

- Vallë, Unë juve t’ju ndaloj shpifjen e Vet të jem një prej atyre që shpifë?!; e Musa, a.s., ju tha izraelitëve:

- Pendohuni të gjithë te Allahu Teala, dhe ndaloni me shpifje! Ata u penduan, e Allahu Teala ju dha shiun.”

⁸⁸ Hadithin e transmeton Ebu Talib Mekki.

Sufjan Sevri tregon: *“Kam dëgjuar se israelitët shtatë vjet i kishte goditur uria dhe thatësia. Merrnin cofëtina nga bërllugu e i hanin, edhe fëmijët e vet i hanin. Dolën në kodra, qanë e u lutën me përulje dhe frikë-respekt. Atëherë Allahu Teala ju shpalli peygamberëve të tyre:*

- Edhe po të më vini këmbëzbathur, gjunj të zhveshur, duar të zgjatura te qielli e gjuhën e rraskapitur nga leximi i duasë, Unë askujt nuk do t’ia pranoj duanë, as që do të kem mëshirë për atë që vajton, deri sa nuk ju ktheni njerëzve gjërat që ju keni marrë padrejtësisht. Kur i kthyen, po atë ditë ju erdhi shiu.”

Malik ibn Dinar tregon: *“Israelitët i goditi thatësi e madhe, e dolën të bëjnë dua. Allahu Teala i shpalli peygamberit të tyre:*

- Ju bëni dua dhe kërkoni rahmet prej Meje me trupa të papastër, i ngritni duart që kanë derdhë gjakun e huaj, e stomakët i keni të mbushur me haram. Vërtetë që Unë tash jam shumë i zemëruar me ju e do të jeni gjithnjë e më larg prej Meje. Braktisni këto, që Unë të ju japë rahmetin.

Ebu Siddik Naxhi tregon: *“Sulejmani, a.s., doli për të bërë dua për shiun. Rugës e takoi një milingonë të shtrirë në shpinë, këmbët kah qielli, e lutej:*

- Allahu im! Ne jemi krijesat Tua e nuk mundemi pa furnizimin Tënd. Mos na shkatërro neve për gjynahet e të tjerëve. Atëherë Sulejmani, a.s., tha:

- Kthehuni! Është bërë duaja e nevojshme për shiun.”

Evzai tregon se disa njerëz dolën për të bërë duanë për shi, e mes tyre edhe Bilal ibn Sad, që i shprehi falënderimet Allahut Teala, e pastaj tha:

- *O ju të pranishëm! A i pranoni gjynahet tuaja?!*

- *I pranojmë; thanë të pranishmit, i ngriti duart e edhe të tjerët i ngritën, e Bilali vazhdoi:*

- *Allahu ynë! Ne i kemi dëgjuar fjalët Tua:*

“Nuk ka vend për vërejtje ndaj punëmirëve” (9- 91), *i pranuar gjynahet tona; a nuk i takon falja Jote të tillëve? Allahu ynë! Na fal e na mëshiro! Na dhuro shi!;*

dhe Allahu Teala ju dërgoi shiun.

Njerëzit iu drejtuan Malik ibn Dinar të bëj dua për ta, e ai tha: *“Ju thoni pse nuk bie shi, e unë them pse nuk bie gurë për këto gjendje dhe veprime tona!”*

Isa, a.s., doli me popullin për duanë e shiut. U mërzitën duke bërë dua, por shi nuk binte. Isa, a.s., kërkoi të largohen ata që kanë bërë ndonjë gjynah, e u larguan të gjithë, pos njërit, dhe Isa, a.s., e pyeti:

- *A nuk ke ti asnjë gjynah?*

- *Pasha Allahun, asgjë nuk kam bërë, përpos që një ditë, derisa po falja namaz, para meje kaloi një grua. E shikova me këtë sy, e kur u largua, e nxorra me gishtat e mi këtë sy dhe e hodha pas asaj gruaje.* Isa a.s., i tha:

- *Atëherë ti bëj dua, e unë do të bëj ‘Amin’;* dhe personi bëri duanë e në qiell u lajmëruan retë, dhe filloi të bie shi.

Jahja Gassani tregon: “Në kohën e Davudit, a.s., njerëzit i goditi thatësi e madhe. Dolën të bëjnë dua për shi, e me vete i morën tre dijetarë. I pari prej tyre, tha:

- Allahu im! Ti në Librin Tënd ke shpallur t’i falim ata që bëjnë padrejtësi, Allahu ynë! Ne i bëmë padrejtësi vetes, prandaj, na fal!; I dyti tha:

- Allahu im! Ti në Librin Tënd ke shpallur t’i lirojmë skllavët. Allahu ynë! Ne jemi skllavët e Tu, prandaj, na liro!; e i treti tha:

- Allahu im! Ti në Librin Tënd ke shpallur që të mos i refuzojmë fukatatë nga dera e shtëpisë. Allahu ynë! Ne jemi fukara, jemi ndalur para derës Tënde, prandaj mos na refuzo.

Pas kësaj, Allahu Teala ju dërgoi shiun.”

Atta es-Sulemi tregon: “Na goditi një thatësi e madhe e dolëm të bëjmë dua. Papritur, para nesh, në varreza, e pamë Sadun el Mexhnun. Më pyeti:

- O Atta! A është kjo dita e ringjalljes apo dita e kiametit? e unë i thashë:

- Jo, nuk është ajo, por na është ndalë shiu, e dolëm të bëjmë dua. Saduni më tha:

- O Atta! A dolët të bëni dua me zemra mbushur me gjynah e që janë lidhur për dynja, apo me zemra që i janë drejtuar Allahut? e unë iu përgjigja:

- Me zemra që janë penduar dhe i janë drejtuar Allahut! E ai tha:

- Eh, sikur të ishte ashtu, o Atta! Thuaj këtyre që të mos largohen nga rruga e drejtë dhe drejtësia, Ai që përcjellë gjithçka sheh mirë.; dhe drejtoi shikimin kah qielli, e filloi duanë:

‘Allahu im! Rabbi im! Mbrojtësi im! Mos e shkatërro Tokën për gjynahet e robëve Tu, por me fshehtësinë e Emrave Tu dhe shenjat e Tua të fshehura, na ujit me ujë të pijshëm e të bollshëm, me të cilin do t’i ngjallësh robët e do ta ujisësh tokën, o Ti që mundesh gjithçka!’

Atta tutje tregon:

-As nuk i përfundoi fjalët e veta, e në qiell filluan bubullimat. Ra shi me bollëk, e Mexhnuni u largua duke thënë:

*Shpëtimi i arrijti besimtarët e përulur,
Që për rizanë e Rabbit, barkun e lënë uritur.
Sytë e humbur në dashuri, ishin lodhur shumë,
netët ju kalonin, ata nuk bënë gjumë.
Për Allahun Teala, humbasin në ibadet,
e njerëzit mendojnë se u kanë humbë mendtë.”*

Ibn Mubarek tregon: *“Udhëtova për Medine atë vit kur mbretëroi thatësi e madhe dhe uria. Njerëzit kishin dalur për të bërë dua, e ju bashkova. Na u afrua një djalë zezak, e në vete kishte dy këmisha të thjeshta, njëren veshur e tjetrën krahëve. U ul afër meje, dhe e dëgjova si lutet:*

- Allahu im! Prej gjynaheve e veprave të shëmtuara, fytyrat turpërohen para Teje. Na e ke ndalë shiun nga qielli, që me këtë t’i përmirësosh robët e Tu. O Gjithëfalësi, o Udhëzuesi, o Bamirës ndaj robëve Tu, nga Ti kërkoj që në këtë çast t’ju japësh ujë, në këtë çast!;

dhe deri sa ende po thoshte: ‘...në këtë çast, në këtë çast’, qiellin e mbuluan retë dhe filloi të bjerë shi me të madhe.

Ibn Mubarek vazhdon: *“Shkova te Fudajli, e ai më pyeti pse jam mërzhitur, e unë thashë:*

- Sepse na ka kaluar dikush; dhe i tregova çfarë kishte ndodhur. Fudajli lëshoi një klithmë dhe e humbi vetëdijen.”

Omer ibn Hattab dhe Abbasi, r.a., po bënin dua për shi. Kur Omeri e përfundoi duanë, Abbasi filloi:

- Allahu im! Vetëm me gjynahe vijnë telashet, e vetëm me teube largohen. Populli më zgjodhi mua të bëj dua për shkak të pozitës time te Resulallahu, s.a.v.s.. Ja duart tona gjynahqare dhe kokat e përulura, e Ti je mbrojtës; do t’i ruash të humburit e nuk do t’i lësh të enden kështu të mposhtur. Të rinjtë janë dobësuar e të vjetrit kanë shkuar, dhe klithmat e keqardhjes janë shtuar. Ti e njeh edhe të fshehtën edhe të dukshmen, Allahu im! Na dërgo rahmetin Tënd para se të lëshohen në dëshpërim e të shkatërrohen, sepse vetëm pabesimtarët e humbin shpresën në mëshirën e Allahut;

Ende pa e përfunduar duanë, re si male e mbuluan qiellin, dhe ra shi.

FAZILETI I SALAVATIT PËR RESULALLAHUN, S.A.V.S.

Allahu Teala thotë:

“Allahu dhe melaiket e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me salam.” 33-Ahzab: 56

Transmetohet se një ditë, Resulallahu, s.a.v.s., erdhi i disponuar, në fytyrë i shihej gëzimi, e tha:

“Më erdhi Xhebraili, a.s., e më tha:

- O Muhammed (a.s.)! A je i kënaqur që secilit nga ummeti yt që të dërgon një salavat ti t’ia kthesh dhjetë, dhe secilit nga ummeti yt që të dërgon një salam, t’ia dërgosh dhjetë.”⁸⁹

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu, ka thënë:

“Kush më dërgon një salavat mua, melekët do të kërkojnë falje dhjetë herë për të. Prandaj, më dërgoni salavat, qoftë pak, ose shumë.”⁹⁰

“Më së afërti meje mes njerëzve janë ata që më së shumti më dërgojnë salavat.”⁹¹

“Koprrac është çdokush tek i cili përmendem, e nuk thërret salavat për mua.”⁹²

“Më dërgoni shumë salavat ditën e xhumasë.”⁹³

“Atij nga ummeti im që më dërgon salavat do t’i shkruhen dhjetë vepra të mira e t’i fshihen dhjetë të këqija.”⁹⁴

⁸⁹ Nesai dhe Ibn Hibban nga Ebu Talha.

⁹⁰ Ibn Maxhe nga Amir ibn Rebi.

⁹¹ Tirmidhi nga Ibn Mesud.

⁹² Nesai

⁹³ Ebu Davud, Nesai dhe Ibn Maxhe.

“Kush thotë pasi ta dëgjojë ezanin dhe ikametit: ‘Allahumme Rabbe hadhihid-da’veti-t-tammeti ves-saletil-kaimeti sal-li ala Muhammedin abdike ve resulike ve ‘atihil-vasilete vel-fadilete ved-derexhete-r-refi’ate vesh-shefa’ate jevme-l - kijame (O Allahu im, Rabb i kësaj thirrjeje të plotë dhe i namazit që do të falet, jepi Muhamedit ndërmjetësimin e nderimin dhe ngrite atë në vendin e lavdishëm që i ke premtuar. Me të vërtetë, ti nuk e thyen premtimin)’; do të jem shefaatxhi i tij në Ditën e Gjykimit.”⁹⁵

“Kush më shkruan salavat në libër, melekët do të kërkojnë falje për të deri sa emri im të jetë në atë libër.”⁹⁶

“Vërtetë ka melekë që sillen rreth Tokës e m’i përcjellin selamet nga ummeti im.”⁹⁷

“Kush do që më qon selam, Allahu Teala ma kthen shpirtin që unë t’ia kthej selamin.”⁹⁸

E pyetën Resulallahun, s.a.v.s.:

- O Resulallah! Si të dërgojmë salavat ty?; e u përgjigj:

- **Thuani: “O Allah! Mëshiroje Muhammedin robin Tënd, familjen e tij, gratë e tij, pasardhësit e tij, siç e ke mëshiruar Ibrahimin, familjen e Ibrahimit! O Allah! Bekoje Muhammedin, gratë e tij, pasardhësit e tij, siç e ke bekuar Ibrahimin, familjen e Ibrahimit. Vërtetë, hamdi të takon Ty e Ti je i lavdëruar”.**⁹⁹

⁹⁴ Nesai në *el-Jevm vel-lejle* nga Amr ibn Dinar, ky në veprën *es-Sijer-u*, si edhe Ibn Hibban nga Enesi.

⁹⁵ Buhari nga Xhabiri.

⁹⁶ Taberani

⁹⁷ Është përmendur në *Librin për haxhin*.

⁹⁸ Ebu Davud nga Ebu Hurejre.

⁹⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Humejd Said.

(Allahumme sal-li ala Muhammedin abdike ve ala alihi ve azvaxhihi ve dhurrijetihi kema sal-lejte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim ve barik ala Muhammedin ve ezvaxhihi ve dhurrijetihi kema barekte ala Ibrahim ve ali Ibrahim inneke hamidun mexhid.)

Tregohet se Omeri, r.a., pas vdekjes së Resulallahut, s.a.v.s., qante e thoshte: *“Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Trungu i palmës ku qëndroje kur ju drejtoheshe njerëzve, e kur numri i njerëzve u shtua ti bëre minberin që njerëzit të dëgjojnë më mirë, ai trung qau për ndarjen prej teje dhe nuk e ndali vajin deri sa nuk e vendose dorën mbi të, e ummeti yt qanë edhe më shumë për ndarjen prej teje. Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Arrite vlerë të madhe te Allahu Teala, sa nënshtrimi ty u barazua me nënshtrimin Allahut: **“Kush i bindet Pejgamberit, i është bindur Allahut”** (4-Nisa: 80).*

*Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Arrite vlerë të lartë te Allahu Teala, e Ai të lajmëroi se të ka falur para se të të njoftojë për gabimin: **“Allahu ta fali ty** (Muhammed) **gabimin pse atyre ju dhe leje.”** (9-Teube: 43).*

*Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Arrite vlerë të lartë te Allahu Teala, e Ai të dërgoi si pejgamberin e fundit e të përmendi të parin: **“(Përkujto) Kur Ne e morëm** (me betim) **prej pejgamberëve premtimin e tyre; edhe prej teje, prej Nuhut, Ibrahimit, Musait, Isait, birit të Merjemes, pra morëm prej tyre besë të fortë.”** (33-Ahzab: 7).*

*Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Arrite vlerë të lartë te Allahu Teala, sa banorët e xhehenemit, deri sa janë duke u dënuar në të, do të dëshirojnë të kenë pasuar e të jenë nënshtruar ty: **“Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: “Ah, sikur t’i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit!”** (33-Ahzab: 66).*

*Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Nëse Allahu Teala i dha Musasë, djalit të Imranit, a.s., që nga gurë t’i rrjedhin lumenj, pse të jetë kjo më e habitshme se gishtat e tu, nga të cilët rrodhi ujë, Allahu të bekoftë. Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Nëse Allahu Teala i dha Sulejmanit, a.s., erën me të cilën në mëngjes e kalonte distancën sa një muaj udhëtim e edhe në mbrëmje e kalonte distancën sa një muaj, pse kjo të jetë më e habitshme se Buraku, me të cilin ti u ngjite në qiellin e shtatë, e më pas, në natën e njëjtë fale namaz të sabahut në Qabe, Allahu Teala të bekoftë. Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Nëse Allahu Teala i dha fuqi Isasë, a.s., djalit të Mejremes, a.s., t’i ngjallë të vdekurit, pse kjo të jetë më e habitshme se delja e helmuar, e cila, ashtu e pjekur, të foli dhe të tregoi të mos e hash sepse ishte e helmuar. Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Nuhi, a.s., i drejtoi dua Allahut Teala kundër popullit të vet: **“O Rabbi im, mos lë mbi tokë asnjë nga jobesimtarët!”** (71-Nuh: 26), e po t’i drejtoje ti Allahut Teala këso duaje, të gjithë do të bëheshim helaq. Të shkelën në shpinë, ta gjakosën fytyrën, t’i thyen dhëmbët, e ti prapë vetëm të mirën ua deshte, dhe u lute: **“Allahu im! Fale popullin tim sepse nuk dinë!”***

Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Edhe pse kishe pak vite dhe jetove për kohë të shkurtë, të pasuan më shumë njerëz se që pasuan Nuhin, a.s., edhe pse ai pati shumë vjet dhe jetoi shumë më gjatë se ti. Shumë e besuan pejgamberllëkun tënd e pak njerëz e besuan pejgamberllëkun e Nuhit, a.s.. Për ty e flijoj edhe babanë edhe nënën, o Resulallah! Nëse ti do të ishe vetëm me ata që janë të ngjashëm me ty, nuk do të uleshe me ne; po të martoje vetëm dikë nga ata të ngjashëm me ty, nuk do të martoje dikë nga ne; po t'ju besojë vetëm atyre të ngjashëm me ty, nuk do të kishe besim në ne; e ti, pasha Allahun, me neve u ule, nga ne more për grua dhe neve na besove, veshe rroba të thjeshta, hipje në gomar dhe lejove që në kafshën e njëjtë të hipin edhe të tjerë, sofrën e shtroje në tokë e nga modestia i lëpije gishtat e tu.

Dikush ka thënë: “E shkruajta një hadith e më pas e shkruajta edhe një salavat Resulallahut, s.a.v.s., pa selam, dhe e pashë në ëndërr Resulallahun, s.a.v.s., e më tha:

- A nuk do ta plotësosh salavatën në librin tënd?
e pas kësaj gjithmonë i shkruaja edhe salavat edhe selam Resulallahut, s.a.v.s.”.

Tregohet se Ebu Hasan ka thënë: “E pashë në ëndërr Resulallahun, s.a.v.s., dhe iu drejtova:

- O Resulallah! Me çfarë u shpërblye Imam Shafi, kur në veprën ‘Risala’ thotë: ‘O Allah, bekoje Muhammedin aq herë sa e përmendin zakirët dhe aq herë sa harrojnë ta përmendin të pakujdesshmit’; e më tha:

- U shpërblye me lirim nga llogaria.”

FAZILETI I ISTIGFARIT

Allahu Teala thotë:

“Ata, që kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun dhe kërkojnë falje për gjynahet e tyre.” 3-Ali Imran: 135.

Alkame bin Kajs dhe Evsed bin Jezidi tregojnë se Abdullah ibn Mesud, r.a., ka thënë: *“Në librin e Allahut ka dy ajete që, kur rob i bën ndonjë gjynah e më pas i lexon ato dy ajete dhe e lutë Allahun Teala për falje, Allahu Teala do t’ia falë gjynahun. Këto dy ajete janë:*

“Ata, që kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun dhe kërkojnë falje për gjynahet e tyre.” 3-Ali Imran: 135, dhe:

“Kush punon vepër të keqe ose i bën zullum vetes, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është falës e mëshirues.” 4-Nisa: 110.

Allahu Teala gjithashtu thotë:

“Ti, pra, lartësoje Rabbin tënd duke falënderuar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin, është mëshirues i madh.” 110-Nasr: 3,

dhe:

“..kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit.” 3-Ali Imran: 17.

Resulallahu, s.a.v.s., shpesh lexonte:

“I lavdëruar qofsh, Allahu im, hamdi të takon vetëm Ty! Më fal, Allahu im, sepse Ti vërtetë falë shumë dhe je i mëshirshëm”
(*Subhaneke Allahumme ve bihamdike Allahummegfirli inneke entet-tevvabur-rahim*)¹⁰⁰

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Atij që vazhdon me istigfar, Allahu Teala ia jep një rrugë shpëtimi në çdo vështirësi dhe ia jep një lehtësim në çdo fatkeqësi, dhe do ta furnizojë prej kah as nuk e pret.”¹⁰¹

“Vërtetë nga Allahu Teala kërkoj falje (bëj istigfar) dhe te Ai pendohem çdo ditë nga shtatëdhjetë herë.”¹⁰²

“Vërtetë, nganjëherë zemrën ma kaplon etja, prandaj bëj istigfar te Allahu Teala çdo ditë nga njëqind herë.”¹⁰³

“Ai që, kur shtrihet në shtrat, tri herë thotë:

Estagfiru’ilahe’l-adhim elledhi la ilahe illa huve’l-hajje’l-kajjumu ve etubu ilejhi. (Kërkoj falje nga Allahu Teala, nuk ka zot tjetër përpos Tij, të Gjallit të Përhershmit, te Ai pendohem), Allahu Teala do t’ia falë gjynahet, qofshin edhe sa shkuma e detit, ose sa zalli i vendit *Temim*, ose sa gjethet në drunj, ose sa ditët në këtë botë”¹⁰⁴; e në hadith tjetër thuhet edhe:

“Kush i thotë këto fjalë (nga hadithi më lartë), do t’i falen gjynahet, edhe nëse ka ikë nga radhët e ushtrisë që po fiton.”¹⁰⁵

¹⁰⁰ Hakimi nga Ibn Mesud.

¹⁰¹ Ebu Davudi dhe Nesai nga Ibn Abbasi.

¹⁰² Buhari nga Ebu Hurejre.

¹⁰³ Muslimi

¹⁰⁴ Tirmidhi nga Ebu Seid.

¹⁰⁵ Ebu Davud dhe Tirmidhi.

Huzejfe kishte gjuhë të ashpër ndaj familjes, dhe pyeti:

- *O Resulallah! Kam frikë se gjuha ime do të më dërgojë në xhehenem; në çka Resulallahu, s.a.v.s. tha:*

- *E ku e ke istigfarin?! Vërtetë, edhe unë bëj istigfar nga njëqind herë në ditë.*"¹⁰⁶

Ajshe r. anha., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

"Nëse bën ndonjë gjynah, kërko falje nga Allahu Teala dhe pendohu te Ai, e vërtetë pendim nga gjynahu është keqardhja dhe kërkimfalja."¹⁰⁷

Duke bërë istigfar, Resulallahu, s.a.v.s., lexoi:

"Allahu im, ma fal gjynahun tim, paditurinë time, mospërmbajtjen time, atë që Ti e di më mirë se unë! Allahu im, ma fal mendjelehtësinë time, ashpërsinë time, gabimin tim, qëllimin tim, e të gjitha këto janë te unë! Allahu im, më fal për atë që e kam bërë më parë, atë që do ta bëj, atë që e kam fshehur, atë që e kam shfaqur, atë që Ti e di më mirë se unë! Ti je i Gjithmonshmi, pa fillim dhe pa mbarim, Ti je i plotfuqishëm për çdo gjë!" (*Allahummagfir li hatieti ve xhehli ve israfi fi emri ve ma ente a'lemu bihi minni. Allahummagfir li hezli ve xheddi ve hatai ve amdi kul-le dhalike indi. Allahummagfir li ma kaddemtu ve me ehhartu vema esrertu ve ma a'lentu ve ma ente a'lemu bihi minni ente-l mukaddimu ve ente muehhiru ve ente ala kul-li shej'in kadir*)¹⁰⁸

¹⁰⁶ Nesai.

¹⁰⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ajshe. anha.

¹⁰⁸ Buhariu dhe Muslimi.

Alia, r.a., tregon: “Isha tashmë i pjekur, e nga Resulallahu, s.a.v.s., dëgjoja hadithe që Allahu Teala m’i bëri të dobishme ashtu siç deshi Ai të m’i bëj të dobishme, por kur dikush prej as’habëve më tregon ndonjë hadith, i kërkoj të betohet, e kur betohet, atëherë i besoj. Ebu Bekr më ka treguar, e Ebu Bekr, r.a., e flet të vërtetën, se e ka dëgjuar Resulallahun, s.a.v.s., të thotë:

‘Kur një person bën gjynah, nëse pastrohet mirë, merr abdes, i falë dy reqate dhe bën teube, Allahu Teala ia falë gjynahet’¹⁰⁹, e më pas e lexoi këtë ajet kur’anor:

“Ata, që kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun dhe kërkojnë falje për gjynahet e tyre.”

(3-Ali Imran: 135).

Ebu Hurejre tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur besimtari bën gjynah, në zemër i lajmërohet një njollë e zezë; nëse pendohet, nuk e përsëritë gjynahun dhe kërkon falje nga Allahu Teala, zemra i pastrohet dhe njollës i humbet gjurma, e nëse vazhdon me gjynah, njolla zgjerohet deri sa ia mbulon gjithë zemrën. Ky është ‘ran’ për të cilin flet Allahu Teala në librin e Tij: ‘E, nuk është ashtu! Por, veprat e tyre (të këqia) i kanë ndryshkur (ran) zemrat e tyre.’” (83-Mutaffifun: 14).¹¹⁰

Ebu Hurejre tregon edhe se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu Teala ia ngrit gradën robit në xhennet, e rob pyet:

- Rabbi im! Prej nga më erdhi kjo?!, e Allahu Teala thotë:

- Ky është istigfari i evladit tënd për ty.”¹¹¹

¹⁰⁹ Autorët e *Sunenit*, ndërsa Tirmidhi e konsideron hasen.

¹¹⁰ Tirmidhi, Nesai, Ibn Maxhe, Bejhaki, Imam Ahmed, Ibn Hibban dhe Hakimi nga Ebu Hurejre.

¹¹¹ Imam Ahmedi me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

Ajshe, r.anha., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu im, më bëj nga ata të cilët, kur bëjnë vepër të mirë - gëzohen, e kur bëjnë vepër të keqe - bëjnë istigfar.”¹¹²

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Kur robi bën gjynah, e më pas kërkon falje nga Allahu Teala, Ai thotë:

- *Robi Im bën gjynah, por e di se ka Rabb, i Cili dënon për gjynahe dhe që i falë gjynahet. Robi Im, bëj çfarë të duash – të kam falur.”¹¹³*

“Nuk është këmbëngulës në gjynahe ai që bën istigfar, edhe nëse e përsëritë gjynahun shtatëdhjetë herë brenda një dite.”¹¹⁴

“Personit që kurrë nuk ka bërë vepër të mirë, e një ditë e drejton shikimin në qiell dhe thotë:

- *Unë e kam Rabbin tim. O Rabbi im, më fal!*

Allahu Teala i përgjigjet:

- *Të kam falur.”¹¹⁵*

“Kush bën ndonjë gjynah, e është i vetëdijshëm që Allahu Teala e ka parë, do të falet, edhe nëse nuk bën istigfar.”¹¹⁶

¹¹² Shënon Ibn Maxhe.

¹¹³ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

¹¹⁴ Ebu Davud dhe Tirmidhi.

¹¹⁵ Nuk është gjetur burimi.

¹¹⁶ Taberani.

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu Teala thotë: ‘O robët e Mi! Të gjithë ju jeni gjynahqarë, përpos atyre që janë nën mbrojtjen Time. Prandaj kërkoni falje te Unë, e do t’ju falë, e kush beson që vetëm Unë jam në gjendje të falë, edhe Unë do ta fali.”¹¹⁷, dhe:

“I falen gjynahet atij që lexon:

‘Subhaneke dhalemte nefsi ve amiltu su-en fagfirli fe innehu la jagfiru-dhdhunube il-la ente’ (i lavdëruar je, Allahu im! I bëra vetes padrejtësi dhe bëra veprë të keqe; më fal, vetëm Ti i falë gjynahet), edhe në qofshin sa ka shtigje të milingonave.”¹¹⁸

Transmetohet se istigfari më i mirë është:

“Allahu im. Ti je Rabbi im, e unë jam robi Yt! Ti më ke krijuar, e unë, aq sa mundem, i përmbahem premtimit që të kam dhënë Ty. Tek Ti kërktoj strehim nga veprat e këqija që i kam bërë. E pranoj dhe i përmbahem mirësisë që më ke dhuruar, dhe i pranoj gjynahet e mia. I kam bërë padrejtësi vetes dhe e pranova gjynahun tim, prandaj m’i fal gjynahet, ato që i kam bërë dhe ato që do t’i bëj, sepse vetëm Ti i falë të gjitha gjynahet.” (Allahumme ente rabbi ve ene abduke halekteni ve ene ala ahdike ve va’dike mesteta’tu eudhu bike min sher-ri ma sana’tu ebuu leke bini’metike alejje ve ebuu ala nefsi bi dhenbi fekad dhelemtu nefsi va’tereftu bi dhenbi fagfirli dhunubi ma kaddemtu minha ve ma enhartu fe innehu la jagirudhdhunube xhemian il-la ente.)¹¹⁹

¹¹⁷ Tirmidhi dhe Ibn Maxhe.

¹¹⁸ Bejheki.

¹¹⁹ Buhari, nga Sheddad ibn Evs.

Halib ibn Mid'an ka thënë se Allahu Teala thotë:

“Robët e Mi më të dashur janë ata që me zemër janë lidhur me xhaminë dhe ata që para agimit bëjnë istigfar. Këta janë personat që, sikur banorët e Tokës të dëshirojnë t'i dënojnë, Unë i përkujtoj ata, dhe nuk i dënoj.”

Katade, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: *“Kur'ani Kerim do t'ju tregojë edhe sëmundjen tuaj, edhe ilaçin për të. Sëmundja juaj janë gjynahet, e ilaçi për të është teube dhe istigfari.”*

Alia, kerremellahu vexhhedu, ka thënë: *“Më huton gjendja e atij që shkatërrohet, e ka shpëtim”*; e kur e pyetën se ku është shpëtimi, tha: *“Teube dhe istigfari!”*

Alia, r.a., gjithashtu ka thënë: *“Po të donte Allahu ta dënonte robin e Tij, nuk do t'ia mësonte istigfarin.”*

Fudjal ka thënë: *“Kur robi thotë: ‘estagfirullah’, kjo e ka kuptimin: ‘O Allahu im, m’i zhduk gjynahet’.”*

Një dijetar ka thënë: *“Robi gjendet mes gjynahut dhe mirësisë, e ta përmirësojë mundet vetëm hamdi Allahut Teala për mirësitë dhe istigfari për gjynahet.”*

Rebi ibn Hajsem, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: *“Askush nga ju të mos thotë:*

- ***Estagfirullah ve etubu ilejhi***, sepse nëse pastaj nuk mud të veprojë ashtu, bëhet gënjeshtar dhe gjynahqar. Por, le të thotë:
- ***Allahummag-firli ve tub alejje!***.”

Fudajl, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: *“Istigfari, pa braktisjen e gjynahut, është pendim i gënjeshtarit.”*

Rabija Adevi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: *“Itsigfari ynë ka nevojë për shumë isftigfar.”*

Disa të urtë kanë thënë: *“Kur kërkon falje nga Allahu Teala para se të jetë penduar, pa vetëdije po luan me Allahun Teala.”*

Një beduin e kapi mbulesën e Qabes, dhe bënte dua:

“Allahu im! Vërtetë që istigfari im, bashkë me vazhdimin me gjynahe, është fatkeqësi e imja! Vërtetë që ikja ime nga istigfari duke e njohur faljen Tënde të madhe, është pafuqi e imja. Sa bukur më përkëdhel me mirësitë Tua, e Ti nuk ke nevojë për mua, dhe çfarë urrejtje ndaj Teje shprehu unë me gjynahet e mia, e unë nuk mundem pa Ty! O Ti, i Cili, kur premton e përmbushë premtimin, e kur kërcënon – falë! Mbuloji gjynahet e mia të shumta me faljen Tënde madhështore, o Mëshirues!”

Ebu Abdullah Verrak ka thënë: *“Edhe po të kesh gjynahe sa ka pika të shiut dhe sa ka dallgë deti, nëse e lexon këtë istigfar me sinqeritet, Allahu Teala i fal ato:*

- Allahu im, nga Ti kërkoj falje për secilin gjynah për të cilin jam penduar tek Ti, e më pas prapë e kam bërë! Nga Ti kërkoj falje për secilin premtim që ta kam dhënë, e nuk e kam mbajtur! Nga Ti kërkoj falje për secilin nimet që ma ke dhënë, e unë e kam përdorë të bëj gjynahe! Nga Ti, i Cili e njeh edhe të fshehurën edhe ashiqaren, falje kërkoj për secilin gjynah që e kam bërë, ditën ose natën, në shoqëri ose i vetëm, fshehurazi ose ashiqare, o Gjithëfalësi!”

(Allahumme inni estagfiruke min kul-li dhenbin tubtu ilejke minhu thum-me udtu fihi ve estagfiruke min kul-li ma va'adtuke bihi min nefsi ve lem ufi leke bihi ve estagfiruke min kul-li amelin eredu bihi vexhheke fehaletahu gajruke ve estagfiruke min kul-li ni'metin en'amte biha alej-je feste'antu biha ala ma'sijetike ve estagfiruke la alimel gajbi vesh-shehadeti min kul-li dhenbin etejtuhu fi dijain-nari ve sevadil-lejli fi melein ev halain ve sirrin ve alanij-jetin ja halimu)

Thuhet se ky është istigfari i Ademit, a.s., e dikush ka thënë se është istigfari i Hidrit, a.s..

Kapitulli i tretë
DUATË TRADICIONALE

DUAJA E RESULALLAHUT, S.A.V.S., PAS NAMAZIT TË SABAHUT

Abdullah Ibn Abbas, r.a., tregon: “*Babai im (Abbas) më dërgoi te Resulallahu, s.a.v.s.. Shkova natën, dhe e gjeta në shtëpinë e tezes time, Mejmune (gruja e pejgamberit). Resulallahu, s.a.v.s., natën ngritej dhe falte namaz, e pasi i fali dy reqate të namazit të sabahut, e bëri këtë dua:*

”Allahumme inni es’eluke rahmeten min indike tehdi biha kalbi ve texhme’u biha shemli ve tulimme biha sha’si ve terudde bihe-l fitnete anni ve tuslihu biha dini ve tahfezu biha gaibi ve terfe’u biha shahidi ve tuzzeki biha ameli ve tebjjeddu biha vexhhi ve tulhimeni biha rushdi ve ta’simuni biha min kulli suin. Allahumme ‘atini imanen sadikan ve jekinen lejse ba’dehu kufrun ve rahmeten enalu biha shurefe kerametike fiddun-ja vel-ahireti. Allahumme inni es’eluke-l fevze inde-l-kadai ve menazileshshuhedai ve ajshessu’adai vennasre ale-l-a’dai ve murafekate-l-enbijai. Allahumme inni enzilu bike haxheti ve in daufe re’ji ve kallet hil-jeti ve kasure ameli veftekartu ila rahmetike fe es’eluke ja kafije-l-umuri ve ja shafijessuduri kema tuxhiru bejne-l-buhuri en tuxhireni min adhabisseiri ve min da’vetisseburi ve min fitneti-l-kuburi. Allahumme ma kasare anhu re’ji ve daufe anhu ameli ve lem jublighu nijjeti ve umnijjeti min hajrin veadtehu ehaden min ibadike ev hajrin ente mu’tihi ehaden min halkike fe inni ergabu ilejke fihî ve es’elukehu ja rabe-l-alemine. Allahummexh’alna hadine muhtedine gajre dalline ve la mudilline harben li a’daike ve

silmen li evlikaike nuhabbib bihubbike men eta'ake min halkike ve nuadi bi adavetike men halefeke min halkike. Allahumme hadheddua'u ve alejkel-l-ixhabetu ve hadhe-l-xhuhdu ve alejket-tekilanu ve inna lilahi ve inna ilejhi raxhi'une ve lahavle ve la kuvvete illa billahil-alijjil-adhimi dhi-l-hablshshedidi vel'emrirreshidi es'eluke-l-emne jevme-l-veidi vel-xhennete jevmel-huludi me'a mukarrabineshshuhudi verrukke'issuxhudil-muvefine bi-l-uhudil inneke rahimun vedudun ve inneke tef'alu ma turidu. Subhanallezi lebis-l-izze ve kale bihi subhanallezi teattafe bi-l-mexhdi ve tekerreme bihi subhanallezi la jenbegi ttesbihi illa lehu subhane zi-l-fadli venni'ami subhane dhi-l-izzeti ve-l-keremi subhanalledhi ahsa kulle shej'in bi ilmihi. Allahumme xh'al li nuren fi kalbi ve nuren fi besari ve nuren fi sha'ri ve nuren fi besheri ve nuren fi lahmi ve nuren fi demi ve nuren fi 'izami ve nuren min bejni jedejje ve nuren min halfi ve nuren 'an jemini ve nuren an shimali ve nuren min fevki ve nuren min tahti. Allahumme zidni nuren ve'tini nuren vexh'alli nuren. (Allahu im! Ty të lutem për rahmetin Tënd, që me atë rahmet ta udhëzosh zemrën time, ta përmbledhësh forcën time, ta përmirësosh gjendjen time, t'i largosh tundimet nga unë, ta përmirësosh imanin tim, të fshehësh në mua atë që nuk është për t'u shfaqur dhe të lartësosh atë që është e dukshme, t'i pastrosht veprat e mia, ta ndriçosh fytyrën time, të m'i tregosh veprimet e drejta e të më ruash nga çdo e keqe. Allahu im! Më dhuro besim të sigurtë dhe bindje pas së cilës nuk do të bie në mosbesim, dhe rahmet me të cilin do të arrij nderin e shpërblimit Tënd, në këtë botë dhe në botën tjetër. Allahu im! Ty të lutem për fitore me rastin e caktimit Tënd, me pozitën e shehidit, me jetën e të lumturve, me fitore kundër armikut dhe me shoqëri të

pejgamberëve. Allahu im! Ty t'a paraqes nevojën time, sepse gjykimi im është i dobët, mundësitë e mia janë të vogla, veprat e mia janë të pamjaftueshme dhe unë kam nevojë për rahmetin Tënd. Prandaj, nga Ti kërkoj, Ti që je i mjaftueshëm për gjithçka, Ti që i shëron gjoksat, ashtu siç i ndanë detet, ashtu më ruaj mua nga zjarri i xhehenemit, nga thirrja në ditën e shkatërrimit dhe nga sprovat e varrit. Allahu im! Atë të mirë, për të cilën gjykimi im është i pafuqishëm, dhe vepra ime e pamjaftueshme, dhe të cilën nuk e ka arritur qëllimi dhe dëshira ime, e Ti ia ke premtuar ndonjërit prej robëve Tu, ose të mirën që Ti ia dhuron krijesave Tua, unë vërtetë e dua atë nga Ti dhe të lus për Të, o Rabb i botëve! Allahu ynë! Na bëj udhëzues dhe të udhëzuar, dhe mos bëj të jemi nga ata që kanë humbur dhe që të tjerët i dërgojnë në humbje! Na kthe kundër armiqve Tu dhe na drejto kah miqtë e Tu! Me dashurinë Tënde i duam ato prej krijesave Tua që Ty të nënshtrohen dhe me armiqësinë Tënde jemi kundër atyre që Ty të kundërshtojnë. Allahu im! Kjo është duaja ime, e përgjigja është e Jotja, ky është mudi im, e shpresa është në Ty! Vërtetë ne jemi të Allahut dhe vërtetë te Ai kthehemi! Nuk ka forcë pos me Allahun, të Lartësuarin e të Fuqishmin, te i Cili është litari i fortë dhe e drejta! Ty të lutem për siguri në ditën e Gjykimit, dhe për xhennet në ditën e Përrjetshme, në shoqëri me ata që janë afër Teje, që Ty të bëjnë ruku e sexhde, që i përmbahen fjalës së dhënë; vërtetë Ti je i mëshirshëm dhe plot dashuri dhe Ti bën çfarë Ti dëshiron. I Lavdëruar është Ai që është mbështjellur me mantelin e forcës dhe flet përmes tij! I Lavdëruar është i Vetmi të cilit i bëhet tesbih, Atij, të Vetmit! I Lavdëruar është Ai te i Cili është çdo e mirë e bereqet! I Lavdëruar është Ai te i Cili është gjithë fuqia e fisnikëria! I Lavdëruar është Ai i Cili ka përfshirë

gjithçka me diturinë e Tij! Allahu im! Zembrës time jepi nur (dritë), më jep nur në varr, më jep nur në të dëgjuarit tim dhe të shikuarit tim, jepi nur flokut tim, lëkurës time, muskujve të mi, gjakut tim, eshtrave të mi; nur pastë para meje dhe pas meje, nga e djathta ime dhe nga e majta ime, nuk pastë përmbi mua dhe nën mua! Allahu im, ma shto nurin, më dhuro nur dhe më bëj nur!).”¹²⁰

DUAJA E AJSHES, R.ANHA

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Ajshes, r.anha:

“Lutu më fjalë që përfshijnë të gjitha kuptimet e lutjeve, prandaj kur të bësh dua thuaj:

- Allahumme inni es’eluke minel-hajri kullihi ‘axhilihi ve axhilihi ma alimtu minhu ve ma lem a’lem ve eudhu bike minesh-sherri kulihi axhilihi ve axhilihi ma alimtu minhu ve ma lem a’lem ve es’elukel-xhennete ve ma karrebe ilejha min kavlin ve amelin ve eudhu bike minen-nari ve ma karrebe ilejha min kavlin ve amelin ve es’eluke minel-hajri mimma seeleke abduke ve resuluke Muhammedun salallahu alejhi ve selem ve esteizuke mimmes-teazeke minhu abduke ve resuluke Muhammedun salallahu alejhi ve selem ve es’eluke ma kadajte li min emrin en texh’ale akibetehu resheden bi rahmetike la erhamer-rahimine. (Allahu im! Ty të lus për çdo të mirë, për ato të mëhershme dhe ato të më vonshme, për atë që më është e njohur dhe atë që më është e panjohur. Ty të lus për mbrojtje nga çdo e keqe, nga ajo që vjen më herët dhe ajo që vjen më vonë,

¹²⁰ Tirmidhi dhe Taberani.

nga ajo që më është e njohur dhe ajo që më është e panjohur. Ty të lus për xhennet dhe për vepra e fjalë që afrojnë xhennetit, dhe nga Ti kërkoj mbrojtje nga xhehenemi dhe nga veprat e fjalët që afrojnë xhehenemit. Nga Ti e kërkoj atë të mirë të cilën nga Ti e kërkoi robi Yt dhe i dërguari Yt, Muhammedi, s.a.v.s., dhe mbrojtje kërkoj nga ajo prej të cilës mbrojtjen Tënde e kërkoi edhe robi Yt dhe i dërguari Yt, Muhammedi, s.a.v.s.. Të lutem, pashë rahmetin Tënd, që në këtë që më ke caktuar të më japësh përfundim të mirë e të hajrit, o i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti.)”¹²¹

DUAJA E FATIMES, R.ANHA

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Fatimes, r.anha:

“Oj Fatima! Çfarë të ndalon ta dëgjosh këshillën time: që (në mëngjes, kur të ngritesh dhe në mbrëmje, kur shkon në gjumë) të lexosh:

- Ja hajju ja kajjumu bi rahmetike estegithu, la tekilni ila nefsi tarfete ajnin ve aslih li she’ni kullehu.(O i Gjalli, o i Përjetshmi duke u strehuar në mëshirën Tënde kërkoj ndihmë prej Teje! As për një moment mos më lë të vetëm dhe përmirësoje gjendjen time të përgjithshme!)”¹²²

¹²¹ Ibn Maxhe dhe Hakimi.

¹²² Nesai

DUAJA E EBU BEKR ES-SIDDIK, R.A.

Resulallahu, s.a.v.s., ia mësoi Ebu Bekrit, r.a., këtë dua:

“Allahumme inni es’eluke bi Muhammedin nebijjike ve Ibrahime halilike ve Musa nexhijjike ve Isa kelimetike ve ruhike ve bi tevrati Musa ve inxhili Isa ve zeburi Davude ve Furkani Muhammedin, salallahu alejhi ve seleme ve alejhim exhme’ine ve bi kulli vahjin evhajtehu ev kadain kadajtehu ev sailin a’tajtehu ev ganijjin efkartehu ev fekirin agnejtehu ev dallin hedejtehu ve es’eluke bismikeledhi enzeltehu ala Musa salallahu alejhi ve seleme ve es’eluke bismikeledhi bessete bihi erzaka-l-ibadi ve es’eluke bismikeledhi veda’tehu alel erdi feste-karret ve es’eluke bismikeledhi veda’tehu ale-l-xhibali feresset ve es’eluke bismiket-tuhrittahiri-l-ehadissamedi-l-vitri-l-munezzeli fi kitabike milledunke minennuri-l-mubini ve es’eluke bismikeledhi veda’tehu alennehari festenare ve alel-lejli fa adhleme ve bi adhemetike ve kibrijaike ve bi nuri vexhhike-l-kerimi en turdhikanije-l-Kur’ane ve-l-ilme bihi ve tuhal-litahu bi lahmi ve demi ve sem’i ve besari ve testa’mile bihi xhesedi bi havlike ve kuvvetike fe innehu la havle ve la kuvvete il-la bike ja erhamerrahimine. (Allahu im! Pashë pejgamberin Tënd, Muhammedin, s.a.v.s., mikun Tënd Ibrahimin, bashkëbiseduesin Tënd Musanë, fjalën Tënde Isanë, Tëvratin Tënd që ia shpalle Musasë, Inxhilin Tënd që ia shpalle Isasë, Zeburin Tënd që ia shpalle Davudit, Furkanin Tënd që ia shpalle Muhammedit, salavati dhe selami Yt për të gjithë ata; dhe pashë shpalljen Tënde që e ke shpallur ose caktimit që e ke caktuar, ose atë i cili ka kërkuar e Ti i ke dhënë, ose të pasurin që e ke bërë fukara, ose fukaranë që e ke bërë të pasur, ose të humburin që e ke

udhëzuar, pashë emrin Tënd që ia ke lëshuar Musasë, a.s., emrin Tënd me të Cilin i shpërndanë robëve Tu furnizimin, emrin Tënd që e ke lëshuar në Tokë e aty u qetësua, emrin Tënd që e ke lëshuar në qiell dhe atje u lartësua, emrin Tënd që e ke lëshuar mbi kodra e ato u forcuan, emrin Tënd me të cilin e mbanë Arshin Tënd, emrin Tënd të ndershëm e të pastër el-ehadis-samed të Cilin e ke shpallur në librin Tënd prej nuri të pastër, emrin Tënd që e ke lëshuar mbi ditën, që e ndriçoi, si edhe në natën, që e bëri të errët, dhe pashë madhëstsinë dhe lartësinë Tënde, dhe pashë nurin e fytyrës Tënde fisnike – të lutem, Allah i dashur, të ma dhurosh Kur'anin dhe diturinë për Kur'anin dhe ta përzieësh me mishin tim, gjakun tim, dëgjimin tim dhe shikimin tim, të lutem Ty që trupin tim ta vendosësh në shërbim të Kur'anit, me fuqinë Tënde, sepse nuk ka fuqi pos me Ty, o i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti.)”¹²³

DUAJA E BUREJDE EL-ESLEMI, R.A.

Tregohet se Resulallahu, s.a.v.s., i tha Burejdes:

- O Burejde! A dëshiron të t'i mësoj fjalët të cilat Allahu Teala ia mëson atyre që dëshiron t'i përdorë në rrugë të hajrit, e më pas, do të bëj që kurrë më të mos i harrojnë.

- Dua, o Resulallah!; u përgjigj Burejde, e Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

- Lexo: “Allahumme inni daifun fe kavvi fi ridake da’fi ve hudh ile-l-hajri bi nasijeti vexh’alil-islame munteha ridaje. Allahumme inni daifun fe kavvini ve inni dhelilun fe e’izni ve inni fekirun fe agnini ja erhamerrahimine.

¹²³ Ibn Hibban

(Allahu im! Vërtetë unë jam i dobët, prandaj më forco në rrugën e kënaqësisë Tënde! Më udhëzo në rrugë të së mirës gjithmonë, dhe bëj që islami të jetë qëllim i kënaqësisë time. Allahu im, unë jam i dobët, prandaj më forco! Jam njeri i poshtër, prandaj më lartëso! Jam i varfër, prandaj më pasuro, o i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti.)”¹²⁴

DUAJA E KUBEJSE IBN MEHARIK

Kubejse iu drejtua Resulallahut, s.a.v.s.:

- *Më mëso fjalë që do të jenë të dobishme për fenë time, sepse jam në moshë të thellë dhe shumë ibadete më nuk mund as t’i bëj; e Resulallahu, s.a.v.s., iu përgjigj:*

- *Për dynjallëk, pas namazit të akshamit thuaj tri herë: ‘Subhanellahi ve bihamdihi subhanellahi-l-adhimi ve la havle ve la kuvvete il-la billahil-l-alijjil-l-adhim’ (Lavdia, madhështia dhe falënderimi i takojnë Allahut Nuk ka forcë pos me Allahun, të Lartësuarin e të Fuqishmin.) Vazhdo me këtë dua, sepse ai që vazhdon në këtë, do të jetë i mbrojtur nga shqetësimet, pikëllimi, paraliza dhe sëmundjet e lëkurës. E për ahiretin tënd, thuaj: ‘Allahummehdini min indike vefdil alejje min fadlike venshur alejje min rahmetike ve enzil alejje min berekatike’ (Allahu im, më dhuro udhëzimin Tënd, më mbulo me mirësitë Tua e me rahmetin Tënd, lësho mbi mua bereqetet e Tua).*

Më pas, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

¹²⁴ Hakimi, nga Burejde.

“Nëse robi rregullisht e bën këtë dua, në ditën e Gjykimit do t’i hapen katër dyer të xhennetit, e do të hyjë kah cila të dojë.”¹²⁵

DUAJA E EBU DERDAS, R.A.

Dikush i tha Ebu Derdas:

- *Po të djeget shtëpia!*, e zjarri e kishte kapluar një pjesë të lagjes së tij. Ebu Derda u përgjigj:

- *Nuk do të duhej*; Tri herë ia thanë fjalët e njëjta, e tri herë e përsëriti përgjigjen e njëjtë. Më pas erdhi një person, e i tha:

- *O Ebu Derda, kur zjarri arriti te shtëpia jote, u fik.*

- *Po, e kam ditur*; tha Ebu Derda, e ata i thanë:

- *Sa të çuditshme e ke përgjigjen!*; e Ebu Derda ju tha:

- *Sepse vazhdimisht e bëj duanë:*

‘Allahumme ente rabbi la ilahe il-la ente alejke tevekkeltu ve ente rabbu-l-arshi-ladhimî la kuvvete il-la bil-lahi-l-alijjî-ladhimî ma shaellahu kane ve ma lem jeshe’ lem jekun a’lemu enellahe ala kuli shejin kadirun ve ennellahe kad ehata bikulli shej-in ilmen ve ahsa kulle shej-in adeden. Allahumme inni eudhu bike min sherri nefsi ve min sherri kul-li dabbetin ente ahidhun binasijetiha inne rabbi ala siratin mustekimin’ (Allahu im, Ti je Rabbi im, nuk ka zot pos Teje, në Ty mbështetem, Ti je Rabb i Arshit të lartësuar, nuk ka forcë as lëvizje pos Allahut, të Fortit e të Lartësuarit. Atë çfarë Ai do, ajo ndodh, e atë çfarë Ai nuk do, nuk ndodh, unë vërtetë e di që Allahu Teala mund të bëj

¹²⁵ Ibn Sunnij në ‘*El-Jevm vel-lejle*’ nga Ibn Abbas dhe Imam Ahmedi në *Musned*, nga vet Kubejs.

gjithçka, që Ai i ka përfshirë në diturinë e Tij të gjitha dhe që gjithçkaje ia ka caktuar numrin. Allahu im, tek Ti kërkoj strehim nga e keqja e shpirtit tim dhe e keqja e secilës kafshë, e të gjitha ato janë nën sundimin Tënd; Rabbi im vërtetë vepron drejtë)”¹²⁶, dhe e kam dëgjuar Resulallahun, s.a.v.s., duke thënë:

- Kush e bën vazhdimisht këtë dua, natën ose ditën, asgjë nuk do t’a dëmtojë.”

DUAJA E IBRAHIMIT A.S.

Kur zgjohej nga gjumi, Ibrahim, a.s., e bënte këtë dua:

Allahumme inne hadha halkun xhedidun feftah hu alejje bi ta’atike vatimhu li bi magfiretike ve ridvanike verzukni fihi haseneten tukabbiluha minni ve zekkiha ve da’afha li ve ma amiltu fihi min sejjietin fagfirha li inneke gafururrahimun vedudun kerimun (Allahu im, ky është një fillim i ri, prandaj bëje që për mua të jetë fillim me nënshtrim Ty e të përfundojë me faljen tënde dhe me kënaqësinë Tëndë! Më furnizo në të me vepra të mira që Ti do t’i pranosh nga unë; pastroi ato dhe shtoi ato! E për veprat e këqija që i bëj në të, më fal, sepse Ti vërtetë je Ai që falë, Mëshiruesi, Ai që dashuron shumë, Fisniku).

Kush e lexon këtë dua në mëngjes, e ka kompletuar falënderimin për atë ditë.

¹²⁶ Taberani nga Ebu Derda.

DUAJA E ISASË A.S.

Isa, a.s., e lexonte këtë dua:

Allahumme inni asbahtu la esteti'u def'a ma ekrehu ve la emliku nef'a ma erxhu ve asbeha-l-emru bijedi gajri ve asbahtu murtehinin bi ameli fe la fekireun afkaru minni, Allahumme la tushmit bize aduvvi ve la tesu'bije sadiki ve la texh'al musibeti fi dini ve la texh'aliddun-ja ekbere hemmi ve la tusellit alejje men la jerhamuni ja hajju ja kajjumu (Allahu im! Unë vërtetë nuk jam në gjendje të largoj nga vetja atë që nuk e dua, e as nuk mund ta furnizoj veten me atë që dua; gjërat nuk janë në dorën time e unë jam vetëm peng i veprave të mia; nuk ka fukara më të madh se unë! Allahu im! Mos lejo që armiku të kënaqet në disfatën time, që unë t'i bëj keq armikut tim, që besimin tim ta godasë fatkeqësia dhe që kjo botë të jetë preokupimi im më i madh; mos i jep pushtet mbi mua atij që nuk ka mëshirë me mua, o i Gjalli, i Përhershmi).

DUAJA E HIDRIT A.S.

Transmetohet se Hidri dhe Ilijasi, a.s., sa herë që takoheshin në kohë të caktuar, nuk ndaheshin pa e lexuar këtë dua:

Bismillahi ma sheallahu la kuvvete il-la bil-lahi ma sheallahu kulu ni'metin minellahi ma sheallahu-l-hajru kul-luhu bijedillahi ma shaellahu la jasrifussue ilellahu (Në emër të Allahut, ashtu si do Allahu! Nuk ka fuqi, pos me Allahun! Ashtu si do Allahu! Secila mirësi është nga Allahu! Ashtu si do Allahu! Vetëm Allahu e largon të keqen). Kush e lexon këtë dua tri herë kur të zbardhet dita, do të jetë, në dhashtë Allahu, i mbrojtur nga zjarri, fundosja në ujë dhe vjedhja.

DUAJA E MA'RUF KERHI R.A.

Muhammed ibn Hassan tregon: *"Ma'ruf Kerhi më tha:*

- A t'i mësoj dhjetë fjali: pesë për dynjanë, pesë për ahiretin.

Kush i bën dua Allahut me to, Allahu Teala ia pranon duanë.

Unë i thashë të m'i shkruaj ato fjali, e ai më tha:

*- Nuk do t'i shkruaj, por do t'i përsëris, siç m'i përsëriste mua
Bekr ibn Hunejs, Allahu e mëshiroftë:"*

***Hazbijellahu li dini hasbijellahu li dun-jaje-l-kerimu lima
ehemmeni hasbijalla-hu-l-halimu-l-kavijju limen bega alejje
hasbijellahushshedidu limen kadeni bis-sui hasbijellahurrahimu
inde-l-mevti has-bijellahurreufu inde-l-me'eleti fi-l-kabri
hasbijellahu-l-kerimu inde-l-hisabi has-bijellahulletifu inde-l-
mizani hasbijel-lahu-l-kadiru indes-sirati hasbijellahu la ilahe
illa huve alejhi tevekkeltu ve huve rabbu-l-arshi-l-adhim*** (Allahu
më mjafton për fenë time; Allahu Fisnik më mjafton për atë që
më mundon, Allahu i Urtë e i Fuqishëm më mjafton kundër atij që
më bën padrejtësi; Allahu më mjafton kur të vdes; Allahu i Dashur
më mjafton kur të merrem në pyetje në varr; Allahu Fisnik më
mjafton kur të jap llogarinë; Allahu i Fuqishëm më mjafton kur të
kaloj urën e Siratit; Mua më mjafton Allahu, nuk ka zot pos Tij;
vetëm në Të mbështetem, Ai është Rabb i Arshit madhështor).

Transmetohet se Ebu Derda ka thënë: *"Ai që çdo ditë e lexon
shtatë herë ajetin kur'anor:*

***"Po nëse ata refuzojnë (atë që ua sjell) atëherë thuaj:
Allahu është për mua mjaft, s'ka të adhuroar pos Tij, vetëm te
Ai jam mbështetur, e Ai është Rabbi i Arshit të madh!"***

(9-Teube: 129);

Allahu Teala ia lehtëson punët në lidhje me ahiretin."

DUAJA E UTBE GULAM

Pasi kaloi në ahiret, Utben e panë në ëndërr, e tha:

- Në xhennet hyra duke vazhduar me këtë dua:

Allahumme ja hadije-l-mudillin ve ja rahime-l-mudhnibine ve ja mukile aseratil-asirine irham abdeke dhe-l-hatari-l-adhimi ve-l-muslimine kullehum exhme'ine vexh'alna me'a-l-ahjari-l-merzukineelledhine en'amte alejhim minennebijjine vessiddikine veshshuhedai vessalihine amin ja rabb-l-alemine (Allahu im! O Ti i Cili të humburit i udhëzon në rrugë të Drejtë, i Cili gjynahqarëve ju dhuron mëshirë, i Cili fatkeqëve ua largon gabimet e tyre – bëj mëshirë me robin Tënd, që është në rrezik të madh, bëj rahmet me të gjithë myslimanët dhe na bëj nga të zgjedhurit dhe të furnizuarit prej Teje, të cilëve ju ke dhuruar nga mirësia Jote, peygamberët, të singertët, shehidët dhe robët e mirë! Pranoje duanë, o Rabb i botëve!)

DUAJA E ADEMIT A.S.

Ajsha, r.anha., tregon: “Kur Allahu Teala deshi ta falë Ademin, a.s., e frymëzoi që të bëjë tavaf rreth Qabes shtatë herë, kur Qabeja ishte një formë kodrine. Më pas, Ademi, a.s., i fali dy reqate namaz, dhe lexoi këtë dua:

Allahummeinneke ta'lemu sirri ve alanijjeti fakbel ma'dhireti ve ta'lemu haxheti fa'tini su'li ve ta'lemu ma fi nefsi fagfirli dhunubi. Allahumme inni es-eluke imanen jubashiru kalbi ve jekinen sadikan hatta a'lemu ennehu len jusibeni illa ma ketebtehu alejje verr-rrida bima kasemtehu li ja dhelxhelali vel-ikram (Allahu im! Ti vërtetë e di atë që e fshehu dhe atë që e shfaq, prandaj pranoje arsyetimin tim! Ti vërtetë e di nevojën time, prandaj më dhuro atë që e kërkoj! Ti vërtetë e di se çfarë ka

*në mua, pranaj m'i fal gjynahet e mia! Allahu im, Ty të lus për iman në zemër dhe bindje të singertë e të fortë, ashtu që ta di se nuk do të më godasë asgjë, pos asaj që Ti e ke caktuar; dhe të lutem të më dhurosh kënaqësi me caktimin Tënd, o i Lartësuar e Fisnik); e Allahu Teala i shpalli: **‘Të kam falur! Secilit nga pasardhësit tu, që ma drejton këtë dua që ti ma drejtove, do ta fal dhe nga ai do të largoj telashet dhe vështirësitë, nga ai do të largoj varfërinë dhe do t’ia lehtësoj ashtu që të mirat e kësaj bote vet do t’i vinë, edhe nëse nuk i kërkon’.**”*

DUAJA E ALI IBN EBU TALIB R.A.

Alia, r.a., transmeton nga Resulallahu, s.a.v.s.:

“Allahu Teala e lartëson Vetën çdo ditë, duke thënë:

- Vërtetë Unë jam Allahu, Rabbi i botëve; vërtetë Unë jam Allahu, nuk ka zot pos Meje, të Gjallit dhe të Përhershmit; vërtetë Unë jam Allahu, nuk ka zot pos Meje, të Lartit dhe të Lartësuarit; vërtetë Unë jam Allahu, nuk ka zot pos Meje, nuk kam lindur dikë e as nuk më ka lindur kush; vërtetë Unë jam Allahu, nuk ka zot pos Meje, jam Ai që falë; vërtetë Unë jam Allahu, nuk ka zot pos Meje, Krijuesit të gjithçkaje te i Cili gjithçka kthehet; i Forti, i Urti, Mëshiruesi, Mëshirëploti, Sundues i ditës së Gjykimit, Krijues i të mirës dhe të keqes, Krijues i xhennetit dhe xhehenemit, Një dhe i Vetmi, Ai të Cilin gjithçka i drejtohet. Për vete nuk kam marrë partner, as fëmijë, i Vetmi, Tek, e njoh të fshehurën dhe të dukshmen, Sundimtar, i Shejti, Dhurues i paqes, Dhurues i sigurisë, Ai që vrojton gjithçka, i Fuqishmi, i Lartësuari, Krenari, Krijuesi, i Cili ka fuqi për gjithçka, Ai që sundon, i Urti, Fisniku, i Denjë për çdo lavdatë dhe lartësim, e njoh të dukshmen dhe të fshehurën, i

Fuqishmi, i Cili jep furnizim të bollshëm dhe i Cili është mbi të gjitha krijesat dhe qeniet e gjalla! (Inni enellahu rabbu-l-alemine inni enellahu la ilahe illa ene-l-hajju-l-kajjumu inni enellahu la ilahe illa ene lem elid ve lem juled inni enellahu la ilahe illa ene-l-afuvvul gafuru inni enellahu la ilahe illa ene mubdi’u kulli shej-in ve ilejje je’udu inni enellahu la ailahе illa ene-l-azizul-hakimu inni enellahu la ilahe illa enerrahmanurrahimu inni enellahu la ilahe illa ene maliku jevmiddini inni enellahu la ilahe illa ene haliku-l-hajri ve sherri inni enellahu la ilahe illa ene haliku-l-xheneti ve nari inni enellahu la ilahe illa ene-l-vahidu-l-ehadu inni enellahula la ilahe illa ene-l-ferdussamed inni enellahu la ilahe illa ene lledhi lem jettehidh sahibeten vela veleden inni enellahu la ilahe illa ene-l-ferdu-l-vitru inni enellau la ilahe illa ene alimu-l-gajb veshshehadeti-l-meliku inni enellahu la ilahe illa ene-l-mu’minu-l-muhejminu inni enellahu la ilahe illa ene-l-mutekebbiru-l-haliku inni enellahu la ilahe illa ene-l-bariu-l-musavviru inni enellahu la ilahe illa ene-l-kebiru-l-mute’alu inni enellahu la ilahe illa ene-l-muktediru-l-kahharu inni enellahu la ilahe illa ene-l-halimu-l-kerimu inni enellahu la ilahe illa ene ehlussenai ve-l-mexhdi a’lemussirre ve ahfa inni enellahu la ilahe illa ene-l-kadirurrezaku fevka-l-halik ve-l-halikati.)”¹²⁷ Hazreti Alia, r.a., kur e lexonte këtë dua, në fillim të çdo fjalie thoshte **‘Inni ena’llahu la ilahe illaene’**, e ai që e lexon këtë dua, në vend të kësaj duhet të thotë **‘Inneke enta’llahu la ilahe illa ente’**.

Ata që e lexojnë këtë dua, do të jenë në afërsi të Muhammedit, s.a.v.s., të Ibrahimit, Musasë, Isasë dhe pejgamberëve tjerë, alejhimusselam, dhe do të kenë sevapin e atyre që bëjnë ibadet në qiej dhe në tokë.

¹²⁷ Burimi i hadithit nuk është gjetur.

DUAJA DHE TESBIHU I SULEJMAN BIN MU'TEMIR

Transmetohet se Junus ibn Ubejd e ëndërroi një shehid që vdiq në luftë kundër Romakëve, dhe e pyeti se cilat vepra janë në ahiret më të vlefshmet, e ai iu përgjigj: *“Tesbihu i Sulejmanit ka një vend të posaçëm te Allahu Teala, e ai tesbih është:*

Subhanallahi vel-hamdulilahi ve la ilahe illellahu vallahu ekberu ve la havle ve la kuvvete illa bil-lahi-l-alijji-l-adhimi adede ma haleka ve zinete ma huve halikun ve zinete ma haleka ve zinete ma huve halikun ve mil'e ma huve halikun ve mil'e semavati ve mil'e erdihi ve mithle dhalike ve ad'afe dhalike ve adede halkihi ve zinete arshihi ve munteha rahmetihi ve midade kelimatihî ve meblega ridahu hatta jerda ve adha radije ve adede me dhekerehu bihi halkuhu fi xhemi'i ma meda ve adede mahum dhakiruhu fima bekije fi kulli senetin ve shehrin ve xhum'atin ve jevmin ve lejletin ve saatin minessaati ve shemmin ve nefesin mine-l-enfasi ve ebedin mine-l-abadi min ebedin ila ebedin ebededdun-ja ve ebede-lahireti ve eksere min dhalike la jenkatî'u evveluhu ve la jenfedu ahiruhu (Gjithë lavdi dhe hamdi i takojnë Allahut Teala, nuk ka zot tjetër pos Tij; Allahu është më i madhi; nuk ka forcë as lëvizje pos me Allahun, të Lartësuarin dhe Madhështorin, aq sa ka krijesa dhe sa do të krijohen, me zbukurimin e asaj që Ai ka krijuar dhe asaj që do të krijojë, aq sa mund të mbushin krijesat e Tij dhe sa do të mbushin, aq sa mund të mbushen qiejt e Tij dhe aq sa mund të mbushet Toka e Tij, e edhe kaq e më shumë se kaq, aq sa ka krijesa të Tij dhe zbukurime të Arshit, aq sa është rahmeti i Tij dhe aq sa është e nevojshme që të shkruhen fjalët e Tij e të arrihet kënaqësia e Tij e që Ai të jetë i kënaqur, aq sa e kanë përmendur dhe madhëruar të gjitha krijesat e Tij nga fillimi i

krijimit dhe aq sa do ta përmendin dhe madhërojnë deri në fund të botës, për çdo vit, për çdo muaj, çdo javë, çdo natë e ditë, për çdo orë, dhe çdo frymë dhe për jetë e mot, aq sa të jetë dynjallëku dhe aq sa të jetë ahireti, dhe më shumë se kaq, pa fillim e pa fund).

DUAJA E IBRAHIM ED'HEMIT

Ibrahim ibn Beshshar, shërbëtori, tregon se Ibrahim ibn Ed'hem çdo xhuma, në mëngjes e mbrëmje, e lexonte këtë dua:

Merhaben bi jevmi-l-mezidi vessubhi-l-xhedidi ve-l-kitabshshehidi jevmuna hadha jevmu idin uktub lena fihi ma nekulu bismillahu-l-hamidi-l-mexhidi rrefi'i-l-vedudil-fe'aali fi halkihi ma juridu asbahtu billahi mu'minen ve bi likaihi musaddikan ve bi huxhxhetihi mu'terifen ve min dhenbi mustagfiren ve li rububijetillahi hadi'an ve li sivellahi fi-l-aliheti xhahiden ve ilellahi fekiren ve alellahi muttekilen ve ilellahi muniben ushhidullahe ve ushhidu melaiketehu ve enbijaehu ve rusulehu ve hamelete Arshihi ve men halekahu ve men huve halikuhu bi ennehu huvvallahul-ledhi la illahuve vahdehu la sherike lehu ve enne Muhammeden abduhu ve resuluhu sallahahu alejhi ve seleme teslimen ve enne-l-xhennete hakkun ve ennennare hakkun ve-l-havda hakun veshshefa'ate hakkun ve Munkiren ve Nekiren hakkun ve vaduke hakkun ve ve-iduke hakkun ve likaeke hakkun vessaate atijetun la rejbe fiha ve ennellahe jeb'asu men fi-l-kuburi ala dhalike ahja ve alejhi emutu ve alejhi ub'asu insheellahu. Allahumme ente rabbi la ilahe illa ente halekteni ve ene abduke ve ene ala ahdiqe ve va'dike mesteta'tu eudhu bikallahumme min sherri ma sane'tu ve min sherri kuli dhi sherrin. Allahumme inni dhalemtnu nefsi

fagfirli dhunubi fe innehu la jagfirudhdhunube illa ente vehdini li ahseni-l-ahlaki fe innehu la jehdi li ahseniha illa ente vasrif anni sejjieha fi innehu la jasrifu sejjiiha ila ente lebbejke ve sa'dejke ve-l'hajru kulluhu bijedejke ene leke ve ilejke estagfiruje ve etubu ilejke amentu. Allahumme bi ma erselte min resulin amentullahumme bima enzelte min kitabin ve salallahu ala Muhammedinin-nebijjil-ummijji ve ala alihi ve seleme teslimen kesiren hatemi kelami ve miftahihi ve ala enbijaihi ve resuluhi exhmeine, amine ja rabbelalemine. Allahumme evridna havda Muhammedin ve eskina bike'sihi meshreben revijjen saigan henijjen la nazmeu ba'dehu ebeden vahshurna fi zumretihi gajre hadhaja ve la nakisine lil-ahdi ve la murtabine ve la meftunine ve la magdubin alejna ve la dalline. Allahumma'simni min fitenid-dunya ve veffikni lima tuhibbu ve terda ve aslih li she'ni kulehu ve sebbitni bil-kavlissabiti fil-hajatid-dunya ve fil-ahireti ve la tudilleni ve in kuntu zalimen, subhaneke, subhaneke ja alijjun ja adhimu ja bariu ja rahimu ja azizu ja xhebbaru, subhane men sebbehat lehus-semavatu bi eknafiha ve subhane men sebbehat lehul-biharu bi emvaxhiha ve subhane men sebbehat lehlul-xhibalu bi asdaiha ve subhane men sebbehat lehlul-hitano bi lugatiha ve subhane men sebbehat lehun-nuxhumu fis-semai bi ebraxhiha ve subhane men sebbehat lehul-eshxharu bi usuliha ve simariha ve subhane men sebbehat lehus-semavatus-seb'u vel-erdunes-seb'u ve men fihinne ve men alejhinne subhane men sebbeha lehu kulu shej'in min mahlukatihi tebarekte ve tealejte subhaneke. Subhaneke ja hajju ja kajjumu ja alimu ja halimu subhaneke la ilahe illa ente vahdeke la sherike leke tuhji ve tumitu ve ente hajjun la temutu bijedikel-hajru ve ente ala kulli shej'in kadir

(Mirë se më erdhi kjo ditë, dita kur shpërndahet shpërblim i shumëfishtë, mëngjes i ri, shkrimtar e dëshmitar; mirë se më erdhi kjo ditë e jona, ditë e gëzimit! Na lexo atë që në këtë ditë e lexojmë: Në emër të Allahut, të Lavdëruarit e të denjë për Madhështi, të Lartësuarit e të Dashurit, i Cili me krijesat e Tij bën çfarë Ai do. U zgjova me besim në Allahun, duke mos dyshuar në takimin me Të, duke e pranuar dëshminë e Tij, duke kërkuar falje për gjynahet e mia, duke iu nënshtruar sundimit të Tij, duke mohuar tjetër zot pos Tij, në gjendje të nevojës së madhe për Të, duke shpresuar në Allahun dhe duke iu kthyer Atij. Allahun Teala e ftoj si dëshmitar, edhe melekët e Tij, edhe peygamberët e Tij, edhe të dërguarit e Tij, edhe bartësit e Arshit të Tij, dhe të gjitha krijesat, edhe krijesat që do të krijohen – i ftoj si dëshmotarë që Ai është Allahu, pranë të cilit zot tjetër nuk ka, Një dhe i Vetmi, i Cili nuk ka partner; dhe dëshmoj që Muhammedi është rob i Tij dhe i dërguar i Tij, salallahu alejhi ve selem; dhe dëshmoj që xhenneti është i vërtetë, dhe që xhehenemi është i vërtetë, dhe që burimi (havd) është i vërtetë, dhe që shefati është i vërtetë, dhe që Munkir dhe Nekir janë të vërtetë, dhe që premtimi Yt dhe kërcënimi Yt janë të vërtetë, dhe që takimi me Ty është i vërtetë, dhe që dita e Fundit padyshim po vjen, dhe që Allahu Teala do të ngjallë ata që janë në varre. Me këtë dëshmi jetoj, me të do të vdes dhe me të, në dhashtë Allahu, do të ngjalle. Allahu im, Ti je Rabbi im! Nuk ka zot tjetër pos Teje. Ti më ke krijuar rob Tëndin. I mbahem Marrëveshjes Tënde dhe premtimit Tënd, me mundësitë e mia. Tek Ti strehohem, Allahu im, nga veprat e këqija që i kam bërë dhe nga e keqja e gjithçkaje që bën keq. Allahu im! Unë i kam bërë gjynah vetes, prandaj fali gjynahet e mia, sepse vetëm Ti i falë gjynahet! Më udhëzo në vlerat më të

larta morale, sepse vetëm Ti udhëzon në to! Largo nga unë të gjitha cilësitë e këqija, sepse vetëm Ti mund t'i largosh ato! Të përgjigjem Ty, Rabbi im, dhe drejt Teje ngutem, çdo e mirë është tek Ti! Unë jam i Yti dhe tek Ti kthehem, nga Ti kërkoj falje dhe Ty të shprehi pendimin. Allahu im, unë i besoj peygamberët që i ke dërguar, edhe besoj, Allahu im, në librat që i ke shpallur. Salavat dhe selam Muhammedit, peygamberit që nuk ka ditur të shkruaj dhe familjes së tij, që është përfundim i të folmes time, dhe fillim i saj. Salavat e selam të gjithë peygamberëve dhe të dërguarve. Pranoje këtë nga unë, Allahu im, Rabb i botëve! Allahu im, na dërgo në havdin e Muhammedit, s.a.v.s., na jep të pimë me gotën e tij, dhe pijen pas së cilës kurrë nuk do të ndjejmë etjen, dhe na ringjall në shoqëri të tij, dhe bëj që të kursehem nga shkatërrimi e të mos jemi nga ata që e kanë thyer Marrëveshjen, e të jemi nga ata që aspak nuk dyshojnë, e që nuk i janë ekspozuar sprovës, e që nuk janë nga ata mbi të cilët do të lëshohet zemërimi i Allahut, as nga të humburit. Allahu im, më mbroj nga sprovat e dynjallëkut dhe më përkrah në atë që Ti e do dhe me çka Ti je i kënaqur! M'i përmirëso të gjitha punët e mia dhe më forco me fjalët e vërteta në këtë botë dhe në botën tjetër dhe mos më dërgo në huti, edhe pse jam njëri nga ata që i kanë bërë keq vetes. I Lavdëruar qofsh! I Lavdëruar qofsh o Madhështor, i Lartësuar, Mëshirëploti, i Fuqishmi, i Cili krijon për mrekulli! I Lavdëruar qofsh Ti, të Cilin e madhërojnë të gjithë qiejt në të gjithë shtrirjen e tyre! I Lavdëruar qoftë Ai të Cilin e madhërojnë detet me valët e tyre! I Lavdëruar qoftë Ai të Cilin e madhërojnë kodrat me lartësitë e tyre! I Lavdëruar qoftë Ai të Cilin e lavdërojnë peshqit me gjuhën e tyre! I Lavdëruar qoftë Ai të Cilin e madhërojnë yjet me renditjen e tyre! I Lavdëruar qoftë Ai të

Cilin e madhërojnë drunjtë me rrënjët dhe frutat e tyre! I Lavdëruar qoftë Ai të Cilin e madhërojnë shtatë qiejtë e shtatë botët me gjithçka që është në to e me to! I Lavdëruar qoftë Ai të Cilin e madhëron gjithçka që është krijuar! I Lavdëruar e i Lartësuar qofsh! I Lavdëruar qofsh, o i Gjalli, i Cili mbanë gjithçka gjallë, i Cili i di të gjitha, i Urti! I Lavdëruar qofsh! Nuk ka zot tjetër pos Teje, Një e të Vetmit, që nuk ka partner! Ti i jep jetë gjithçkaje dhe i merr jetën gjithçkaje, ndërsa Ti je gjithmonë i gjallë dhe Ti nuk vdes. Në Ty është çdo e mirë dhe Ti mundesh gjithçka).

Kapitulli i katërt

DUATË QË TRANSMETOHEN NGA RESULALLAHU, S.A.V.S., DHE AS'HABËT E TIJ, R.A.

Këto dua transmetohen nga Resulallahu, s.a.v.s., dhe as'habët e tij, r.a., e janë marrë nga *Përmbledhja e duave* e Ebu Talib Mekki, Ibn Huzejme dhe Ibn Munzir. Është e lavdëruar për udhëtarin e ahiretit që, kur të zgjohet në mëngjes, virdi më i dashur t'i jetë duaja, për çka do të flasim në *Librin e virdeve*. Nëse ti je prej atyre që kërkojnë shpërblim në botën tjetër, që e pasojnë Resulallahun, s.a.v.s. në duatë e tij, atëherë filloje duanë që e bën pas namazit, me këto fjalë:

Subhane rabbijjel-alijil-alel-vehhab la ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul- hamdu ve huve 'ala kulli shej'in kadir. (I Madhëruar është Rabbi im, i Lavdëruari e i Lartësuari, nuk ka zot tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe nuk ka partner. Atij i takon sundimi dhe falënderimi. Ai ka fuqi mbi çdo gjë); pastaj tri herë thuaj:

Raditu billahi rabben ve bil-islami dinen ve bi Muhammedin sallallahu alejhi ve seleme, nebijjen. (Jam i kënaqur që Allahu është Rabbi im, që islami është feja ime dhe që Muhammedi, salallahu alejhi ve selem, është peygamberi im), e më pas thuaj:

Allahumme fatires-semavati vel-erdi alimel-gajbi veshshehadeti rabbe kuli shej'in ve melikehu eshhedu en la ilahe illa ente eudhu bike min sherri nefsi ve sherish-shejtani ve shirkihi. (Allahu im. Krijues i qiejve e Tokës, që e di të fshehtën dhe ashiqaren, Pronar i gjithçkaje, dëshmoj se nuk ka zot pos Teje, tek Ti kërkoj strehim nga e keqja ime dhe mashtrimet e shejtanit dhe shirkut të tij) dhe:

Allahumme inni es'eluke-afve vel-afijete fi dini ve dunjaje ve ehli ve mali. Allahummes-tur avrati ve amin rev'ati ve ekil aserati vahfazni min bejni jedejje ve min halfi ve an jemini ve an shemali ve min fevki ve eudhu bike en ugtale min tahti. Allahumme la teummini mekreke ve la tuvellini gajreke ve la tenzi' anni sitreke ve la tunsini dhikreke ve la texh'alni mune-l-gafiline. (Allahu im, Ty të lutem për falje dhe të mirën për fenë time, për dynjallëkun tim, për familjen time dhe pasurinë time! Allahu im, mbuloi turpet e mia, largoje frikën dhe pengesat e mia dhe më mbroj nga ajo që mund të vijë para meje, pas meje, nga e djathta ime dhe nga e majta ime, përmbi mua, dhe te Ti strehohem të më mbrosh nga dëmi i asaj që mund të vij nën mua. Allahu im, më mbjell frikë nga dënimi prej Teje, mos më lësho në duar të askujt pos Teje, mos e hjek mbrojtjen Tënde prej meje, mos lejo që unë të harroj kujtimin në Ty dhe mos lejo të jem nga ata që janë të pavëmendshëm).¹²⁸

Më pas lexon tri herë:

Allahumme ente rabbi la ilahe il-la ente halekteni ve ene abduke ve ene ala ahdiqe ve va'dike mesteta'tu eudhu bike min sherri me sana'tu ebuu leke bi ni'metike alejje ve ebuu bidhenbi fagfirli le fi innehu jagfirudhdhunube il-la ente. (Allahu im, Ti je Rabbi im! Nuk ka zot tjetër pos Teje, Ti më ke krijuar si robin Tënd. I përmbahem marrëveshjes Tënde dhe premtimit Tënd në kufijt e mundësive të mia. Tek Ti strehohem nga të këqijat që i kam bërë. E pranoj dhe i përmbahem mirësisë Tënde që ma ke dhuruar, e i pranoj edhe gjynahet e mia. Prandaj, nga Ti kërkoj falje, sepse vetëm Ti i falë gjynahet).¹²⁹

¹²⁸ Ebu Davud, Nesai, Ibn Maxhe dhe Hakimi, nga Ibn Omeri.

¹²⁹ Buhari nga Sheddad ibn Evsa.

Më pas, gjithashtu tri herë, lexon:

Allahumme afini fi bedeni ve afini fi sem'i ve afini fi besari la ilahe illa ente (Allahu im, ruaje dhe mbroje trupin tim, ruaje dëgjimin tim, ruaje shikimin tim; nuk ka zot pos Teje!)

Allahumme inni es'eluker-rida ba'del-kadai ve berdel-ajshi ba'del-mevti ve lezzeten-nezari ila vexhhikel-kerimi ve shevkan ila likaike min gajri darrae mudirretin ve la fitnetin mudilletin ve eudhu bike en azlime ev uzleme ev a'tedi ev ju'teda alejje ev eksibe hatieten ev dhenben la tagfiruhu (Allahu im, të lutem Ty për kënaqësinë Tënde pas caktimit Tënd, Të lutem Ty për jetë të rehatshme pas vdekjes, më jep kënaqësinë e shikimit në fytyrën Tënde fisnike, më jep dëshirën për takim me Ty, por që ajo dëshirë të mos më dëmtojë ose të më jetë sprovë që mund të më dërgojë në humbje. Tek Ti kërkoj mbrojtje që të mos i bëj dikujt padrejtësi dhe të mos më bëhet padrejtësi, që të mos i shfaqë dikujt armiqësi e as të mos më shfaqet armiqësi mua, dhe nga secili gjynah dhe gabim që nuk do ta falësh).

Më pas lexo këtë dua:

Allahumme inni es'elukes-sebate fil-emri vel-azimete fir-rushdi ve es'eluke shukre ni'metike ve husne ibadetike ve es'eluke kalben hashian selimen ve hulukan mustekimen ve lisanen sadikan ve amelen mutekabbelen kimen ve lisanen sadikan ve amelen mutekabbelen ve es'eluke min hajri ma ta'lemu fe inneke ta'lemu ve la a'lemu ve ente allamul-gujub. (Allahu im, më dhuro forcë dhe vendosmëri në veprim të drejtë; më mundëso të Të falënderoj Ty dhe që në mënyrën më të bukur të Të bëj ibadet; më dhuro zemër të përulur e të dorëzuar, me moral të bukur e të drejtë, gjuhë që e flet të vërtetën dhe vepër që do të pranohet! Nga Ti kërkoj të mirën për të cilën Ti e di dhe

mbrojtje nga e keqja të cilën Ti e di, dhe të lutem për falje për atë që nuk është e fshehur prej Teje, sepse Ti di, e unë nuk di, Ti je Njohës i gjithçkaje të fshehur).

Allahummag-fir li ma kaddemtu ve ma ehhartu ve ma esrertu ve ma a'lemtu ve ma ente a'lemu bihi minni fe inneke entel-mukaddimu ve entel-muehhiru ve ente ala kuli shej'in kadir ve ala kuli gajbin shehid. (Allahu im, më fal atë që e kam bërë më herët, edhe atë që do ta bëj, edhe atë që e kam fshehur, edhe atë që e kam shprehur, edhe atë që Ti e di më mirë se unë! Ti çon përpara, Ti kthen mbrapa, Ti mundesh gjithçka! Gjithçka të fshehur Ti e njeh mirë!)

Allahumme inni e'eluke imanen la terteddu ve ne'imen la jenfedu ve kurrete ajnil-ebedi ve murafe-kate nebijiike Muhammedin salallahu alejhi ve selem fi a'la xhennetil-huldi. (Allahu im, më fal iman pas të cilit nuk bie në mosbesim, mirësi të pafund, gëzim të përhershëm dhe shoqërinë e Pejgamberit Tënd, s.a.v.s., në lartësitë e përhershme të xhennetit).

Allahumme inni es'eluket-tajjibati ve fi'lel-hajrati ve terkel-munkerati ve hubbel-mesakini es'eluke hubbeke men ehabbeke ve hubbe kuli amelin jukaribu ila hubbike ve en tetube alejje ve tagfire li ve terhameni ve idha eredte bikavmin fitneten fakbidni ilejke gajre meftun. (Allahu im! Më dhuro mirësi, më mundësi kryerjen e veprave të mira dhe braktisjen e të këqijave, dhe më mbjell dashuri ndaj të varfërve! Më dhuro dashurinë Tënde, dashurinë e atyre që Ty të duan, dëshirë për secilën vepër që më afron tek dashuria Jote! Pranoje pendimin tim, më fal e më mëshiro, e kur vendos të dënosh popullin, më merr afër Vetes para se unë të bie në sprovë).

Allahumme bi ilmikel-gajbe ve kudretike al-el-halki ahjini ma kanetil-hajatu hajren li ve teveffeni ma kanetil-vefatu hajren li es'eluke hashjeteke fil-gajbi vesh-shehadeti ve kelimetel-adli fir-rida vel-gadabi vel-kasde fil-gina vel-fakri ve lezzeten-nesari ila vexhhike vesh-shevka ila likaike ve eudhu bike min darrae mudirretin ve fitnetin mudilletin. Allahumme zejjinna bi zinetil-imani vexhalna hudaten muhtedin. (Allahu im! Pashë diturinë Tënde për të panjohurën dhe pushtetit Tënd mbi krijesat, më mbaj gjallë deri sa në këtë jetë të ketë të mira për mua, dhe më vdis kur vdekja të jetë më e mirë për mua. Më dhuro frikë prej Teje kur jam vetëm dhe kur jam mes njerëzve, dhe fjalën e drejtë kur jam në disponim të mirë dhe kur jam i zemëruar, dhe maturi në pasuri e në varfëri, dhe kënaqësinë e shikimit të fytyrës Tënde, dhe mall për takim me Ty. Tek Ti strehohem të më mbrosh nga e keqja dhe sprova që dërgon në humbje. Allahu im, na zbukuro me stolinë e imanit dhe bëj të jemi nga ata që janë në rrugë të Drejtë dhe që thërrasin në atë rrugë).

Allahummak-sim lena min hashjetike ma tehulu bihi bejnena ve bejne measike ve min ta'atike ma tubelliguna bihi xhenneteke ve minel-jekini ma tuhevvinu bihi alejna mesaibed-dunya vel-ahireti. (Allahu ynë! Na dhuro aq frikë sa të na pengojë të bëjmë gjynahe; na dhuro aq nënshtrim Ty, sa të na sjellë në xhennetin Tënd; na dhuro aq qëndrueshmëri në besim sa për të përballuar vështirësitë në këtë botë dhe në botën tjetër).

Allahume-m-le' vuxhuhena minke hajaen ve kulubena minke ferekan ve eskin fi nufusina min azametike ma tuzellilu bihi xhevarihana li hidmetike vexh-alkellahumme ehabbe ilejna mimmen sivake vexh-alna ahsha leke mimmen sivake (Allahu ynë! Mbushi fytyrat tona me turp ndaj Teje, mbushi zemrat tona

me frikë ndaj Teje e shpirtat tanë mbushi me vetëdije për madhështinë Tënde me të cilën do të nënshtrosh gjymtyrët tona që të jenë vetëm në shërbimin Tënd. Allahu ynë, bëj që për neve Ti të jesh më i dashur se gjithçka tjetër dhe që prej Teje të kemi frikë më shumë se prej çfarëdo tjetër).

Allahummexh-al evvele jevmına haza salahan ve evsetahu felahan ve ahirehu nexhahan. Allahummexh-al evvelehu rahmeten ve evsetahu ni'meten ve ahirehu tekrimeten ve magfireten. (Allahu ynë! Bëje fillimin e kësaj dite tonë të mbarë, mesin e saj të mirë, e përfundimin e saj të suksesshëm! Allahu ynë! Mbushe fillimin e kësaj dite me mëshirë, mesin e saj me bereqet, e përfundimin e saj me nderim e falje!)

Elhamdu lilahiledhi tevadaa kulu shej'in li adhametihi ve dhele kulu shej'in li idhdhetihi ve hada'a kulu shej'in li mulkihi vestesleme kulu shej'in li kudretihi vel-hamdu lilahil-ledhi sekene kulu shej'in li hejbetihi ve az'here kulu shej'in bi hikmetihi ve tesagare kulu shej'in li kibrija'ihı. (Hamd Allahut, madhështisë së Tij gjithçka i nënshtrohet, para fuqisë së Tij gjithçka është një hiq, pushtetit të Tij gjithçka i nënshtrohet dhe forcës së Tij gjithçka i dorëzohet. Hamd Allahut, para madhështisë së Tij gjithçka heshtet, me urtësinë e Tij gjithçka manifestohet dhe madhësisë së Tij gjithçka i nënshtrohet).

Allahumme sali ala Muhammedin ve ala ali Muhammedin ve ezvaxhi Muhammedin ve dhurrijjetihi ve barik ala Muhammedin ve ala alihi ve ezvaxhihi ve dhurrijjetihi kema barekte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim fil-alemine inneke hamidun mexhid. (Allahu ynë! Bekoje Muhammedin, familjen e tij, gratë e tij, pasardhësit e tij, si e ke mbuluar me mirësi

Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, në të gjitha botët. Vërtetë Ti je i lavdëruar, i lartësuar!)

Allahumme sali ala Muhammedin abdike ve nebijiike ve resuliken-nebijil-ummijji resulikel-emiini ve a'tihil-mekamel-mahmudel-ledhi veadtehu jevmed-din (O Allah, salavati Yt mbi Muhammedin, robin Tënd, Pejgamberin e të Dërguarin, që s'dinte shkrim dhe lexim, besnik, dhe dhuroi atij vendin e vlefshëm e të lavdëruar që ia ke premtuar në Ditën e gjykimit).

Allahummexh'alna min evlijaike-l-muttekine ve hizbike-l-muflihine ve ibadikessalihine vesta'milna limerdatike anna ve veffikna limehabbike minna ve sarrijfna bihusni ihtijarike lena (Allahu ynë! Bëj të jemi robë Tu të devotshëm, të jemi në grupin që Ti e shpëton, të jemi robë Tu të singertë! Na përdor për atë me çka Tj je i kënaqur, na ndihmo në atë që Ti e do dhe na mbrojt duke zgjedhë të mirën për ne.)

Nes'eluke xhevamial-hajri ve fevatihahu ve havatime-hu ve neudhu bike min xhevami'ish-sherri ve fevatihahi ve havatimihi. (Na dhuro çdo të mirë, në fillim dhe në fund, dhe na ruaj nga çdo e keqe, në fillim dhe në fund).

Allahumme bi kudretike alejje tub alejje inneke entet-tevvabur-rahim ve bi hilmike anni-'fu anni inneke entel-gaffarul-halim ve bi ilmike bir-fuk bi inneke ente erhamur-rahimine ve bi mulkike li melikni nefsi ve la tuselitha alejje inneke entel-melikul-xhebbaru. (Allahu ynë! Pashë pushtetin Tënd mbi mua, pranoje pendimin tim, sepse Ti je, vërtetë, Mëshiruesi dhe Ai që e pranon pendimin. Pashë butësinë tënde ndaj meje, më fal, sepse Ti je, vërtetë, i Urti dhe Ai i Cili shumë falë. Pashë diturinë Tënde për mua, shpreh kujdesin ndaj meje, sepse Ti je, vërtetë, Mëshiruesi, Mëshirëploti! Pashë pushtetin

Tënd mbi Mua, fute nefsin tim nën kontrollën time dhe mos lejo që ai të më kontrollojë mua, sepse Ti je, vërtetë, Sunduesi, i Fuqishmi!)

Subhanekellahumme ve bi hamdike la ilahe ila ente amiltu suen ve zalemto nefsi fagfir li zenbi inneke ente rabbi ve la jagfirudhdhunube ila ente. (I Lavdëruar qofsh, Allahu im, dhe hamd i pafund qoftë për Ty, nuk ka zot pos Teje! Kam bërë vepër të shëmtuar dhe i kam bërë keq vetes, prandaj, ma fal gjynahun tim, sepse Ti je, vërtetë, Rabbi im dhe vetëm Ti i falë gjynahet).

Allahumme elhimni rushdi ve kini sherre nefsi. (Allahu im! Më dhuro maturi dhe më ruaj prej të keqes së nefsit tim!)

Allahummer-zukni halalen la tuakibuni alejhi ve kanni'ni bi ma rezakteni ves-ta'milni bihi salihan takbeluhu minni. (Allahu im! Më dhuro furnizim hallall për të cilën nuk do të më dënosh dhe më dhuro kënaqësi në atë që ma ke ndarë, dhe ma mundëso që atë ta përdori në të mirën që Ti do ta pranosh nga unë).

Allahumme inni es'elukel-afve vel-afijete ve husnel-jekini vel-muafate fid-dunya vel-ahireti. (Allahu im! Të lutem për falje, shëndet, bindje dhe mbrojtje, në këtë botë dhe në botën tjetër).

Ja men la tedurruhdhdhunubu ve la tenkusuhul-magfiretu heb li ma la jedurruke ve a'tini ma la junkisuke. (O Ti, të Cilit gjynahet nuk i bëjnë dëm dhe që nuk ka mungesë të faljes, më dhuro atë që Ty nuk të dëmton dhe atë që Ty nuk të mungon).

“Rabbi ynë, na dhuro durim dhe na bëjë të vdesim myslimanë!” 7-Araf: 126

“Ti je kujdestar imi në dynja e në ahiret, më bën të vdes mysliman dhe më bashko me të mirë!” 12-Jusuf: 101

"Ti je mbrojtësi ynë, pra falna e mëshirona, se Ti je më i miri që falë (gabimet).

Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në dynja dhe të mirë në botën tjetër, se vërtet jemi kthyer kah Ti." 7-Araf: 155, 156

"O Rabbi ynë, te Ti mbështetemi dhe Ty të drejtohem i dhe te Ti do të kthehem i." 60-Mumtehine: 4

"O Rabbi ynë, mos na vënë në sprovë të popullit zullumqarë" 10-Junus: 85

"O Rabbi ynë, mos lejo që të bijmë në provë të pafeve dhe falna neve. O Rabbi ynë, me të vërtetë, Ti je i Plotëfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm." 60-Mumtehine: 5

"O Rabbi ynë! Falna mëkatet tona dhe teprimin në punën tonë, forcona këmbët tona dhe ndihmona kundër popullit jobesimtar!" 3-Ali Imran: 147

"O Rabbi ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve; O Rabbi ynë, Ti je, me të vërtetë, i mirë dhe mëshirues!" 59-Hashr: 10

"O Rabbi ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë!" 18-Kehf: 10

"O Rabbi ynë, na jep të mira në këtë jetë dhe në jetën tjetër! Dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!" 2-Bekare: 201

"O Rabbi ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): *Besoni Rabbin tuaj!* E ne besuam! O Rabbi ynë, na i falë mëkatet tona, na i mbulo të metat dhe pas vdekjes na bashko me të mirët!

"O Rabbi ynë, na jep atë që nëpërmjet të dërguarëve Tu, na e premtove dhe në ditën e kijametit mos na turpëro; vërtet Ti je Ai që nuk e shkel premtimin!" 3-Ali Imran: 193, 194

"O Rabbi ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë! O Rabbi ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh! O Rabbi ynë, mos na ngarko me atë për të cilën ne nuk kemi fuqi! Na i shlyej mëkatet, na i mbulo të këqijat, na mëshiro. Ti je mbrojtësi ynë, na ndihmo kundër popullit pabesimtar!" 2-Bekare: 286

Rabbigfirli ve li valdejje verhamhuha kema rebbejani sagiren vagfir li-l-mu'minine ve-l-mu'minati ve-l-muslimine ve-l-muslimati-l-ahjai minhum vel-emvati. (Rabbi im, më fal mua dhe prindërit e mi, siç kishin mëshirë ata për mua, kur isha i vogël, dhe fali të gjithë besimtarët, dhe të gjithë myslimanët e myslimanet, atyre që ende janë në jetë dhe atyre që kanë kaluar në ahiret).

Rabbigfir verham ve texhavez amma ta'lemu ve ente-l-e'azzul-ekrem ve ente hajrurr-rrahimin ve ente hajru-l-gafirine ve inna lilahi ve inna ilejhi raxhi'une ve la havle ve la kuvvete illa billahi-l-alijji-l-adhim ve hasbunellahu ve ni'me-l-vekilu ve sallahahu ala Muhammedin hatiminnebijjine ve alihi ve sahbihi ve selleme teslimen kethiren. (Allahu im, më fal, më mëshiro dhe lëji në harresë ato gjynahe tona që vetëm Ti i di, sepse Ti je më i Lartësuar dhe më Fisniku, Ti je Mëshiruesi më i mirë dhe Ti falë më së shumti! Vërtetë ne jemi të Allahut dhe vërtetë Atij i kthehemi! Nuk ka forcë as vullnet pos me Allahun, të Lartësuarin dhe Madhështorin! Salavat dhe selam pafund Muhammedit, vules së pejgamberëve, familjes së tij dhe as'habëve të tij).¹³⁰

¹³⁰ Ebu Davud dhe Ibn Maxhe.

TEALA

Allahumme inni eudhu bike minel-buhli ve eudhu bike minel-xhubni ve eudhu bike min en uredde ila erzelil-umuri ve eudhu bike min fitnetid-dunya ve eudhu bike min adhabil-kabri. Allahumme inni eudhu bike min tab'in jehdi ila tamein ve min tamein fi gajri matmein ve min tamein min hajsu la matmea. Allahumme inni eudhu bike min ilmin la jenfeu ve kalbin la jahsheu ve dua-in la jusmeu ve nefsin la teshbeu ve eudhu bike minel-xhui fe innehu bi'sed-daxhiux ve minel-hijaneti fe inneha bi'setil-bitanetu ve minel-keseli vel-buhli vel-xhubni vel-heremi ve min en uredde ila erdhelil-umuri ve min fitnetid-dexhxhali ve azabil-kabri ve min fitnetil-mahja vel-memati. Allahumme inna nes-eluke kuluben evvaheten muhbiteten munibeten fi sebilike. Allahumme inni es-eluke azaima magfiredike ve muxhibati rahmetike ves-selamete min kuli ismin vel-ganimete min kuli birrin vel-fevze bil-xhenneti ven-nexhate minen-nari. Allahumme inni eudhu bike minet-tereddi ve eudhu bike minel-gammi vel-gareki vel-hedmi ve eudhu bike min en emute fi sebilike mudbiren ve eudhu bike min en emute fil tetallubid-dunya. Allahumme inni eudhu bike min sherri ma alimtu ve min sherri ma lem a'lem. Allahumme xhennibni munkeratil-ahlaki vel-'amali vel-edvai vel-ehva. Allahumme inni eudhu bike min xhehdil-belai ve derkish-shekai ve su'il-kaddai ve shematetil-a'dai. Allahumme inni eudhu bike minel-kufri ved-dejmi vel-fakri ve eudhu bike min azabi xhehenneme ve eudhu bike min fitnetid-dexhxhalli. Allahumme inni eudhu bike min sherri sem'i ve besari ve sherri lisani ve kalbi ve sherri menijji. Allahumme inni eudhu bike min xharis-su'i fi daril-mekameti fe inne xharel-

badijeti jetehavvelu. Allahumme inni eudhu bike minel-kasveti vel-gafleti vel-ajleti vez-zelleti vel-meskenetive eudhu bike minel-kufri vel-fakri vel-fusuki vesh-shikaki ven-nifaki ve suil-ahlakive dikil-erzaki ves-sum'ati ver-rijai ve eudhu bike mines-samemi vel-bekemi vel-ama vel-xhununi vel-xhuzami vel-beresi ve seji-il-eskami. Allahumme inni eudhu bike min zevalli ni'metike ve min tehavvuli afijetike ve min fexh'eti nakmetike ve min xhemi'i sehatike. Allahumme inni eudhu bike min azabin-nari ve fitnetin-nari ve azabil-kabri ve fitnetil-kabri ve sherri fitnetil-gina ve sherri fitnetil-fakri ve sherri fitnetil-Mesihid-Dexhkhalli ve eudhu bike minel-magremi vel-me'semi. Allahumme inni eudhu bike min nefsin la teshbeu ve kalbim la jahsheu ve salatin la tenfeu ve da'vetin la tustexhabu ve eudhu bike min sherril-gammi ve fitnetis-sadri. Allahumme inni eudhu bike min galebetid-dejni ve galebetil-aduvvi ve shematetil-a'da'i (Rabbi im, tek Ti kërkoj mbrojtje nga koprracia dhe qyqarllëku, tek Ti kërkoj mbrojtje nga pleqëria e thellë, sprovat e kësaj bote dhe tmerrit të varrit. Allahu im! Më mbroj nga shprehinë që më dërgojnë në lakmi, dhe më mbrojnë nga lakmia për atë që nuk duhet, dhe më mbrojnë nga lakmia për atë që nuk e meriton lakminë! Allahu im! Më mbroj nga dituria nga e cila nuk ka dobi, nga zemra që nuk ka frikë, nga duaja që nuk arrin te Ti dhe më mbroj nga shpirti i pangopur! Më mbroj nga uria, sepse ajo është shoqërues i shëmtuar! Më mbroj nga tradhëtia, sepse, sa veti e keqe është ajo! Më mbroj nga dembelia, koprracia, qyqarllëku, pleqëria e thellë dhe harresa, dhe nga sprovat që i sjell Dexhkhalli, dhe nga tmerri i varrit, dhe nga sprova që vjen me jetën dhe me vdekjen! Allahu ynë! Na dhuro zemra të përlura Ty dhe të dorëzuara e të qëndrueshme në rrugën Tënde.

Allahu im! Ty të lutem për atë që do të ma sjell faljen Tënde, mëshirën Tënde dhe mbrojtjen Tënde nga çfarëdo gjynahu! Prej Teje kërkoj shpërblimin për secilën vepër të mirë, dhe fitoren përfundimtare me xhennet dhe me shpëtim nga Zjarri. Allahu im! Më ruaj nga pavendosmëria! Më ruaj nga brenga e rëndë, mbytja në ujë dhe shkatërrimi! Mos lejo që në rrugën Tënde të vdes duke ikur, e as të vdes duke i dashur të mirat e kësaj bote. Allahu im! Më ruaj nga e keqja që e njoh dhe e keqja që nuk e njoh! Allahu im! Më ruaj nga morali i shëmtuar, nga sëmundja dhe kërkesat! Allahu im! Më ruaj nga mundi i kotë, fatkeqësia, kismeti i shëmtuar dhe e keqja e armikut! Allahu im! Më ruaj nga tradhtia, borxhi dhe varfëria! Më ruaj nga dënimi i xhehenemit dhe sprovës që vjen me Dexhxxhallin! Allahu im! Më ruaj nga e keqja e dëgjimit tim, shikimit tim, dhe e keqja e gjuhës time dhe zemrës, dhe e keqja e dëshirave të mia! Allahu im! Më ruaj nga komshiu i keq në shtëpinë e përhershme, sepse komshiu në vendqëndrimin kalimtar ndërrohet! Allahu im! Më ruaj nga vrazhdësia, pakujdesi, varfëria dhe mjerimi! Më ruaj nga tradhëtia, varfëria, gabimi, fatkeqësia, dyfytirësia, morali i shëmtuar, furnizimi i pamjaftueshëm, dëshira për famë e lavdërim! Më ruaj nga shurdhimi, memecëria, verbëria, çmenduria, sëmundja e leprës, mortajës dhe sëmundjet tjera të rënda! Allahu im! Mos lejo të mbetem pa mirësinë Tënde, e as që mirësia jote të ndryshojë! Më ruaj nga hakmarrja jote e përnjëhershme dhe nga gjithçka që shkakton zemërimin Tënd! Allahu im! Më ruaj nga vuajtja e xhehenemit dhe sprovë e xhehenemit, vuajtja e varrit dhe sprovë e varrit, e keqja e sprovës me pasuri dhe e keqja e sprovës me varfëri, dhe e keqja e sprovës së Mesihut Dexhxxhall! Më ruaj nga borxhi dhe gjynahu! Allahu

*im! Më ruaj nga shpirti i pangopur, zemra që nuk ka frikë Allahun, namazi që nuk sjell dobi dhe dua që nuk plotësohet! Më ruaj nga e keqja që e sjellë brenga dhe sprovat e gjoksit! Allahu im! Më ruaj nga borxhi i madh, fitorja e armikut dhe e keqja e armikut!)*¹³¹

Le të jetë salavati i Allahut Teala mbi Muhammedin dhe secilin rob të zgjedhur nga të gjitha botët! Amin!

¹³¹ Nesai dhe Hakimi nga Abdullah ibn Amr. Hakimi thotë se i plotëson kushtet e Muslimit.

Kapitulli i pestë

DUATË NË MOMENTE TË RËNDËSISHME

Kur zgjohesh nga gjumi dhe e dëgjon ezanin, është mirë t'i përgjigjesh thirrjes së muezinit, për çka kemi folë më herët, siç i kemi përmendur edhe duatë me rastin e hyrjes në nevojtoire dhe daljes nga aty, si edhe duatë kur të merret abdes. I kemi përmendur këto në *Librin për fshehtësitë e pastërtisë*.

Kur të nisësh për në xhami, lexoje këtë dua:

Allahumme-xh'al fi kalbi nuren ve fi lisani nuren ve xh'al fi sem'i nuren ve-xh'al fi besari nuren ve-xh'al halfi nuren ve emami nuren ve'-xh'al min fevki nuren. Allahumme a'tini nuren. (Allahu im! Le të jetë zemra ime prej nuri, le të jetë gjuha ime prej nuri, le të jetë dëgjimi im dhe shikimi im prej nuri. Le të jetë nur (dritë) pas meje e para meje, dhe le të jetë nur mbi mua. Allahu im, më dhuro nur!).¹³² Gjithashtu, lexo edhe këtë:

Allahumme inni es-eluke bi hakkis-sa'iline alejke ve bi hakki memshaje hadha ilejke fe inni lem ahruxh esheren ve la betaren ve la rijaen ve la sum'aten harexhtut-tikae suhtike vebtigae merdatike fe es-eluke en tunkizeni min-nari ve en tagfire li dhunubi innehu la jagfirudhdhunube illa ente. (Allahu im! Pashë ata që kanë kërkuar prej Teje dhe pashë këtë ecje timen, nuk jam nisur duke e dëshiruar të keqen, as telashen, as reputacion, as nuk jam nisur që të më shohin të tjerët; jam nisur me shpresën se do të ruhem nga zemërimi Yt dhe do të përfitoj kënaqësinë Tënde, prandaj të lus të më mbrosh nga zjarri dhe të m'i falësh gjynahet e mia, sepse vetëm Ti i falë gjynahet!)¹³³

¹³² Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Abbas

¹³³ Ibn Maxhe nga Ebu Seid Hudri.

Kur del nga shtëpia për ndonjë nevojë, lexo këtë dua:

Bismilahi rabbi eudhu bike en adhlime ve udhleme, ev exhhile ev juxhhelu alejje, bismillahir-rahmanir-rahim, ve la havle ve la kuvvete illa bilahil-alijil-adhim, bismillahit-tekilanu alallah. (Bismilah, o Rabbi im, tek Ti kërkoj mbrojtje nga bërja padrejtësi dikujt ose që mua të më bëhet padrejtësi; që të mos veproj me mosdije ose që ndaj meje të mos veprohet me mosdije.¹³⁴ ***Bismilahir-rahmanir-rahim.*** Nuk ka fuqi as forcë pa Allahun të Lartësuar e Madhështor, dhe tek Ai i mbaj shpresat.¹³⁵

Kur të arrish në xhami, gjatë hyrjes lexoje këtë dua:

Allahumme Sali ala Muhammedin ve ala ali Muhammedin ve selim, Allahummagfir li xhemia dhunubi vef-tah li ebvabe rahmetike. (Allahu im, dërgoi salavat dhe selam Muhammedit dhe familjes së Muhammedit! Allahu im, m'i fal të gjitha gjynahet e mia dhe m'i hap dyert e mëshirës Tënde!)¹³⁶

Kur të hysh në xhami, hyn me këmbën e djathtë. Nëse e sheh se dikush në xhami po bën tregti, thuaj:

La erbehallahu tixhareteke (E lus Allahun Teala që tregtia juaj të mos ketë sukses!)¹³⁷

Nëse në xhami sheh dikë që pyet për mall të humbur, thuaj:

La reddehellahu alejke (E lus Allahun Teala mos ta kthejë!)¹³⁸ Kështu ka urdhëruar Resulallahu, s.a.v.s.. E kur të falësh dy reqate të namazit të sabahut, lexo duanë e plotë nga Ibn Abbasi, r.a., që e treguam në kapitullin e tretë.

¹³⁴ Shënojnë autorët e *Sunenit* nga Ummu Seleme, ndërsa Tirmidhi thotë se është hasen-sahih.

¹³⁵ Shënon Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre.

¹³⁶ Tirmidhi dhe Ibn Maxhe, nga Fatime r.anha.

¹³⁷ Tirmidhi.

¹³⁸ Muslimi, nga Ebu Hurejre.

Sa je në ruku, lexo këtë dua:

Allahumme leke reka'tu ve leke hashe'tu ve bike amentu ve leke eslemtu ve alejke tevekkeltu ente rabbi hashea sem'i ve besari ve muhhi ve adhmi ve asabi ve mestekallet bihi kademi lillahi rabbil-alemin. (Allahu im, Ty t'u përula (të bëra ruku), dhe Ty të jam dorëzuar, Ty të besoj dhe Ty të nënshtrohem, dhe në Ty mbaj shpresë. Ti je Rabbi im! Nënshttrim Ty të shpreh dëgjimi im, shikimi im, mendja ime, eshtrat e mi dhe nervat e mi, e në këmbë qëndroj i nënshtroar Allahut, Rabbit të botëve.)¹³⁹, ose tri herë:

Subhane rabbijel-adhim (I Lavdëruar qoftë Rabbi im Madhështor!)¹⁴⁰; ose mund të lexosh këtë:

Subbuhun kuddusun rabbul-melaiketi ve'r-ruh. (I Lavdëruar qoftë Allahu, Rabb i melekëve dhe i shpirtit!)¹⁴¹

E kur drejtohesh prej rukusë, lexo këtë dua:

Semiallahu limen hamideh rabbena lekel-hamdu mil'es-semavati ve mil'el-erdi ve mil'e ma shi'te min shej'in ba'du ehliissenai vel mexhdi ehakku ma kalel-abdu ve kuluna leke abdun la mania lima a'tajte ve la mu'tije lima mena'te ve la jenfeu dhel-xheddi minkel-xhedde (Dëgjoi Allahu atë që falënderon! Rabbi ynë, hamd Ty sa hapësira e Tokës dhe ajo që Ti do, pas falënderimit e madhërimit më të drejtë e më të mirë që ndonjë rob i Yti e ka thënë, e ne të gjithë jemi robë Tu. Askush nuk mund të ndalë çfarë Ti dhuron, dhe askush nuk mund të japë çfarë Ti ndalon, askush nuk ka ndikim në vendimin Tënd).¹⁴²

¹³⁹ Muslimi nga Alia, r.a..

¹⁴⁰ Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ibn Maxhe nga Ibn Mesud.

¹⁴¹ Muslimi, nga Ajshe, r.anha.

¹⁴² Muslimi nga Ebu Seid Hudri dhe Ibn Abbas. Nesai në *el-Jevm vel-lejle* nga Hasan ibn Ali Ma'meri, te Muslimi nga Ibn Ebu Evfa e te Buhari nga Ebu Hurejre.

Kur të bësh sexhden, lexoje këtë dua:

Allahumme leke sexhdedu ve bike amentu ve leke eslemtu sexhede vexhhije liledhi halekahu ve savverehu ve shekka sem'ahu ve besarehu fetebarekel-lahu ahsenul-halikin. Allahumme sexhede leke sevadi ve hajali ve amene bike fu-adi ebu'u leke bini'metike alejje ve ebuu bidhenbi ve hadha ma xhenejtu ala nefsi fa-g-fir li fe innehu la jagfirudhdhunube illa ente. (Allahu im! Ty sexhde të bëj, në Ty besoj, Ty të shprehu nënshtrimin tim. Sexhde i bën fytyra ime Atij që e krijoi e i dha formë, i dhuroi dëgjim e shikim, prandaj i lartësuar qoftë Allahu Teala, më i miri krijues. Ty sexhde të bën trupi im e shpirti im, e zemra ime beson në Ty. T'i pranoj të gjitha mirësitë që m'i ke dhuruar, e pranoj edhe gjynahun tim, dhe i kam bërë padrejtësi vetes, prandaj më fal, sepse vetëm Ti i falë gjynahet).¹⁴³

Ose mund të lexosh tri herë:

Subhane rabbijel-a'la (Lavdëruar qoftë Rabbi im i lartësuar).

Kur të përfundosh namazin, lexoje këtë:

Allahumme entes-selamu ve minkes-selamu tebarekte ja dhel-xhelali vel-ikram. (Rabbi ynë, Ti je burim i shpëtimit dhe nga Ti vjen shpërtimi. I Lartësuar je Ti, o Rabb i madhështisë dhe fisnikërisë)¹⁴⁴

Pas kësaj mund të lexosh duatë tjera që i kemi përmendur. Kur të largohesh nga ndonjë tubim dhe dëshiron të lexosh dua me të cilën Allahu Teala do të largojë nga ti gabimet e mundshme të bëra gjatë atij tubimi, atëherë lexo këtë dua:

¹⁴³ Muslimi nga Alia, r.a..

¹⁴⁴ Muslimi nga Sevan.

Subhanekellahumme ve bihamdike eshhedu en la ilahe il-la ente estagfiruke ve etubu ilejke amiltu suen ve dhalemtu nefsi fa-g-fir li fe innehu la jagfirudhdhunube il-la ente. (i Lartësuar qofsh Allahu im, e hamd për Ty! Dëshmoj se nuk ka zot pos Teje. Nga Ti kërkoj falje, Ty të pendohem. Kam bërë vepër të shëmtuar e i kam bërë keq vetes; më fal, sepse vetëm Ti i falë gjynahet!)¹⁴⁵

Kur të hysh në pazar ose dyqan, lexo këtë dua:

La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, lehul-mulku ve lehul-hamdu juhji ve jumitu ve huve hajjun la jemutu bi jedihil-hajru ve huve ala kuli shej-in kadir. Bismillahi, allahumme inni es-eluke min hajri hadhihis-suki ve hajri ma fiha. Allahumme inni eudhu bike min sherriha ve sherri ma fiha. Allahumme inni eudhu bike en usibe fiha jeminen faxhireten ev safkaten hasireten. (Nuk ka zot pos Allahut, Një, të Vetmit. Ai nuk ka partner. Atij i takon pushteti e falënderimi. Ai ngjallë dhe sjell vdekjen, e Ai është i gjallë e nuk vdes. Tek Ai është çdo e mirë. Ai mundet gjithçka.¹⁴⁶ Në emër të Allahut! Allahu im, prej Teje kërkoj të mirat e këtij pazari dhe të mirën në të! Allahu im, prej Teje kërkoj mbrojtje nga e keqja e këtij pazari dhe e keqja në të! Allahu im, më mbroj nga dëshmia e rreme në këtë pazar ose nga marrëveshja e keqe.)¹⁴⁷, e nëse je në borxhe, lexoje këtë dua:

Allahummek-fini bi halalike an haramike vag-nini bi fadlike ammen sivake. (Allahu im! Më bëj të mjaftohem me furnizimin Tënd hallall dhe më mbroj nga harami; me të mirën Tënde më bëj të pavarur nga të tjerë pos Teje.)¹⁴⁸

¹⁴⁵ Nesai nga Rafi ibn Hadixh.

¹⁴⁶ Tirmidhi nga Omeri.

¹⁴⁷ Hakimi nga Burejde.

¹⁴⁸ Tirmidhi dhe Hakimi, Alia, r.a..

Kur të veshësh rrobë të re, lexo këtë dua:

**Allahumme kesevteni hadhessevbe fe lekel-hamdu, es-
eluke min hajrihi ve hajri ma sunia lehu ve eudhu bike min
sherrihi ve sherri ma sunia lehu.** (Allahu im, më veshe me këto
rroba, hamd për Ty. Prej Teje kërkoj të mirën e kësaj rrobe dhe të
mirën për të cilën ajo është qepur. Tek Ti kërkoj mbrojtje nga e
keqja e kësaj rrobe dhe e keqja për të cilën ajo është qepur).¹⁴⁹

Kur sheh diçka që nuk të pëlqen, lexo:

**Allahumme la je'ti bil-hasenati il-la ente ve la jedhhebu
bisseejjati il-la ente la havle ve la kuvvete il-la billahi.** (Allahu im!
Vetëm Ti sjell çka është e mirë dhe vetëm Ti largon çka është e
keqe. Nuk ka fuqi a forcë pa Allahun e Lartësuar, Madhështor).¹⁵⁰

Kur e sheh Hënën e re, lexo këtë dua:

**Allahumme ehilehu alejna bil-emni vel-imani vel-birri
vesselameti vel-islami vet-tevfiki limma tuhibbu ve terda vel-
hifzi ammen tes'hatu, rabbi ve rabbukellah. Hillalu rushdin ve
hajrin amentu bi halikike. Allahumme inni es'eluke hajre
hadheshshehri ve hajrel-kaderi ve eudhu bike min sherri jevmil-
hashri.** (Allahu ynë, me lajmërimin e Hënës së re, na dhuro siguri,
besim, të mirën, shpëtim, islam, ndihmë në atë me çka Ti je razi
dhe mbrojtje nga ajo me çka Ti nuk je razi. Rabbi im dhe i yti oj
Hënë, është Allahu!¹⁵¹ Hëna e re,¹⁵² e të drejtës dhe të mirës! Unë
besoj në Krijuesin tënd! Allahu im! Prej Teje kërkoj të mirën e këtij
muaji dhe caktim të hajrit, prej Teje kërkoj mbrojtje nga telashet
në Ditën kur të mbledhemi)¹⁵³; e në fillim lexon tri herë tekbir.

¹⁴⁹ Tirmidhi

¹⁵⁰ Ibn Ebu Shejbe dhe Ebu Nuajm.

¹⁵¹ Darimi nga ibn Omeri dhe Tirmidhiu nga Talha ibn Ubejdullah.

¹⁵² Davudi nga Katade.

¹⁵³ Ibn Ebu Shejbe dhe Imam Ahmed nga Ubade ibn Samit.

Kur të fryejë erë e fortë, lexo këtë dua:

Allahumme inni es'seluke hajre hadhihirrihi ve hajre ma fiha ve hajre ma erselte bihi ve neudhu bike min sherriha ve sherri ma fiha ve min sherri ma erselte bihi (Allahu im! Më dhuro të mirën e kësaj fryme, të mirën që ajo e bartë dhe me të cilën e ke dërguar! Më mbroj nga e keqja e kësaj fryme, e keqja që ajo e bartë dhe me të cilën e ke dërguar!)¹⁵⁴

Kur dëgjon se dikush ka kaluar në ahiret, lexo duanë:

Inna lillahi ve inna ilejhi raxhiun, ve inna ila rabbina le munkalibune. Allahumme-ktub-hu fil-muhsinine vexh'al kitabehu fi ilijjine va-h-luf-hu ala akibihi fil-gabirine. Allahumme la tuhrimna exhrehu ve la teftinna ba'dehu vegfir lena ve lehu. (Ne jemi të Allahut dhe vetëm tek Ai kthehemi (2:156). Me siguri do të kthehemi te Rabbi ynë (43:14). Allahu im, shkruaje me të mirët, e libri i veprave le t'i jetë në Ilijun. Pas tij, ringjalle familjen e tij! Mos na shkurto shpërblimin që ia ke dhënë! Mbrona nga sprova pas tij! Falna neve dhe atë!)¹⁵⁵

Kur jep sadaka, lexo këtë ajet kur'anor si dua:

Rabbena tekabbel minna 'inneke 'ente es-semi'ul-'alimu (O Rabbi ynë! Pranoje prej nesh, se vërtetë Ti je që dëgjon dhe di! 2-Bekare: 127).

Kur të dështon ndonjë punë, lexo këtë ajet si dua:

Asa rabbuna 'en jubdilena hajren minha 'inna 'ila rabbina ragibune (Shpresohet se Rabbi ynë do të na e zëvendësojë me ndonjë edhe më të mirë se kjo; ne vetëm tek Rabbi ynë mbajmë shpresën. 68-Kalem: 32).

¹⁵⁴ Tirmidhi dhe Nesai nga Ebi bin Ka'b.

¹⁵⁵ Ibn Seni dhe Ibn Hibban nga Ummu Seleme.

Kur do të fillosh ndonjë punë, lexo këto ajete si dua:

Rabbena ‘atina min ledunke rehmeten ve hejji’ lena min emrina resheden (Rabbi ynë, na dhuro nga ana Jote mëshirë dhe na përgatit udhëzim të drejtë në tërë çështjen tonë! 18-Kehf: 10)

Rabbi eshreh li sedri ve jessir li ‘emri (O Rabbi im, zgjeroma krahërorin tim, dhe lehtësoma punën time. 20-Ta Ha: 25, 26).

Kur shikon në qiell, lexo këto ajete kur’anore si dua:

Rebbena ma halekte hadha batilen subhaneke fekina adhabe en-nar (Rabbi ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit! 3-Ali Imran: 191).

Tebarekel-ledhi xhe’ale fi es-sema’i buruxhen ve xhe’ale fiha siraxhen ve kameren muniren (I madhërishëm është Ai që krijoi yje në qiell dhe vendosi në të dritë (diell) e hënë që ndriçon. 25-Furkan: 61).

Kur dëgjon bubullimën, lexoje këtë dua:

Subhane men jusebbihurra’du bihamdihi vel-melaiketun min hifetih (i Lavdëruar qoftë Ai të Cilin bubullima e madhëron dhe falënderon, e edhe melekët, nga frikërespekti ndaj Tij!)¹⁵⁶

Kur sheh vetëtimën në qiell, lexoje këtë dua:

Allahumme la taktulna bigadabike ve la tuhlikna biadhabike ve afina kable dhalike (Allahu ynë! Mos na mbyt me zemërimin Tënd, dhe mos na shkatërro me dënimin Tënd, dhe na fal para kësaj!)¹⁵⁷

¹⁵⁶ Shënon Maliki në ‘Muvatta’ nga Abdullah ibn Zubejr.

¹⁵⁷ Tirmidhi, Nesai nga Ibn Omeri.

Kaab ka thënë: “Kur të bjerë shi, bëje këtë dua:

Allahumme sukjen henien ve sajjiben nafian.
Allahummexh'alhu sajjibe rahmetin ve la texh'alhu sajjibe
adhabin (Allahu im! Na dhuro shi të këndshëm e të dobishëm!¹⁵⁸
Allahu ynë! Bëje të jetë shi i mëshirës, e mos e bëj dënim!)”¹⁵⁹

Kur të zemërohesh, lexoje këtë dua:

Allahummegfir li dhenbi ve edh'hib gajdha kalbi ve exhirni
mine'shshejtanirraxhim (Allahu im! Ma fal gjynahun tim dhe
largoje vrazhdësinë e zemrës time! Më mbroj nga shejtani i
mallkuar!)¹⁶⁰

Nëse ke frikë nga e keqja e njerëzve, lexo këtë dua:

Allahumme inna nexh'aluke fi nuhurihim ve neudhu bike
min shururihim (Allahu ynë! Ty të lusim që dredhitë e tyre t'i
drejtosh kah ta dhe tek Ti kërkojmë strehim prej të keqës së
tyre).¹⁶¹

Në luftë kundër armikut, lexo këtë dua:

Allahumme ente adudi ve nesiri ve bike ukatilu (Allahu im!
Ti je përkrahja ime dhe Ti je ndihmësi im dhe me emrin Tënd po
luftoj).¹⁶²

Kur të tingëllojnë veshët, lexo këtë dua:

Dhekerullahu men dhekereni bihajrin (Allahu Teala le ta
përmend atë që mua për të mirë më përmend!)¹⁶³

¹⁵⁸ Buhari nga Ajshe, r.anha.

¹⁵⁹ Nesai nga Seid b. Musejjeb.

¹⁶⁰ Ibn Seni nga Ajshe, r.anha.

¹⁶¹ Ebu Davud dhe Nesai nga Ebu Musa.

¹⁶² Davudi, Tirmidhi dhe Nesai nga Enesi.

¹⁶³ Taberani, Ibn Adijj dhe Ibn Seni nga Ebu Rafi.

Nëse vëren se duaaja të është pranuar, lexo këtë:

Elhamdu lilahil-ledhi bi izzetihi ve xhelalihi tetimmussalihatu (Hamd Allahut, me fuqinë dhe madhësitinë e Tij plotësohen veprat e mira).

E nëse duaaja nuk të pranohet menjëherë, lexo këtë:

Elhamdu lilahi ala kulli halin (Në secilin rast, hamdi i takon Allahut Teala).¹⁶⁴

Kur dëgjon ezanin për namazin e akshamit, lexo këtë dua:

Allahumme hadha ikbalu lejlike ve idbaru neharike ve asvatu duatike ve huduru salevatike es'eluke en tagfire li (Rabbi im! Po vjen nata, e po largohet dita. Kjo është koha kur dëgjojen zërat e atyre që Ty të drejtohen dhe kur lëshohen bereqetet Tua, prandaj të lutem të më falësh!)

Kur të kaplojnë brengat, lexo këtë dua:

Allahumme inni abduke vebnu abdike vebnu emetike nasijeti bijedike madin fijje hukmuke adlun fijje kadauke es'eluke bikuli ismin huve leke semmejte bihi nefseke ev enzeltehu fi kitabike ev allemtehu ehaden min halkike eviste'serte bihi fi ilmil-gajbi indeke en texh'alel-kur'ane rebia kalbi ve nure sadri ve xhellae gammi ve dhehabe hudhni ve hemmi (Allahu im, unë jam vërtetë, robi Yt, biri i robëve Tu. Jeta ime është në dorën Tënde. Unë jam i nënshtruar dhe mbi mua zbatohen vendimet Tua, i drejtë është caktimi Yt. Prandaj, të thërras me të gjithë emrat e Tu të bukur me të cilët e ke quajtur Vetën ose i ke shpallur në librin Tënd, ose ia ke treguar ndonjë

¹⁶⁴ Është përmendur te duatë.

¹⁶⁵ Hakimi nga Umme Seleme.

prej krijesave Tua, ose i ke mbajtur për Vete si dituri të fshehur, të thërras që Kur'anin ta bësh pranverë të zemrës sime, dritë të gjoksit tim, zbehje të pikëllimit tim dhe largim të brengave të mia e të fatkeqësisë time).¹⁶⁶

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

- Atë që e kaplon pikëllimi, dhe ai, më pas i lexon këto fjalë, Allahu Teala, sigurisht, do t'ia largojë brengën dhe do t'ia ndërrojë me gëzim.

- O Resulallah! A do t'i mbajmë në mend këto fjalë?;

pyetën, e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

- Po. Do të duhej t'i mësojë secili që i dëgjon.

Kur të ndjesh dhembje, ti ose dikush tjetër, shëroje këtë me duanë që e lexonte Resulallahu, s.a.v.s.; ai e vendoste gishtin tregues në vendin e dhembjes, më pas e ngriste e thoshte:

Bismillah turbetu erdina bi rukjati ba'dina jusfa sekimuna bi izni rabbina (Me emrin e Allahut, pluhuri i tokës sonë përzier me pështymën tonë, me lejen e Allahut, le t'i shërojë të sëmurët tanë).¹⁶⁷

Kur ndjen dhembje në trup, vendose gishtin në vendin ku ke dhembje dhe lexo tri herë *Bismilah*, e pastaj shtatë herë lexoje:

Eudhu bi'izzetillahi ve kudretihi min sherri ma exhidu ve uhadhiru (Strehim kërkoj në kudretin e Allahut dhe gjithëfuqinë e Tij nga e keqja e asaj që ndjej dhe që i frikësohem).¹⁶⁸

¹⁶⁶ Imam Ahmed bin Hanbel në 'Musned'. Bejheki në 'Kitab'ul-Esma ve's-Sifat' nga Abdullah Ibn Mesud.

¹⁶⁷ Buhariu dhe Muslimi nga Ajshe, r.anha.

¹⁶⁸ Muslimi nga Osman ibn Ebu el-As.

Kur ke ndonjë vështirësi, lexo këtë dua:

La ilahe illallahul-alijjul-halimu la ilahe illallahu rabbul-arshil-adhimi la ilahe illallahu rabbussemavatissebi ve rabbul-arshil-kerimi. (Nuk ka zot pos Allahut, të Lartësuarit e të Urtit. Nuk ka zot pos Allahut, Rabbit të Arshit të lartësuar. Nuk ka zot pos Allahut, Rabbit të shtatë qiejve dhe Rabbit të Arshit fisnik).¹⁶⁹

Kur dëshiron të flesh, merr abdes, shtriju në krah të djathtë kthyer kah kibla dhe lexo *Allahu ekber* 34 herë, *Subahanallah* 33 herë, *Elhamdulillah* 33 herë,¹⁷⁰ e më pas lexo duanë:

Allahumme inni eudhu biridake min sehatike ve bi muafatike min ukubetike ve eudhu-bike minke. Allahumme inni la estetiu en ebluga senaen alejke ve lev harastu ve lakin ente kema esnejte ala nefsike. Allahumme bismike ahja ve emutu. Allahumme rabbessemavati ve rabbel-erdi ve rabbe kuli shej'in ve melikehu falikal-habbi ven-neva munzilet-tevratu vel-inxhili vel-Kur'an eudhu bike min sherri kuli zi sherrin ve min sherri kuli dabbetin ente ahizun bi nasijetiha, entel-evvelu fe lejse kableke shej'un ve entel-ahiru fe lejse ba'deke shejun ve entezzahiru fe lejse fevkake shej'un, ve entel-batinu fe lejse duneke shej'un, ikdi annid-dejne ve agnini minel-fakr. Allahumme inneke halakte nefsı ve ente teteveffaha leke mematuha ve mahjaha. Allahumme in emetteha fagfir leha ve in ahjejteha fahfazha. Allahumme inni es-elukel-afijete fiddunya vel-ahireti bismike rabbi veda'tu xhenbi fagfir li dhenbi. Allahumme kini adhabeke jevme texhmeu ibadeke. Allahumme eslemtu nefsı ilejke ve vexhxhehtu vexhhi ilejke ve

¹⁶⁹ Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Abbas.

¹⁷⁰ Buhariu dhe Muslimi.

fevvadtu emri ilejke ve elxhe'tu dhahri ilejke ragbeten ve rehbeten ilejke la melxhee ve la menxha minke illa ilejke amentu bi kitabikelledhi enzelte ve nebijikelledhi erselte (Allahu im! Strehohem te mëshira Jote nga zemërimi Yt, në gatishmërinë Tënde për falje strehohem nga dënimi Yt. Strehohem tek Ti nga Ti. Nuk jam në gjendje, sa do që mundohem, të shpreh falënderimin tim për Ty. Ti je i tillë çfarë ke thënë Ti vet që Je. Allahu im, me emrin Tënd jetoj dhe vdes. Allahu im, Rabb i qiejve, Rabb i Tokës, Rabb i gjithçkaje, Ti nën pushtetin e të Cilit është gjithçka, Ti që bën që fara e thelbi të mbijnë, Ti që e ke shpallur Tevratin, edhe Inxhilin, edhe Kur'anin, prej Teje kërkoj mbrojtje nga çdo e keqe e keqbërësit dhe e keqja e secilës kafshë që është nën pushtetin Tënd; Ti je i Pari dhe para Teje nuk ka asgjë; Ti je i Fundit dhe pas Teje nuk ka asgjë; Ti je i Dukshmi dhe përmbi Ty nuk ka asgjë, Ti je i Fshehuri dhe nën Ty nuk ka asgjë, më shpëto nga borxhi dhe më mbroj nga varfëria! Allahu im! Ti më ke krijuar dhe Ti do të më vdesësh, sepse Ty të takon jeta ime dhe vdekja ime, prandaj nëse më vdes, Allahu im, më fal, e nëse më mban gjallë, më ruaj! Allahu im! Më dhuro falje edhe në këtë botë edhe në botën tjetër! Me emrin Tënd në muzg pushoj, prandaj më fal gjynahun tim! Allahu im! Më ruaj nga dënimi Yt në Ditën kur të mbledhësh robët Tu! Allahu im, Ty të dorëzohem, fytyrën time e drejtoj kah Ti, Ty ta dorëzoj rastin tim, Ty të falem, nga dashuria për Ty dhe nga frika para Teje, sepse nuk ka strehim e shpëtim prej Teje përpos tek Ti. Besoj në Librin Tënd, që e ke shpallur dhe në Pejgamberin Tënd, që e ke dërguar).¹⁷¹

¹⁷¹ Buhari, Muslim, Nesai dhe Tirmidhi.

Le të jetë kjo dua ja jote e fundit para gjumit, sepse kështu ka urdhëruar Resulallahu, s.a.v.s., e para kësaj gjithashtu lexo:

Allahumme ejkidhni fi ehabbissa'ati ilejke vesta'milni biehabbi-l-a'mali ilejke tukarribuni ilejke zulfa ve tub'iduni min sehatike bu'den es'esluke fe tu'tijeni ve estagfiruke fetagfire li ve ed'uke fetestexhibe li (Allahu im! Më zgjo në kohën më të dashur për Ty, dhe më angazho në veprat më të dashura për Ty, të cilat do të më afrojnë tek Ti e do të më largojnë nga zemërimi Yt. Ty të lutem, prandaj më dhuro, nga Ti kërkoj falje, prandaj më fal, Ty të bëj dua, prandaj ma prano duanë).¹⁷²

Kur (në mëngjes) të zgjohesh nga gjumi, lexo:

Elhamdulillahi'ledhi ahjana ba'de ma ematena ve ilejhinnushur. Asbahna ve asbehal-mulku lillahi vel-adhametu vessultanu lillahi vel-idhdhetu vel-kudretu lillahi asbahna ala fitretil-islami ve kelimetil-ihlasi ve ala dini nebijjina Muhammedin sallallahu alejhi ve selem ve mileti ebina Ibrahime hanifen ve ma kane minel-mushrikine. Allahumme bike asbahna ve bike emsejna ve bike nahja ve bike nemutu ve ilejkel-mesir. Allahumme inni es'eluke en teb'asena fi hazel-jevmi ila kuli hajrin ve neudhu bike en nexhterihia fihi suen ev nexhxurrehu ila muslimin feinneke kulte ve huvel-ledhi jeteveffakum bil-lejli ve ja'lemu ma xherehtum bin-nehari thumme jeb'athukum fihi lijukda exhelun musemmen. Allahumme falikul-isbahi ve xha'olellejli sekenen veshshemsi vel-kameri husbanen es'eluke hajre hadhel-jevmi ve hajre ma fihi ve eudhu bike min sherrihi ve sherri ma fihi. Bismillahi mashaellahu la kuvvete illa billahi mashaellahu kullu ni'metin

¹⁷² Ebu Mansur Dejlemini në 'Musned-i Firdevs' nga Ibn Abbas.

minellahi ma shaellahu-l-hajru kulluhu bijedillahi ma shaellahu la jasrifussue illellahu reditu billahi rabben ve bi-l-islami dinen ve bi-lkur'ani imamen ve bi Muhammedin sallahahu alejhi ve seleme nebijjen ve resula. Rabbena alejke tevekkeln ve ilejke eneba ve ilejke-l-mesiru (Hamd Allahut, i Cili na ka ngjallur, pasi që na ka vdekur. Kthimi është te Ai.¹⁷³ U zgjuam, e gjithë pushteti i takon Allahut, edhe lartësimi dhe fuqia i takojnë Allahut, edhe madhështia dhe lëvizja i takojnë Allahut.¹⁷⁴ U zgjuam në islam dhe në fjalën e singertë, dhe në fenë e pejgamberit tonë, Muhammedit, s.a.v.s., dhe të miletit të babasë tonë, Ibrahimit, a.s., i cili ishte i pastër dhe nuk ishte idhujtar.¹⁷⁵ Allahu ynë! Në rrugën Tënde u zgjuam dhe në rrugën Tënde u errëm, në rrugën Tënde jetojmë dhe në atë rrugë vdesim, dhe tek Ti do të kthehem.¹⁷⁶ Allahu im! Ty të lus që në këtë ditë të sotme të na udhëzosh në çdo të mirë dhe tek Ti kërkoj mbrojtje nga bërja e të keqes në këtë ditë ose nga të bërit keq myslimanit, sepse Ti ke thënë: **Ai është që ju vë në gjumë natën dhe e di çka vepruat ditën, pastaj ju ngjall në të (ditën) deri në afatin e caktuar** (6-Enam: 60). Allahu im, Ti që e bën ditën të lind, Ti që natën e bërë qetësi, e Diellin dhe Hënën i caktove për llogaritje të kohës, prej Teje kërkoj të mirën e kësaj dite dhe të mirën që ajo e sjell, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e kësaj dite dhe e keqja që

¹⁷³ Buhari nga Huzejfe dhe Muslimi nga el-Ber.

¹⁷⁴ Taberani në 'Evsat' Taberani nga Ajshe, r.anha. Shënon edhe Muslimi nga Ibn Mesud.

¹⁷⁵ Nesai në 'El-Jevm ve'l-Lejle' nga Abdurrahman ibn Ebzij, me zinxhir të besueshëm. Edhe Ahmedi nga Ibn Ebzij, ky nga Ubejj ibn Ka'b si merfu.

¹⁷⁶ Autorët e Sunnen, Ibn Hibban dhe Tirmidhi, që e konsideron hasen.

*ajo e sjell.*¹⁷⁷ Me emrin e Allahut dhe siç do Allahu – nuk ka forcë pos me Allahun; siç do Allahu – çdo bereqet është nga Allahu; siç do Allahu – çdo e mirë është nga Allahu; siç do Allahu – vetëm Ai e largon të keqen. Jam i kënaqur që Allahu është Rabbi im, që islami është feja ime dhe që Muhammedi, s.a.v.s., është peygamberi im.¹⁷⁸ **“O Rabbi ynë, te Ti mbështetemi dhe Ty të drejtohem i dhe te Ti do të kthehem i”** (60-Mumteherine: 4).

Në mbrëmje lexoje këtë dua, vetëm se në vend të *asbahna* lexo *emsejna* (u errëm). E bashkë me këtë, lexoi edhe këto dua:

Eudhu bekilimatillahittammati ve esmaihi kulliha min sherri ma dhere’e ve bere’e ve min sherri kulli dhi sherrin ve min sherri kulli dabbetin ente ahidhun bi nasijetiha inne rabbi ala siratimmustekimin (Mbrohëm me fjalët e plota të Allahut dhe me të gjithë emrat e Tij nga e keqja e gjithçkaje që është krijuar nga asgjëja dhe nga e keqja e secilit keqbërës dhe e keqja e secilës kafshë që është nën sundimin Tënd! Rabbi im vërtetë vepron drejtë!)¹⁷⁹

Kur shikohesh në pasqyrë, lexoje këtë dua:

Elhamdulillahilledhi sevva halki fe addelehu ve kerreme surete vexhhi ve hasseneha ve xhe’aleni mine-l-muslimine. (Hamd Allahut, i Cili më krijoi në formën më të bukur, i Cili më nderoi me fytyrë të bukur dhe i Cili më bëri mysliman).¹⁸⁰

¹⁷⁷ Ebu Mansur Dejlemi në ‘*Musned-i Firdevs*’ nga Ebu Seid. E shënon edhe Muslimi.

¹⁷⁸ Është shënuar në kapitullin e parë.

¹⁷⁹ Ebu Shejh nga Abdurrahman ibn Avf.

¹⁸⁰ Taberani dhe Ibn Seni nga Enesi.

Kur blen ndonjë kafshë, kape për litari e thuaj:

Allahumme inni es'eluke hajrehu ve hajre ma xhubile alejhi ve eudhu bike min sherrihi ve sherri ma xhubile alejhi (Allahu im, prej Teje kërkoj të mirën e kësaj dhe të mirën e asaj për çfarë e ke bërë të përshtatshëm. Prej Teje kërkoj mbrojtje nga e keqja e kësaj dhe e keqja e asaj për çfarë e ke bërë të përshtatshëm).¹⁸¹

Kur dikujt i uron martesën, thuaj:

Barekallahu fike ve bareke alejke ve xhemea bejnekuma fi hajrin (Allahu të bekoftë dhe e lëshoftë bereqetin mbi ty e ju bashkoftë në të mirë).¹⁸²

Kur t'a kthesh borxhin, huazuesit lexoja këtë dua:

Barekallahu leke fi ehlike ve malike (Allahu ta dhashtë bereqetin, në familjen tënde dhe në pronën tënde!),

sepse Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

"Shpërblimi i borxhit është kthimi i tij në kohë dhe falendërimi."¹⁸³

Këto janë dua që secili murid do të duhej t'i dijë përmendësh, e kur bëhet fjalë për duatë tjera, si për shembull dua ja gjatë udhëtimit, dua ja me rastin e faljes së namazit dhe marrjes së abdesit, i kemi përmendur në librat për haxhin, namazin dhe pastërtinë.

¹⁸¹ Ebu Davud dhe Ibn Maxhe, nga Amr ibn Shuajb.

¹⁸² Ebu Davud, Tirmidhi dhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre.

¹⁸³ Nesai, nga Abdullah ibn Ebu Rebi.

Nëse je në dyshim rreth asaj se cila është dobia e duasë kur gjithçka është paraprakisht e përcaktuar, dije se caktimi i Allahut është edhe largimi i telashes përmes duasë. Pra, duaja është shkaktar për largimin e telashes dhe për arritjen e mëshirës së Allahut, siç është mburoja shkaktar i ndalimit të shigjetës, ose siç është uji shkaktar i rritjes së bimëve. Prandaj, ashtu siç e largon mburoja shigjetën, edhe duaja me telashen e plotësojnë njëra-tjetrën. Nëse besohet dhe pranohet caktimi i Allahut, atëherë nuk mundet të mos bartet armë, sepse Allahu Teala thotë:

“Rrini të përgatitur...” 4-Nisa: 71, e as që mundet të mos ujitet toka pasi që aty është hedhur fara, e të thuhet: *“Nëse është caktuar që nga fara të rritet bima, do të rritet, e nëse nuk është caktuar ashtu, bima nuk do të rritet.”*

Nuk mundet kështu, sepse lidhja në mes të shkakut dhe pasojës është, në fakt, caktimi fillestar i Allahut, e kjo lidhje është si dridhja e qerpikut, ose edhe më e shpejtë. Renditja në ndodhjen e shkakut dhe pasojës, është, në fakt, caktimi i Allahut. Kështu, Ai i Cili e ka caktuar të mirën, e ka caktuar me shkas; Ai i Cili e ka caktuar të keqen, e ka caktuar edhe shkakun me të cilin ajo largohet. Prandaj, nuk ka kurrfarë kundërshtie për atë që mendon. Përpos kësaj, duaja ka edhe dobi tjera, e i përmendëm kur folëm për vlerat e dhikrit, sepse duaja kërkon dorëzim të singertë Allahut Teala, që është edhe qëllimi final i secilit ibadet. Prandaj, Allahu Teala thotë:

“Duaja është esenca e ibadetit.”¹⁸⁴

¹⁸⁴ Tirmidhiu nga Enes b. Malik.

Shumica e njerëzve bëjnë dhikr vetëm kur kanë nevojë e telashe, sepse kur njeriut i ndodhë ndonjë e keqe, ai atëherë bën shumë dua. Pra, nevoja është ajo që personin e shtyen të bëj dua, e leximi i duasë e kthen zemrën kah Allahu Teala e në të mbjell frikë-respektin dhe shpresën. Në këtë mënyrë ndodh dhikri, si ibadeti më i nderuar. Prandaj sprovat ishin përcjellje e vazhdueshme e peygamberëve, pastaj robëve të mirë të Allahut, e më pas atyre që janë si ta, e me rend. Në sprovë, zemra fuqishëm ndjen nevojën për Allahun Teala dhe ndjen përlulje, që nuk e lejon ta harrojë Allahun. E pasuria, në të shumtën e rasteve, shkakton pakujdes, sepse njeriu hutohet, sapo te ndjehet i pavarur.

Këto janë duatë dhe dhikret që kishim qëllim t'i tregojmë, e Allahu Teala jep përkrahje dhe ndihmë në bërjen e veprave të mira. Sa për duatë tjera, siç janë duaja e të ushqyerit, duaja e udhëtimit, duaja e vizitës të sëmurit, e të ngjashme, do t'i përmendim, inshallah, në librat tjerë. E mbështetja është vetëm në Allahun.

Me këtë e përfunduam Librin për dhikr dhe dua, e pason, në dhashtë Allahu, libri i virdeve. Hamd Allahut, Rabbit të botëve, dhe salavat e selam peygamberit tonë, Muhammedit, s.a.v.s., ehli-bejtit dhe as'habëve të tij.

PËRMBAJTJA

VLERAT E LARTË DHE DOBIA E DHIKRIT SIPAS AJETEVE, HADITHEVE DHE TRANSMETIMEVE TJERA	5
VLERAT E (TUBIMIT) MEXHLISIT TË DHIKRIT	10
FAZILETI I SHQIPTIMIT TË <i>SUBHANALLAH, ELHAMDULILLAH</i> DHE DHIKREVE TJERË	18
EDEBI I DUASË, VLERAT E SAJ, DISA DUA TË RESULALLAHUT, S.A.V.S., VLERAT E ISTIGFARIT DHE TË SALAVATIT DËRGUAR RESULALLAHUT, S.A.V.S.	33
VLERAT E LARTATË DUASË	33
ADABI I DUASË	34
FAZILETI I SALAVATIT PËR RESULALLAHUN, S.A.V.S.	50
FAZILETI I ISTIGFARIT	55
DUATË TRADICIONALE	64
DUAJA E RESULALLAHUT, S.A.V.S., PAS NAMAZIT TË SABAHUT	64
DUAJA E AJSHES, R.ANHA.....	67
DUAJA E FATIMES, R.ANHA.....	68
DUAJA E EBU BEKR ES-SIDDIK, R.A.	69
DUAJA E BUREJDE EL-ESLEMI, R.A.	70
DUAJA E KUBEJSE IBN MEHARIK	71
DUAJA E EBU DERDAS, R.A.	72
DUAJA E IBRAHIMIT A.S.....	73
DUAJA E ISASË A.S.	74
DUAJA E MA'RUF KERHI R.A.	75
DUAJA E UTBE GULAM'IT	76
DUAJA E ADEMIT A.S.....	76
DUAJA E ALI IBN EBU TALIB R.A.	77
DUAJA DHE TESBIHU I SULEJMAN BIN MU'TEMIR'IT	79
DUAJA E IBRAHIM ED'HEMIT	80
DUATË QË TRANSMETOHEN NGA RESULALLAHU, S.A.V.S., DHE AS'HABËT E TIJ, R.A.	85
SI KËRKONTE MBROJTJE RESULALLAHU, S.A.V.S., TEK ALLAHU TEALA	95
DUATË NË MOMENTE TË RËNDËSISHME	99

